# RAPORTI VJETOR

## PËR REVIZIONET E KRYERA DHE PUNËN E ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION



**PËR VITIN 2021**

# RAPORTI VJETOR

# PËR REVIZIONET E KRYERA DHE PUNËN E ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION



PËR VITIN 2021

**Titulli origjinal:**
Годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија за 2021 година

**Titulli i publikimit:**
Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror për Revizion për vitin 2021

**Botues:**
Enti Shtetëror i Revizionit – Shkup
Rruga Pavel Shatev nr. 2, Pallati Emanuel Çuçkov, Shkup

**Për botuesin:**
mr. Maksim Acevski, Kryerevizori shtetëror

**Redaktor:**
mr. Maksim Acevski, Kryerevizori shtetëror

**Албански јазик**
Përkthim maqedonisht-shqip: Sefedin Rexhepi

**Shtypi:**
Shoqëria për aktivitetin e shtypjes grafike, tregtinë, prodhimin dhe shërbimet GETEO print Pero SHPKNJP eksport - import - Shkup

**Përpunimi kompjuterik dhe teknik:** Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime KOMA SHPKNJP eksport import Shkup

**Vendi i botimit:**
Shkup, 2022

**Tirazhi:**
50 kopje

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
„Св. Климент Охридски", Скопје

657.6(497.7)„2021"(047.31)

RAPORTI vjetor për revizionet e kryera dhe punën e Entit shtetëror për revizion per vitin 2021 / [redaktor Maksim Acevski ; përkthim maqedonisht-shqip Sefedin Rexhepi]. - Shkup : Enti shtetëror i revizionit, 2022. - [172] стр. : илустр. ; 30 см

Превод на делото: Годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија за 2021 година

ISBN 978-608-5006-01-4

а) Државен завод за ревизија (Скопје) -- 2021 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 57659653

# P Ë R M B A J T J A


1 PËR ENTIN SHTETËROR TË REVIZIONIT 16

1.1. KORNIZA JURIDIKE 19

1.2. DOKUMENTET STRATEGJIKE 20

1.3. DOKUMENTET METODOLOGJIKE 22

2 Transparenca dhe bashkëpunimi 24

2.1.TRANSPARENCA NË PUNËN E ESHR-së 25

2.2. BASHKËPUNIMI ME ASOCIACIONET DHE INSTITUCIONET PROFESIONALE, ORGANIZATAT QYTETARE DHE PUBLIKUN E PËRGJITHSHËM 32

2.3. BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE PËR REVIZIONET DHE EFEKTET E TYRE 35

3 KAPACITETET ADMINISTRATIVE 38

3.1. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE 39

3.2. RRITJA E NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË REVIZORËVE SHTETËROR 40

3.3. BURIMET E TI-së 43

3.4. MJETET FINANCIARE PËR PUNË TË ESHR-së 44

4 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR 46

4.1. AKTIVITETET E PROJEKTIT 54

## 5 REVIZIONET E KRYERA 56

5.1. VLERA E SHTUAR E REVIZIONEVE 63

5.2. BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2020 65

5.2.1. BUXHETI THEMELOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2020 65

5.2.2. MENAXHIMI ME BORXHIN PUBLIK – HUAMARRJA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT 71

5.2.3. HUAMARRJA E SUBJEKTEVE TË SEKTORIT PUBLIK, SHKALLA E PËRDORIMIT TË KREDIVE DHE HUAVE DHE SHPENZIMET E PAGUARA DHE TË KRIJUARA 73

5.2.4. EFEKTIVITETI I MASAVE TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR BARAZINË GJINORE DHE NISMAT BUXHETORE GJINORE PËRKATËSE 80

5.3. KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT 83

5.4. MENAXHIMI ME PRONËN 84

5.4.1. REGJISTRIMI I MJETEVE, KËRKESAVE DHE DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PËR PUNË TË PËRGJITHSHME DHE TË PËRBASHKËTA TË QEVERISË SË RMV-së 84

5.4.2. QENDRA TREGTARE E QYTETIT SH.A. SHKUP 84

5.5. EFEKTET NGA PANDEMIA COVID-19 87

5.5.1. MASAT EKONOMIKE TË QEVERISË SË RMV-së PËR BALLAFAQIMIN ME KRIZËN E SHKAKTUAR NGA VIRUSI KOVID-19 88

5.5.2. MASAT DHE POLITIKAT E NDËRMARRA PËR MBËSHTETJEN E PUNËSIMIT DHE PROFESIONEVE TË PREKURA NGA KRIZA SHËNDETËSORE DHE EKONOMIKE TË SHKAKTUAR NGA KOVID-19 91

5.5.3. EFIKASITETI I MASAVE DHE POLITIKAVE TË NDËRMARRA PËR ZVOGLIMIN E EFEKTEVE TË PANDEMISË NË SEKTORIN E TURIZMIT 95

5.6. SHËNDETËSIA 98

5.6.1. FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I RMV-së 98

5.6.2. AGJENCIA E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT 101

5.6.3. INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE 102

5.7. ENERGJETIKA 103

5.7.1. EKSPLOATIMI I BURIMEVE TË UJIT GJATË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN PREJ 2012 DERI MË 2021 103

5.7.2. SHA PËR PRODHIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE ESM NË PRONËSI SHTETËRORE 105

5.8. SHOQËRIA INFORMATIKE 107

5.8.1. INTEROPERABILITETI MIDIS INSTITUCIONEVE TË SEKTORIT PUBLIK 107

5.8.2. SISTEMI INFORMATIKË PËR PARAQITJE, TESTIM DHE PUNËSIM NË AGJENCINË E ADMINISTRATËS 108

5.9. DREJTËSIA DHE SIGURIA 110

5.9.1. MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME 110

5.9.2. MINISTRIA E DREJTËSISË 112

5.9.3. MINISTRIA E DREJTËSISË-DREJTORIA PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE 112
5.9.4. INSTITUCIONI PENITENSIAR BURGU SHKUP - SHKUP 113
5.9.5. GJYKATA E APELIT SHKUP 113
5.9.6. GJYKATA THEMELORE TETOVË 114

5.10. TRAFIKU, TRANSPORTI DHE KOMUNIKIMI 115

5.10.1 HEKURUDHAT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT - SHA TRANSPORT 115
5.10.2. NDËRMARRJA RADIODIFUZIVE PUBLIKE RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË SHKUP - TVM 115
5.10.3. AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE 117

5.11. MJEDISI JETËSOR 117

5.11.1. POLITIKAT DHE MASAT E MARRA NGA ANA E RMV-së / AUTORITETET KOMPETENTE, ME QËLLIM TË ZBUTJES SË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE 117

5.12. FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET KOMUNALE 121

5.12.1. NDËRMARRJET PUBLIKE NË NIVEL LOKAL 121
5.12.2. NP "STREZHEVO" MANASTIR 123

5.13. PUNË DHE SOCIALE 125

5.13.1. FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT 125
5.13.2. AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT 127
5.13.3. INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS 129

5.14. ARSIMI 130

5.14.1. ARSIMI I LARTË 130

5.15. KULTURA 131

5.15.1. INSTITUCIONET NACIONALE NË FUSHËN E KULTURËS 131

5.16. VETËQEVERISJA LOKALE 133

5.16.1. NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE 133

5.17. PARTITË POLITIKE DHE FUSHATAT ZGJEDHORE 136

5.17.1. PARTITË POLITIKE - PUNA E RREGULLT 136
5.17.2. PARTITË POLITIKE - FUSHATA ZGJEDHORE 137

6 DOBËSITË SISTEMATIKE 140

7 RAPORTI FINANCIAR I ESHR-së DHE RAPORTI I REVIZORIT TË PAVARUR 152

Shkurtesat 170



# Të nderuar,

Kaloi edhe një vit i shënuar me vështirësitë dhe sfidat e shkaktuara nga pandemia globale e KOVID-19, vit në të cilin rrjedha normale e ngjarjeve, zakoneve dhe rutinave me të cilat përballet shoqëria dhe ekonomia kanë ndryshuar globalisht dhe realiteti i ri i ka detyruar të mësojnë për t'u përballur me të.

Megjithatë, puna në Entin Shtetëror të Revizionit ka vazhduar pa ndërprerje, duke i tejkaluar të gjitha pengesat gjatë përmbushjes së vizionit dhe misionit tonë dhe të Programit Vjetor të Punës për vitin 2021. Falë vendosjes së sistemit të mirë të punës, sigurimit të kushteve teknike dhe kushteve të tjera të nevojshme për kryerjen e punës së pandërprerë, përkushtimi i udhëheqësisë dhe punonjësve, me sukses arritëm ta përmbledhim punën tonë në këtë raport. Me krenari jua prezantoj Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2021.

Misioni i çdo Institucioni Suprem të Revizionit është të kontribuojë në menaxhimin e shëndoshë financiar me fondet publike, prandaj mbajtja e përgjegjësisë për fondet publike dhe dhënia e rekomandimeve të qarta dhe efektive me të cilat do të kontribuojnë në avancimin e menaxhimit me to janë misioni dhe vizioni themelor i ESHR-së. Në Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2021 janë përmbledhur 1170 gjendje tona të përcaktuara dhe 654 rekomandimet nga 109 raportet e revizionit, nëpërmjet të cilave kemi dorëzuar informacione objektive për punën e subjekteve të reviduara.

Në bazë të treguesve të punës sonë, me revizionet në vitin 2021 kemi rritur përfshirjen e shpenzimeve të reviduara në krahasim me fondet e përgjithshme buxhetore, ndërsa ndjeshëm janë përmirësuar edhe treguesit për zbatimin e rekomandimeve të revizionit dhe në të njëjtën kohë është rritur vlera e shtuar nga revizionet e kryera, para se gjithash, në pjesën e shumës së mjeteve të përcaktuara të llogaritura më pak, më pak të kthyera, përkatësisht më pak mjete të paguara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që tregon për faktin se kontributi i ESHR-së në forcimin e institucioneve dhe përgjegjësia menaxheriale është më e rëndësishme në shoqërinë tonë.

Me revizionet e suksesit, të cilat për kënaqësinë time po marrin gjithnjë e më shumë rëndësi nga viti në vit, fokusohemi në çështjet aktuale, me interes për publikun dhe palët e tjera të interesuara, me theks të veçantë në vlerën e shtuar të tyre. Ndikimi i krizës së COVID-19 është jashtëzakonisht heterogjen, me implikime të rëndësishme për sistemin financiar dhe zbatimin e politikave të pushtetit qendror dhe lokal. Prandaj, besoj se është me rëndësi të veçantë që Institucionet Supreme të Revizionit të vlerësojnë ndikimin e pandemisë në nivel lokal përmes aspekteve të ndryshme: shëndetësore, ekonomike, sociale dhe fiskale. Duke i pasur parasysh këto aspekte, ndërsa me qëllim që t'u dalë në ndihmë sfidave që kanë lindur nga pandemia, Programi Vjetor i Punës së ESHR-së për vitin 2021 përfshiu tre revizione që kanë të bëjnë me masat e ndërmarra dhe aktivitetet për tu mbrojtur dhe parandaluar nga ngjarjet e paparashikuara dhe tronditjet potenciale.

Në raportet e tona të revizorëve, pa marrë parasysh llojin dhe objektivat e revizioneve, veçmas për gjendjet të cilat i konstatojmë te subjektet që janë lëndë e revizionit, sugjerojmë edhe për dobësitë sistematike, gjegjësisht dobësitë dhe zbrazëtirat në rregullativën e disa fushave të caktuara. Me sugjerimet e nevojës për t'i tejkaluar ato, kontribuojmë në forcimin e sistemit juridik dhe krijimin e ambientit të volitshëm për zhvillimin e mëtejshëm të subjekteve juridike.

Kemi investuar vazhdimisht në zhvillimin e mëtejshëm të Entit Shtetëror të Revizionit si ISR dhe përmirësimin e proceseve të revizionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe në përmirësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të punonjësve. Enti Shtetëror i Revizionit shumë aktivitete të rëndësishëm i ka zbatuar edhe në nivel ndërkombëtar, si në kuadër të anëtarësimit në organizatën evropiane dhe ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit, ashtu edhe në kuadër të organizatave të tjera ndërkombëtare.

Enti Shtetëror i Revizionit, në arritjen e objektivave të saj strategjike, kërkon të bashkëpunojë me qytetarët dhe mediat, me qëllim të rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë në përdorimin e fondeve të tatimpaguesve. Për këtë qëllim në vazhdimësi ndërmarrim aktivitete për të rritur numrin e palëve të interesuara dhe me kënaqësi mund të theksoj se ky numër në dhjetor të vitit 2021 është 380, që në krahasim me fundin e vitit 2020 përbën rritje prej 100%.

Çdo krizë është mundësi për të zgjuar atë që është e mirë te njerëzit: kreativiteti, përgjegjësia, dhembshuria dhe aftësia për të zgjidhur problemet. Ne, si Ent Shtetëror i Revizionit konsiderojmë se kemi guxim t'i shohim punët ashtu siç janë në të vërtet, dhe gjithashtu edhe aftësi që na ndihmojnë ta vazhdojmë procesin e marrjes së besimit, identifikimit të punës së institucionit, forcimit të autoritetit të pavarësisë, objektivitetit dhe efikasitetit të institucionit suprem të revizionit në drejtim të mbrojtjes së fondeve të tatimpaguesve.

Kryerevizori shtetëror
mr. Maksim Acevski

# VLERA E SHTUAR E REVIZIONEVE

VLERA E SHTUAR E REVIZIONEVE

**1.743.644**
Kompensimet e papaguara më pak të paguara në Buxhetin e RMV-së

**121.838**
Kompensimet e papaguara më pak të paguara në Buxhetin e RMV-së të komunave të reviduara

**1.323.941**
Përdorimi i mjeteve në kundërshtim me ligjin

**5.975.562**
Shuma e përgjithshme nga parregullsitë e konstatuara te PP-ja

**36.497.709**
Përfshirja e PP-së me revizionet

**135.320.350**
Aktiva/ pasiva e përgjithshme

**3.922.995**
Regjistrimet korrektuese në Bilancet e gjendjes

në 000 denarë

# **PROGRAMI VJETOR** I PUNËS SË ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT PËR VITIN 2021

5 BARAZIA GJINORE

7 ENERGJIA E PASTËRT E ARRITSHME

8 PUNË ME DINJITET DHE RRITJE EKONOMIKE

9 INDUSTRIA, INOVACIONI, INFRASTRUKTURA

10 ZVOGËLIMI I PABARAZISË

11 BASHKËSITË DHE QYTETET E QËNDRUESHME

13 BALLAFAQIMI ME NDRYSHIMET KLIMATIKE

SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS

OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË PËRFSHIRA ME REVIZIONET

**68** REVIZIONE TË KRYERA

- 56 revizione të rregullshmërisë
- 7 revizione të suksesit
- 3 revizione të pajtueshmërisë
- 2 revizione të TI-së

## TEMAT E PËRFSHIRA ME REVIZIONET

- Buxheti shtetëror
- njësia e vetëqeverisjes lokale
- fondet e shtetit
- drejtësia
- sigurimi shëndetësor
- arsimi
- infrastruktura
- shërbimet publike komunale
- kultura
- mjedisi jetësor
- energjetika
- fondet e BE-së
- sistemi për sigurim social
- fondet ndërkombëtare
- sistemi i TI-së
- zhvillimi i qëndrueshëm
- sistemi politik
- mbrojtja

# AKTIVITETET E REVIZIONIT PËRMES NUMRAVE

**109** RAPORTE TË REVIZIONIT

**MENDIME TË REVIZIONIT REVIZIONI I RREGULLSHMËRISË**

**96** mendime për raportet financiare:

- **31** pa rezervë
- **26** me rezervë
- **31** mendime të pavolitshme dhe
- **8** mendime të përmbajtura

**92** mendime për pajtueshmëri me rregulla dhe ligje

- **23** pa rezervë
- **35** me rezervë
- **32** mendime të pavolitshme dhe
- **2** mendime të përmbajtura

**PËRFUNDIMET REVIZIONI I PAJTUESHMËRISË/ REVIZIONI I SUKSESIT**

- **3** përfundime për revizionin e pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit
- **7** përfundime për revizionin e suksesit
- **2** përfundime për revizionin e TI-së

**1.170** ⚠ GJETJE TË KONSTATUARA ME REVIZION

- **942** revizione të rregullshmërisë
- **144** revizione të suksesit
- **71** revizione të pajtueshmërisë
- **13** revizione të TI-së

**136** SUBJEKTE TË PËRFSHIRA ME REVIZION

- **56** revizione të rregullshmërisë
- **63** revizione të suksesit
- **15** revizione të pajtueshmërisë
- **2** revizione të TI-së

**72** GJETJE TE PROKURIMET PUBLIKE

**NË MIJË DENARË VLERA E PËRGJITHSHME E KONTRATAVE TË NDARA PËR PROKURIMET PUBLIKE**
**40.357.958**
во 000 денари

**NË MIJË DENARË PROKURIME PUBLIKE TË REVIDUARA**
**36.497.709**
во 000 денари

**5.975.562** ⚠
**NË MIJË DENARË PARREGULLSI TË KONSTATUARA TE PROKURIMET PUBLIKE**
во 000 денари

- dobësi në realizimin e kontratave të lidhura për prokurimet publike;
- Dobësi në fazën e lidhjes së kontratës për prokurimet publike,
- parregullsi gjatë përgatitjes së dokumentacionit të tenderit/specifikime teknike;
- dokumentacioni i tenderit e cila në vete përfshin elemente të kufizuara në lidhje me konkurrencën;
- parregullsi në vlerësimin e ofertave;
- dobësi në fazën e planifikimit të prokurimeve publike

# TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E **REVIDUARA**

Gjithsej **511.923 MILION DENARË** të ardhura publike të reviduara dhe **236.060 MILION DENARË** shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021

| | **të ardhurat e reviduara publike** | | **shpenzimet e reviduara publike** | |
|---|---|---|---|---|
| | Programi Vjetor - 2021 | Programi Vjetor - 2020 | Programi Vjetor - 2021 | Programi Vjetor - 2020 |
| Buxheti Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut | 217.686 | 161.101 | 12.693 | 2.535 |
| Buxhetet e fondeve | 121.805 | 109.548 | 115.718 | 107.048 |
| Buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale | 3.393 | 2.048 | 2.829 | 1.651 |
| Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së | 782 | 555 | 773 | 552 |
| Partitë politike | 397 | 642 | 294 | 550 |
| Ndërmarrjet publike | 1.744 | 303 | 1.953 | 292 |
| Institucionet tjera/Personat juridik në të cilat shteti është aksioner | 13.939 | 1.317 | 15.220 | 1.134 |
| Të përfshira me revizionin e pajtueshmërisë | 57.299 | 395 | 7.022 | 807 |
| Të përfshira me revizionin e suksesit | 94.878 | 71.386 | 79.558 | 69.863 |

Programi Vjetor - 2021    Programi Vjetor - 2020    (në milionë denarë)

# REKOMANDIMET
DHE ZBATIMI I TYRE

## 2021

**654**
REKOMANDIMET
E DHËNA:

- **300** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE;

- **354** REKOMANDIME PËR TË CILAT NUK KA SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE;

- **93** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE NUK ËSHTË PËRCAKTUAR STATUSI

**88%**
ËSHTË
VEPRUAR SIPAS
REKOMANDIMEVE;

**207**
REKOMANDIME
ME STATUS TË
PËRCAKTUAR

**182** REKOMANDIME PËR TË CILAT JANË NDËRMARRË MASA;

**23** nuk janë zbatuar;

**2** të pazbatueshme;

# 2020

**604** REKOMANDIMET E DHËNA

- **604** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE

**542** REKOMANDIME ME STATUS TË PËRCAKTUAR

**81%** ËSHTË VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE

- **62** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE NUK ËSHTË PËRCAKTUAR STATUSI

**439** REKOMANDIME PËR TË CILAT JANË NDËRMARRË MASA

**90** nuk janë zbatuar

**13** të pazbatueshme

# 2019

**498** REKOMANDIMET E DHËNA

- **498** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE

**441** REKOMANDIME ME STATUS TË PËRCAKTUAR

**83%** ËSHTË VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE

- **57** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE NUK ËSHTË PËRCAKTUAR STATUSI

**364** REKOMANDIME PËR TË CILAT JANË NDËRMARRË MASA

**73** nuk janë zbatuar

**4** të pazbatueshme

# PROCESI I REVIZIONIT



# 1

## PËR ENTIN SHTETËROR TË REVIZIONIT

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është Institucion Suprem i Pavarur i Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila më shumë se 20 vite i informon institucionet kompetente dhe publikun në mënyrë transparente, në kohë dhe në mënyrë objektive për gjetjet e revizorëve nga revizionet e kryera. Enti Shtetëror i Revizionit është themeluar në vitin 1997 me miratimin e Ligjit për revizion shtetëror. Revizionet e para janë kryer në vitin 1999.

Si institucion suprem i revizionit, ESHR revizionin e kryen në përputhje me udhëzimet, standardet dhe parimet e revizionit të përfshira në kornizën e njoftimeve profesionale të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI), ku kualifikimet e larta profesionale dhe trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve janë baza e punës.

Pavarësia e institucionit është përcaktuar me Ligjin për revizion shtetëror, në të cilin janë rregulluar kompetencat e ESHR-së, është përcaktuar mandat i gjerë në kryerjen e revizioneve të rregullshmërisë dhe të suksesit, me qasje në të gjitha informacionet e nevojshme, dokumentacionet, evidencat për zbatimin e revizionit shtetëror. ESHR në mënyrë të pavarur e përcakton Programin Vjetor të Punës, në mënyrë objektive vendos për subjektet lëndë të revizionit dhe mënyrën, përmbajtjen e njoftimit nga revizionet e kryera, pa anshëm dhe i lirë nga ndikimet e pushteti legjislativ dhe ekzekutiv.

Në të njëjtën kohë, ESHR si dhe institucionet e tjera supreme të revizionit kanë rol të rëndësishëm në luftën për parandalimin e korrupsionit dhe me punën e saj është përfshirë në aktivitete të lidhur me këtë fushë, e cila kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjeteve dhe pronën publike nga aktivitetet të paautorizuar dhe të paligjshëm.

Enti Shtetëror i Revizionit është i njohur sipas vlerave të cilat janë vendosur në institucion, të cilat i kultivon dhe i plotëson dhe si vijon:

aftësi profesionale;

kryerjen e detyrave të punës me përgjegjësi;

puna në ekip, etikë profesionale dhe ndërgjegjes;

integritet dhe

pavarësia e revizorëve të autorizuar shtetëror dhe revizorëve shtetëror në lidhje me subjektet e revizionit, institucioneve shtetërore dhe shfrytëzuesve tjerë të mjeteve publike.

## MISIONI

Enti Shtetëror i Revizionit është Institucioni Suprem i Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut i cili synon të informojë me kohë dhe në mënyrë objektive Kuvendin, Qeverinë, bartësit tjerë të funksioneve publike dhe publikun për gjetjet revizorëve nga revizionet e zbatuara. ESHR siguron mbështetjen e Kuvendit të RMV-së në përmbushjen e kompetencave të saj përmes identifikimit dhe paraqitjes së parregullsive, rasteve të punës të paligjshme dhe rasteve të mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimin e funksionit. Përmes rekomandimeve të qarta dhe efektive, ESHR-ja siguron mbështetjen e institucioneve shtetërore dhe shfrytëzuesit e mjeteve publike për avancimin menaxhimit të tyre. Në këtë mënyrë, ESHR kontribuon në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## VIZIONI

Për ta përmbushur me sukses qëllimin tonë – mbajtjen e përgjegjësisë për mjetet publike dhe të kontribuojmë për avancimin e menaxhimit me to, vizioni jonë është që duhet të sigurojmë vazhdimisht cilësi në punën tonë me të cilën do të ruanim epitetin e një partneri të pavarur dhe profesional me integritet të lartë ku në të njëjtën kohë është bartës i progresit në menaxhimin me mjetet publike, llogaridhënies dhe transparencës në shfrytëzimin e tyre.

## OBJEKTIVAT

Duke i pasur parasysh kompetencat ligjore të ESHR-së, aktet nënligjore dhe dokumentet strategjike, në drejtim të realizimit të misionit dhe vizionit të ESHR-së janë përcaktuar objektivat në vijim:

- sigurimi i pavarësisë së revizionit shtetëror si kategori kushtetues, në pajtim me principet e Deklaratës së Meksikës;
- arritjen e numrit të përshtatshëm të të punësuarve dhe harmonizimin e strukturës organizativ dhe numrit të përgjithshëm të zbatuesve me kompetenca dhe objektiva strategjike të ESHR-së;
- avancimin e etikës dhe integritetit;
- ngritje e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së kryerjes së revizionit në pajtim me standardet e revizionit dhe praktikat metodologjike të revizionit shtetëror;
- përgatitja dhe përditësimi i akteve metodologjike për revizionin;
- implementimi i vazhdueshëm i sistemit elektronik për menaxhim me revizionin - Audit Management System – AMS (AMS);
- do të vazhdon praktika për sigurimin e cilësisë së revizionit, përmes zgjedhjes së revizionit të cilët do të jenë lëndë e kontrollit, me qëllim që të përmirësohet cilësia e punës;
- ndërtimin e bashkëpunimit me institucionet kompetente në luftë kundër korrupsionit dhe konflikt të interesit.

# KORNIZA JURIDIKE, DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE METODOLOGJIKE

## 1.1. KORNIZA JURIDIKE

Në lidhje me kornizën juridike për revizionin shtetëror në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" nr. 122 nga 03.06.2021 është botuar Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për revizion shtetëror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/10, 145/10, 145/10, 12/14, 43/14, 154/15, 192/15, 27/16 dhe 83/18), me të cilën është kryer ndryshimi i Ligjit për revizion shtetëror për shkak të emrit kushtetues të shtetit, ndërsa gjithashtu kryhet edhe pajtueshmëria e dispozitave kundërvajtëse me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

Në Programin Nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) Revizioni 2021 - 2025 të miratuar nga Qeveria e RMV-së, në Kapitullin 3.32. Kontrolli financiar, në lidhje me fushën e revizionit të jashtëm, si prioritet afatshkurtër është përcaktuar të punohet në përmirësimin e kornizës ligjore për të forcuar pavarësinë kushtetuese, financiare dhe operative të ESHR-së dhe do të hartohet dhe propozohet Ligj i ri për revizionin shtetëror i cili do të harmonizohet me standardet ndërkombëtare të ISR-së dhe praktikën e pranuar ndërkombëtare.

Forcimi i kornizës juridike për revizionin e jashtëm me arritjen e pavarësisë kushtetuese të ESHR-së dhe forcimi i pavarësisë financiare dhe operative në përputhje me parimet, standardet dhe udhëzimet e INTOSAI-t duke hartuar draft-ligj të ri për revizionin shtetëror dhe dorëzimin e tij në Kuvendin e RMV-së janë përcaktuar si masa dhe aktivitete primare në përputhje me Draft-Programin për reformën e menaxhimit me financat publike "SMART PUBLIC FINANCE" 2022 - 2025 dhe Draft-Planin e Veprimit për zbatimin e Programit për reformën e menaxhimit me financat publike për vitin 2022.

Me qëllim të përmirësimit të kornizës juridike për revizion shtetëror për shkak të arritjes së pavarësisë kushtetuese të ESHR-së dhe forcimit të pavarësisë operative dhe financiare në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të BE-së, në kuadër të Tvining Projektit **"Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare"**, është përgatitur vlerësimi i kornizës juridike për revizionin shtetëror dhe janë dhënë rekomandimet për të fituar pavarësinë kushtetuese dhe forcimin e pavarësisë operative dhe financiare të ESHR-së.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve, me mbështetjen e Tvining Projektit në vitin 2021 janë hartuar:

- Propozimet për draft-amendamentet për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës së RMV-së për rregullimin e ESHR-së si kategori kushtetuese;
- Propozimi i ri i Ligjit për revizion shtetëror me qëllim të forcimit të pavarësisë financiare dhe operative të ESHR-së.

Në kuadër të aktiviteteve të Tvining Projektit është kryer vlerësimi edhe i ligjit në lidhje me revizionin e financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore, prokurimeve publike dhe Ligjit të ri për buxhetin, të cilat janë të lidhura me kornizën ligjore për revizionin shtetëror, me qëllim që të jepen propozime për harmonizimin dhe përmirësimin e tyre.

Me mbështetjen e Tvining Projektit u zbatua vlerësimi dhe u dhanë propozime për të përmirësuar kornizën juridike të ESHR-së dhe Kuvendit të RMV-së për dorëzimin dhe shqyrtimin e raporteve të revizorit.

## 1.2. DOKUMENTET STRATEGJIKE

Zhvillimi i dokumenteve strategjike është një nga hapat kryesorë në zhvillimin e ISR-së dhe realizimin e vizionit, misionit dhe objektivave të tij. Në Raportin Vjetor të Progresit të RMV-së së Komisionit Evropian në lidhje me zonën e revizionit të jashtëm, i cili është nën kompetencën e ESHR-së, vuri në dukje aspektet që kanë nevojë për përmirësim në lidhje me:

- pavarësia e Entit Shtetëror të Revizionit të garantohet me Kushtetutën e RMV-së;
- korniza juridike në masë të madhe është në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI);
- revizioni i suksesit të përmirësohet më shumë;
- rekomandimet e përfshira në raportet e revizionit të ESHR-së të zbatohen në kohë dhe sistematikisht nga institucionet e reviduara;
- monitorimi dhe mbikëqyrja e Kuvendit të RMV-së të rritet nëpërmjet shqyrtimit të raporteve të ESHR-së me qëllim që të përmirësohet niveli i rekomandimeve të zbatuara.

Duke vepruar në përputhje me rekomandimet e dhëna dhe duke ndërmarrë aktivitete në drejtim të qëllimeve të përcaktuara, ESHR-ja vazhdon të ndërmarrë aktivitete për zbatimin e përhershëm por edhe zhvillimin dhe miratimin e dokumenteve të rinj strategjike si vijon:

- Strategjia për zhvillimin e ESHR-së 2018 – 2022;
- Strategjia e TI-së së ESHR-së 2018 – 2022;
- Strategjia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore 2020 – 2023;
- Strategjia e Komunikimit e ESHR-së 2020 – 2023
- Strategjia për Menaxhim me Rreziqet e ESHR-së 2020-2023;
- Udhëzimi për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve;
- Vendimet për vendosjen e objektivave strategjike për revizionet e ESHR-së për periudhën 2021 - 2023 dhe për fushat prioritare për revizionet e sektorëve që kryejnë revizion dhe
- Plani strategjik për revizion të viteve 2021 – 2023.

Në Strategjinë për zhvillimin e Entit Shtetëror të Revizionit 2018-2022, përshkruhen përpjekjet për të forcuar pavarësinë dhe integritetin që janë parakushtet për arritjen e profesionalizmit dhe besueshmërisë në punë, për të promovuar dhe përmirësuar implementimin e parimeve, standardeve dhe udhëzimeve ndërkombëtare të përfshira në kornizën e njoftimeve profesionale të INTOSAI, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të efekteve të revizioneve të kryera dhe shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të përfshira në raportet e revizionit. Implementimi vjetor i strategjisë për zhvillim të Entit Shtetëror të Revizionit zbatohet në përputhje me aktivitetet e përcaktuara në Programin Vjetor për punën e ESHR-së për vitin 2021.

Për shkak të përmirësimit strategjik dhe planifikimit vjetor të ESHR-së në kuadër të aktiviteteve të Tvining projektit në vitin 20201 janë përgatitur propozime për strategji të ri për zhvillimin e ESHR-së për periudhën pes vjeçare me plan veprim për zbatimin e tyre.

Në vitin 2021, u zbatuan aktivitetet për realizimin e Strategjisë së TI-së së Entit Shtetëror të Revizionit 2018-2022, me qëllim që të rritet efikasiteti i sistemit të informacionit të Entit Shtetëror të Revizionit dhe njëherazi të kontribuojë në implementimin e strategjisë për zhvillimin e Entit Shtetëror të Revizionit 2018-2022, në pjesën e riorganizimit të fushës së strukturës ekzistuese në përputhje me aktet e ri për organizimin dhe sistematizimin e ESHR-së, mbështetje në avancimin dhe administrimin

e Sistemit për Menaxhim me Revizionin [Audit Management System (AMS)] dhe Softver për analizën e të dhënave të raporteve të revizorit, gjetjet dhe rekomandimet (SAPRI).

Janë ndërmarrë aktivitete për mbështetjen e revizionit në fushën e marrjes dhe përpunimit të bazës së të dhënave të subjektit që është lëndë e revizionit, nëpërmjet përdorimit të teknikave të revizorit të ndihmuar me kompjuter –CAAT's dhe janë prokuruar licenca të reja për softverin IDEA për të analizuar të dhënat, për të zgjedhur mostrën dhe dokumentimin e tij. Procedurat dhe politikat e TI-së implementohen në vazhdimësi, procedurat për përdorimin e Sistemit për Menaxhim me Revizionin (AMS) dhe standardet ISO 9001.

Për realizimin e Strategjisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në ESHR 2020-2023, janë ndërmarrë aktivitete për implementimin e funksionit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ESHR, me qëllim të ndërtimit të sistemit funksional dhe efikas nëpërmjet sigurimit të kushteve për punësimin e personave profesionistë dhe cilësorë me shkallë të lartë të integritetit, të cilët janë të gatshëm për të kryer në mënyrë efektive funksionet dhe kompetencat e caktuara. Gjithashtu, promovohet zhvillimi i cilësive profesionale i punonjësve dhe vendosja e sistemit real të vlerësimit të suksesshëm në punë, nëpërmjet procedurave të drejta dhe transparente për zhvillimin profesional dhe kreativ të punonjësve, si dhe vendosjen e materialeve plotësuese dhe stimulimeve të tjera për punonjësit.

ESHR-ja vazhdon bashkëpunimin me Fondacionin për Demokraci Vestminster (WFD) në kuadër të projektit me titull "Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në Maqedoni nëpërmjet zbatimit të përmirësuar të rekomandimeve të ESHR-së", të përkrahur nga Qeveria Britanike. Aktivitetet kanë të bëjnë me implementimin e dy fazave të mbetura nga projekti në lidhje me Strategjinë e Komunikimit të ESHR-së për vitet 2020-2023, duke u fokusuar në bashkëpunimin dhe komunikimin e ESHR-së me institucionet kompetente – Prokurorinë Publike të RMV-së dhe Kuvendin e RMV-së dhe organizatat joqeveritare.

Udhëzimet për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve është bazë për përgatitjen e vendimit për caktimin e qëllimeve strategjike për revizionet e ESHR-së për periudhën 2021-2023 dhe për fushat primare për revizionet e sektorëve të cilët kryejnë revizion, si dhe për përgatitjen e planit strategjik për revizionin e ESHR-së për periudhën 2021-2023 të miratuar në dhjetor të vitit 2020. Në bazë të dokumenteve strategjike të lartpërmendura për revizionet u përgatit Programi Vjetor i Punës së ESHR-së për vitin 2021.

Në përputhje me Planin e Veprimit për vitin 2021 për zbatimin e programit për reformën e menaxhimit me financat publike, janë zbatuar aktivitetet që janë në lidhje me **prioritetin 7: Kontrolli i jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare,** e cila është në kompetencat e Entit Shtetëror të Revizionit. Qëllimi i këtij prioriteti është forcimi i menaxhimit me financat publike nëpërmjet sigurimit të llogaridhënies në përdorimin e mjeteve publike nëpërmjet forcimit të revizioneve të rregullshmërisë dhe të suksesit të ESHR-së në përputhje me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit dhe dokumenteve strategjike të ESHR-së, duke vendosur mekanizëm për rishikimin e rolit proaktiv të raporteve të revizorit në Kuvendin e RMV-së dhe forcimin e kapacitetit institucional dhe kapacitetit të burimeve njerëzore në ESHR.

Kryerevizori shtetëror, në mënyrë aktive mori pjesë në punën e Këshillit për Menaxhimin me Financat Publike, i cili paraqet trup koordinues të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për të monitoruar zbatimin e reformave për menaxhimin me financat publike të parapara me programin për reformat e menaxhimit me financat publike 2018 – 2021.

## 1.3. DOKUMENTET METODOLOGJIKE

Në kuadër të Tvining Projektit "Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare", në vitin 2021 u përgatitën aktet metodologjike të përmirësuara për revizionin e suksesit, revizioni i TI-së, udhëzimet për revizionin e fondeve të BE-së dhe zbulimi i mashtrimit dhe parregullsive dhe rekomandimeve për përmirësimin e monitorimit për zbatimin e rekomandimeve të revizionit.

Gjithashtu, u përgatit rregullorja e re për revizionin e pajtueshmërisë, duke u bazuar në rekomandimet nga Tvining Projekti i mëparshëm i financuar nga fondet IPA 2013. Në kuadër të Tvining Projektit është harmonizuar Rregullorja për revizionin e TI-së me "GUID 5100 - Udhëzimi për revizionin e sistemeve të informacionit".

Si rezultat i aktiviteteve të Tvining Projektit, janë përgatitur propozimet për përmirësimin e strukturës dhe përmbajtjes së Raportit Vjetor të ESHR-së, ndërsa në drejtim të përmirësimit të komunikimit të brendshëm në ESHR, janë hartuar draft-rregullat për rrjedhën e brendshme të dokumenteve të printuara dhe elektronike.

Si rezultat i bashkëpunimit me OECD-SIGMA në fushën e revizionit të buxhetit të shtetit, në periudhën e kaluar janë përgatitur draft-udhëzimet për revizionin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me Tvining Projektin në vitin 2021 janë bërë analiza me përgatitjen e rekomandimeve për përmirësimin e procesit të revizionit të Llogarisë Vjetore të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me qëllim të përmirësimit të prezantimit të rezultateve dhe rekomandimeve të revizionit, në kuadër të Tvining Projektit të ri është përgatitur struktura dhe përmbajtja e re e raporteve të revizionit në përputhje me ISSAI.

Nga trupi i certifikimit më 27.05.2021 është kryer kontrolli i tretë i ricertifikimit, për të cilin është përgatitur raporti i kontrollit, në përputhje me të cilin sistemi i menaxhimit të Entit Shtetëror të Revizionit është plotësisht në harmonizim me kërkesat e standardit MKS EN ISO 9001. : 2015, gjatë të cilit është vazhduar vlefshmëria e certifikatës me të cilën vërteton se ESHR-ja e zbaton Sistemin e Menaxhimit në përputhje me kërkesat e standardit ISO me vlefshmëri deri më 30.05.2024.

Raporti Vjetor për revizionet dhe punën e kryer të ESHR-së për vitin 2020 është përgatitur dhe dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në afatin e përcaktuar me ligj deri në fund të qershorit 2021 dhe gjithashtu është i disponueshëm në faqen e internetit të ESHR-së në tri gjuhë: në gjuhën maqedonase, gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze;

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e 54-t e shqyrtoi dhe miratoi Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2020 dhe më pas miratoi konkluzionet të cilat së bashku me Raportin e Komisionit për Financim dhe Buxhet i dorëzuan Qeverisë së RMV-së, Ministrisë së Financave dhe Entit Shtetëror të Revizionit.

Është krijuar praktikë për disponueshmërinë e informacioneve dhe të dhënave të përfshira në Raportin Vjetor për revizionet dhe punët e kryera të ESHR-së për institucionet supreme të revizionit, Gjykatën Evropiane të Revizorëve, INTOSAI dhe EUROSAI, Delegacionin e Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, misionet e organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësitë e caktuara diplomatike në RMV.

ESHR-ja ka zbatuar Programin Vjetor të Punës për vitin 2021, të përgatitur në bazë të Planit Strategjik të Revizionit 2021 - 2023, në përputhje me Udhëzimet e miratuara për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizionit dhe Vendimin për përcaktimin e objektivave strategjike për revizionet e Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën 2021 - 2023 dhe për fushat primare për revizionet sipas sektorëve të cilët kryejnë revizione.

Enti Shtetëror i Revizionit, duke ndjerë nevojën për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë në kryerjen e kompetencave të deleguara me ligj për herë të parë në ekzistencën e tij në kuadër të përgatitjes së Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021, ka dorëzuar raport deri mbi 190 faqe përkatëse dhe në të njëjtën kohë e ka publikuar në faqen e saj të internetit formularin "Njoftimi për paraqitjen e kërkesës për revizion te ESHR-ja" https://dzr.mk/contact/barane_za_revizija. Si rezultat i kërkesave të marra nga palët e interesuara për revizionin e subjekteve të caktuara, Enti Shtetëror i Revizionit në Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021 ka përcaktuar revizionin e suksesit me titull "Efektiviteti i masave të Qeverisë së RMV-së

për barazi gjinore dhe nismën buxhetore gjinore përkatëse", ndërsa në 4 (katër) revizione të suksesit do të përfshihen edhe aspekti i nismës buxhetore gjinore.

Programi Vjetor i Punës në vitin 2021 përmban 9 revizione të suksesit. Me fushat që janë përfshirë me revizion të suksesit ESHR-ja duhet të sigurojë kontribut aktiv nëpërmjet dhënies së rekomandimeve organeve kompetente në lidhje me punën e tyre dhe përdorimin e fondeve publike, çështjeve shëndetësore dhe sociale, burimeve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Për t'u dalë në ndihmë sfidave për shkak të pandemisë KOVID-19, Programi Vjetor i Punës së ESHR-së për vitin 2021 përmban 4 revizione të suksesit të masave ekonomike të qeverisë, menaxhimi dhe huamarrja shtetërore me borxhin publik, mbështetja për punësim për profesionet më të prekura nga pasojat e pandemisë, si dhe masat dhe politikat për mbështetjen e sektorit të turizmit.

Në vitin 2021, ESHR-ja ka përgatitur Planin Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2021, me të cilat janë paraparë masat dhe aktivitetet në lidhje me parandalimin e korrupsionit në nivel të institucionit, ndërsa njëherazi ka përgatitur program të veçantë të revizionit për harmonizimin e punës së subjekteve që janë lëndë e revizionit në fushën e mbrojtjes së qasjes së lirë dhe sinjalizues të informacioneve me karakter publik, me të cilat janë siguruar udhëzimet e përditësuara dhe mjetet e reja metodologjike për revizorët gjatë kryerjes së këtij aspekti të rëndësishëm të revizioneve.

Gjatë vitit 2021, ESHR-ja mori pjesë në grupin e punës ndërkombëtar që ka për synim përgatitjen e Udhëzuesit për Praktikat e Revizionit të Barazisë Gjinore në Ballkanin Perëndimor, si akt metodologjik për kryerjen e revizionit me bazë gjinore në kuadër të projektit "Promovimi i politikave dhe buxheteve të përgjegjshme gjinore: drejt menaxhimit transparent, gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut", e cila mbështetet financiarisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar – SIDA, ndërsa zbatohet nga UN Women. Ky udhëzues pritet të përgatitet në vitin 2022.

ESHR-ja ka zbatuar Planin Vjetor për zhvillim dhe trajnim të vazhdueshëm profesional për vitin 2021, ndërsa në muajin dhjetor 2021, ESHR-ja ka miratuar Planin Vjetor për zhvillimin e vazhdueshëm profesional për vitin 2022 si dhe Planin Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022, të cilat janë publikuar në faqen e internetit të ESHR-së[1,2].

Enti Shtetëror i Revizionit në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për revizion shtetëror në afatin ligjor dorëzoi në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2022[3] me të cilin është planifikuar të kryhen gjithsej 183 revizione nga të cilat 166 revizione të rregullshmërisë, 12 revizione të suksesit dhe 5 revizione të pajtueshmërisë. Nga totali i revizioneve të planifikuara, 45 revizione u referohen subjekteve dhe temave për revizion në përputhje me Ligjin për revizion shtetëror, ndërsa 142 revizione u referohen subjekteve që kanë marrë pjesë në Zgjedhjet Lokale 2021. Gjatë përcaktimit të revizioneve të suksesit me këtë Program Vjetor, si kriter janë marrë synimet strategjike të ESHR-së, qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së, kriteret e përcaktuara me metodologjinë për vlerësim nga OECD-SIGMA.

Si pjesë e aktiviteteve në kuadër të Tvining Projektit "Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrjes parlamentare", delegacione të nivelit të lartë nga ESHR-ja e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ESHR-ja e Republikës së Kroacisë morën pjesë në takim me Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut z. Talat Xhaferi për prezantimin e përgatitur të draft-Memorandumit për Bashkëpunim mes Kuvendit dhe ESHR-së, duke theksuar nevojën e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, veçanërisht për shqyrtimin dhe veprimin sipas raporteve të dorëzuara të revizorëve.

1 https://dzr.mk/sites/default/files/2022-01/Godisen_plan_kontinuirano_profesionalno_usovrsuvanje_2022_godina.pdf

2 https://dzr.mk/sites/default/files/2021-12/Godisen_plan_sprecuvanje_korupcija_DZR_2022_godina.pdf

3 https://dzr.mk/sites/default/files/2021-12/Godisna_programa_za_rabota_DZR_2022_godina.pdf

# 2

# Transparenca **dhe bashkëpunimi**

## 2.1.TRANSPARENCA NË PUNËN E ESHR-së

Gjatë vitit 2021, ESHR-ja ka vazhduar të forcojë përpjekjet e saj për të intensifikuar aktivitetet që synojnë rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në punën e saj. Informimi profesional dhe në kohë i të gjitha palëve të interesuara të jashtëm (media, gazetarë hulumtues, organizata qytetare, publiku i gjerë) për rezultatet e arritura nga kryerja e revizionit shtetëror është një nga përcaktimet më të rëndësishme strategjike të ESHR-së në vitin 2021. Të udhëhequr nga përcaktimet strategjike të cilat janë të theksuara në "Strategjinë e Komunikimit të ESHR-së 2020-2023", qëllimi i ESHR-së ishte të nxisë komunikimin në të cilin mediat, qytetarët dhe organizatat qytetare do të jenë bashkëpunëtorë në arritjen e qëllimeve për rritjen e transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies në veprimet e subjekteve të sektorit publik për mënyrën e përdorimit të fondeve publike. Bashkëpunimi mes ESHR-së dhe mediave, organizatave qytetare dhe gazetarëve u zhvillua nëpërmjet njoftimeve, përgjigjeve në pyetjet e parashtruara dhe pjesëmarrjes në emisionet debatuese. Gjithashtu, u forcua edhe mënyra e informimit të vazhdueshëm dhe në kohë të palëve të interesuara të jashtëm nëpërmjet publikimit të raporteve përfundimtare të revizionit në faqen e internetit të ESHR-së, dorëzimin e njoftimeve për shtyp dhe publikimin e Abstraktit të raportit të revizionit në të cilën përmbahen gjendjet kryesore të përcaktuara deri në të gjitha palët e interesuara 190 në vitin 2020, gjegjësisht 380 në vitin 2021.

Si rezultat i aktiviteteve të ndërmarra në vitin 2021 në drejtim të forcimit të komunikimit dhe bashkëpunimit me palët e interesuara për informimin dhe prezantimin e rezultateve nga kryerja e revizionit shtetëror, Enti Shtetëror i Revizionit ka përmirësuar ndjeshëm transparencën, dukshmërinë dhe llogaridhënien ndaj publikut dhe qytetarëve.

Informimi objektiv, në kohë dhe i saktë për publikun dhe mediat, organizatat qytetare dhe institucionet kompetente, edhe në vitin 2021 ishte prioritet i rëndësishëm strategjik i Entit Shtetëror të Revizionit, një nga parimet themelore të theksuara në Strategjinë e Komunikimit të ESHR-së 2020 - 2023.

## TRENDI NË RRITJE I „LISTËS SË MEJLINGIT TË ESHR-SË“

Në fillim të vitit 2020, ESHR-ja hartoi "Listën e mejlingut të palëve të interesuara" me 190 kontakte fillestare. Gjatë vitit 2021 lista është përditësuar vazhdimisht me kontakte të reja, kështu që nga numri fillestar në mesin e vitit 2021, ESHR-ja kishte listë prej 380 palë të interesuara, dhe në fund të vitit dhe në fillim të vitit 2022 numri i palëve të interesuara arriti në 930 palë të interesuara. Të gjithëve ESHR-ja në vazhdimësi u dërgonte dhe i informonte për rezultatet e punës së saj me Raportet Përfundimtare të Revizionit, njoftim për opinionin dhe mediat dhe abstrakt për secilin raport financiar.

Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2021, ESHR-ja e tregoi përkushtimin dhe angazhimin e saj për përfshirje më të madhe të palëve të interesuara dhe shfrytëzuesve të raporteve të revizionit.

## **LISTA-MEJLING** E ESHR-SË DHE KOMUNIKIMI ME PALË TË **JASHTME** TË INTERESUARA




## **LISTA-MEJLING MEJLING** E ESHR-SË DHE KOMUNIKIMI ME **930 PALË TË JASHTME** TË INTERESUARA

që nga prilli 2022



## SHFAQJET TELEVIZIVE, BASHKANGJITJET INFORMATIVE, DEBATET E HAPURA

Përpjekjet e Entit Shtetëror të Revizionit për të qenë i hapur për publikun, mediat dhe sektorin civil dhe për të prezantuar aktivitetet dhe rezultatet nga kryerja e revizionit shtetëror janë të dukshme gjatë vitit 2021. Kjo duket nga të dhënat për shfaqjet televizive të kryerevizorit shtetëror dhe zëvendëskryerevizorit shtetëror në televizionet nacionale. Pjesëmarrësit me shfaqjet e tyre në interes të prezantimit të rezultateve të punës së ESHR-së në vitin 2021, nëpërmjet paraqitjeve si mysafir dhe deklaratave të shkurtra në edicionet ditore informative të mediave, kishin këshilltarët dhe ndihmësit e kryerevizorit shtetëror. Gjatë vitit 2021 janë evidentuar gjithsej 9 intervista dhe deklarata për edicionet ditore informative të mediave, nga menaxhmenti i Entit Shtetëror të Revizionit.

## KLIPINGU I REZULTATEVE TË ESHR-SË

Rritja e interesit për punën dhe rezultatet e Entit Shtetëror të Revizionit dhe përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me përfaqësuesit e mediave dhe sektorin civil, vihet re përmes të dhënave statistikore dhe vlerësimit të njoftimeve në media (cliping) në lidhje me publikimet e raporteve përfundimtare të revizionit dhe pyetjet e parashtruara gazetareske për revizionet në vazhdim dhe publikimi i raporteve përfundimtare të revizionit.

Në fakt, gjatë vitit 2021, te Enti Shtetëror i Revizionit janë dorëzuar 11 pyetje gazetareske, të cilave u është dorëzuar përgjigje në kohën më të shkurtër të mundshme për informacionin e kërkuar. Gjithashtu, punonjësit e Departamentit për Marrëdhënie me Publikun dhe Informimit të Rezultateve për revizionin shtetëror, në vazhdimësi i informojnë përfaqësuesit e mediave dhe organizatave qytetare për çështjet dhe dilemat që lindin në kuadër të punës së revizionit dhe raporteve përfundimtare të revizionit të publikuara.

Aktivitetet e ESHR-së u përfaqësuan në mediat nacionale dhe lokale. Si rezultat i këtyre aktiviteteve gjatë vitit 2021 janë regjistruar gjithsej 421 njoftime, nga të cilat 81 njoftime në televizionet nacionale dhe 340 njoftime në portalet e internetit, për publikimet e raporteve përfundimtare të revizionit dhe aktivitetet e tjera të ESHR-së.

# **ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT DHE** MARRËDHËNIET ME **MEDIUMET**

31.12.2021

**421** NJOFTIME TË MEDIUMEVE PËR RAPORTET PËR-FUNDIMTARE TË REVIZIONIT

**81** NJOFTIME JANË TRANSMETUAR NGA ANA E TELEVIZIONEVE

**340** NJOFTIME JANË PUBLIKUAR NGA ANA E PORTALEVE TË INTERNETIT

**9** INTERVISTA DHE DEKLARATA PËR MEDIUMET

## ËSHTË HAPUR FAQJA E FACEBOOKUT TË ESHR-SË

Si aktivitet i planifikuar në procesin e zbatimit të Strategjisë së Komunikimit të ESHR-së më 17 nëntor 2021 është hapur dhe promovuar faqja zyrtare e Facebookut e Entit Shtetëror të Revizionit. Përmes tij, qytetarët dhe të gjithë palët e interesuara kanë mundësinë të informohen për aktivitetet dhe rezultatet e arritura nga kryerja e revizionit shtetëror. Njëherazi, ky mjet i ri komunikimi i ESHR-së është hapësirë për diskutime dhe shkëmbim mendimesh kreative dhe konstruktive.

Në periudhën nga hapja e sajë deri më 31.12.2021, në faqen e ESHR-së në Facebook janë shënuar mesatarisht 518 vizita në ditë.




Në drejtim për të rritur dukshmërinë e efekteve të revizioneve të kryera dhe aktiviteteve të ndërmarra për punën rrjedhëse të ESHR-së, janë ndërmarrë aktivitete plotësuese për promovimin e mediave sociale të cilat i përdor ESHR-ja. Kështu, në katër muajt e parë të vitit 2022 (01.01.2022 - 31.04.2022), në faqen e Facebookut të ESHR-së janë shënuar mesatarisht 1.394 vizita në ditë, që është rritje prej 269% krahasuar me vizitën ditore në vitin 2021.

## KANALI YOU TUBE

Gjatë vitit 2021 janë ndërmarrë aktivitete për përditësimin në kohë të përmbajtjes së kanalit YouTube të ESHR-së me të gjitha video përmbajtjet nga vizitat e RKSH, ZRKSH dhe punonjësve të tjerë në ESHR. Këto përmbajtje janë promovuar edhe përmes profilit në Facebook të ESHR-së.

## RRITJA E VIZITËS SË FAQËS SË INTERNETIT

Aktivitetet e ndërmarra për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së ESHR-së, përditësimi dhe plotësimi i vazhdueshëm i listës së mejlingut, dhanë rezultate të dukshme në vitin 2021. Informimi i të gjitha palëve të interesuara për aktivitetet e revizionit dhe raportet përfundimtare të revizionit të publikuara, ka kontribuar në rritjen e vizitës së faqes së internetit të Entit Shtetëror të Revizionit krahasuar me vitin 2020.

Njëherazi nëse në vitin 2020 mesatarisht në faqen e ESHR-së janë regjistruar rreth 4000 vizitorë dhe 20500 përmbajtje të shkarkuara në muaj, gjatë vitit 2021 janë regjistruar 8600 vizitorë dhe 39000 përmbajtje të vizituara mesatarisht në muaj, që është përmirësim 100% i të dhënave statistikore për vizitën në faqen zyrtare të ESHR-së.

# VIZITA NË FAQËN E INTERNETIT **WWW.DZR.MK**



## PËRMBAJTJET E VIZITUARA NË **WWW.DZR.MK**




## ANKETA PUBLIKE - SHKALLA E KËNAQËSISË

Enti Shtetëror i Revizionit kryen anketën publike në vazhdimësi si mjet për të hulumtuar mendimin dhe ndikimin në punën e ESHR-së te palët e interesuara.

Me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe të forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe dukshmërisë në punën e saj, Enti Shtetëror i Revizionit dërgoi pyetësor/anketë për shkallën e kënaqësisë nga bashkëpunimi me ESHR-në dhe informacion për punën e institucionit tonë për të gjithë 930 palët e interesuara si në vijim: 558 institucione, 322 media dhe 50 organizata qytetare. Sipas strukturës së përgjigjeve të marra në lidhje me çështjen e kënaqësisë nga bashkëpunimi me ESHR-në, 90% e të anketuarve janë të kënaqur, duke theksuar se është bërë një hap i madh në aspektin e hapjes dhe bashkëpunimit me ESHR-në, veçanërisht përmes informimit në kohë për raportet e publikuara të revizionit, për aktivitetet e ESHR-së, ndërsa është rritur transparenca ndaj mediave dhe organizatave qytetare. Është shprehur besim i madh në punën e ESHR-së, si e paanshme, e pavarur, ligjore, objektive, transparente dhe profesionale. Nuk mungon kënaqësia me cilësinë e raporteve përfundimtare të revizionit të publikuar, të cilat vlerësohen si aktuale, të kuptueshme, të sakta dhe objektive.







## ESHR-JA NËPËRMJET PUNËS SË VET SIGURON:




## RAPORTET PËRFUNDIMTARE TË REVIZIONIT TË ESHR-SË JANË:



## 2.2. BASHKËPUNIMI ME ASOCIACIONET DHE INSTITUCIONET PROFESIONALE, ORGANIZATAT QYTETARE DHE PUBLIKUN E PËRGJITHSHËM

Me qëllim të arritjes së objektivave të saj strategjike, ESHR-ja edhe në vitin 2021 ka vazhduar praktikën e saj të zhvillimit të bashkëpunimit dhe komunikimit me asociacionet e shumta profesionale, institucionet, duke përfshirë institucionet e arsimit të lartë, organizatat qytetare/joqeveritare, por edhe me opinionin e gjerë.

Njëherazi, ESHR-ja njihet si partner serioz nga këto institucione/organizata nga të cilat mund të marrin informacione dhe analiza të detajuara, për të siguruar shkëmbimin e përvojës, informacioneve dhe njohurive në fushën e lëndës me interes të përbashkët, por edhe për të dhënë kontribut aktiv në mënyrë që të forcojnë efektivitetin e punës së ESHR-së dhe të maksimizojnë ndikimin e raporteve të revizionit, në vendosjen e presionit shtesë ndaj institucioneve për të vepruar në bazë të gjetjeve të raporteve të revizorit. Për këtë qëllim, ESHR-ja iu qas lidhjes së Memorandumeve për Bashkëpunim me çka është siguruar forcimi i bashkëpunimit të ESHR-së me institucionet e theksuara.

**ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT**
MEMORANDUMET PËR BASHKËPUNIM

**4** INSTITUCIONE ARSIMORE

**3** INSTITUCIONE PROFESIONALE

**5** INSTITUCIONE SHTETËRORE

### Institucionet shtetërore / Organizatat profesionale

Enti Shtetëror i Revizionit bashkëpunon me asociacione dhe institucione të shumta profesionale vendase dhe me disa prej tyre ka lidhur memorandume për bashkëpunim, siç janë: Instituti për Revizorët e Autorizuar, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Shtëpia e Kliringut Sistemet Ndërbankare të Kliringut SHA Shkup KIBS, dhe Enti Gjeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në pajtim me memorandumet e lidhura për bashkëpunim me Institutin e Revizorëve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë, duke pasur parasysh se Enti Shtetëror i Revizionit, si institucion suprem i revizionit përpiqet t'i kryej në mënyrë cilësore dhe të vazhdueshme kompetencat ligjore duke siguruar Rregullore për standardet ndërkombëtare për kontroll të cilësisë, revizionit, kontrollit, angazhimeve tjera të bindjes dhe shërbimeve të lidhura - PJESA I, II dhe III e IFAC, ndërsa në të njëjtën kohë të gjithë punonjësit në Entin Shtetëror të Revizionit vizitojnë trajnime virtuale dyditore e cila është pjesë e Planit Vjetor për përmirësim të vazhdueshëm profesional të Institutit të Revizorëve të Autorizuar të RM (IRARM), ndërsa me të cilën janë përfshirë kërkesat më të rëndësishme të standardeve të revizionit dhe zbatimi praktik i tyre.

Në vitin 2021, Enti Shtetëror i Revizionit, bashkë me Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionin dhe Shtëpinë e Kliringut KIBS nënshkruan Memorandum për Bashkëpunim të përbashkët dhe Protokoll për shkëmbimin e të dhënave. Memorandumi u nënshkrua me qëllim të zbatimit të dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe Ligjit për revizion shtetëror, për të siguruar të dhënat e nevojshme nga Regjistri i Vetëm i Llogarive të Transaksioneve (ERTS) për nevojat e mbikëqyrjes së transaksioneve të kryera në fushatën zgjedhore. Me këtë aktivitet janë krijuar kushtet për realizimin e kompetencave, të drejtave dhe detyrimeve të KSHPK-së dhe ESHR-së në kryerjen e mbikëqyrjes dhe revizionit të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore.

Në vitin 2021, ESHR-ja me përfaqësuesit e tyre kontribuuan në përgatitjen e Strategjisë për përmirësimin e sistemit të prokurimeve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022-2026, si dhe në përgatitjen e Strategjisë Nacionale për luftën kundër mashtrimit për të mbrojtur interesat financiare të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022-2025.

Enti Shtetëror i Revizionit në drejtim të ndarjes së aftësive dhe përvojës nga revizionet e kryera në fushën e prokurimeve publike, gjatë vitit 2021 organizoi trajnim me temë në fushën e prokurimeve publike, për nevojat e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

### Institucionet arsimore

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) me Universitetin e Evropës Juglindore, si dhe me Fakultetin Ekonomik në Universitetin Shën Kirili dhe Metodi në Shkup, nënshkruan Memorandum për Bashkëpunim me të cilën shprehën pëlqimin për të bashkëpunuar nëpërmjet inkurajimit dhe afirmimit të fushave me interes të përbashkët, ndërtimit dhe forcimit të lidhjeve të ndërsjella të veprimit, si dhe sigurimit të disponueshmërisë së shkëmbimit profesional të përvojës. Në lidhje me këtë, disa nga objektivat e përbashkëta të dakorduara janë:

- Përgatitja dhe botimet e publikimeve, artikujve, doracakëve dhe komenteve në fushën e revizionit, hartimi i punimeve shkencore;
- Organizimi i forumeve, seminareve dhe punëtorive;
- Zhvillimi i programeve studimore dhe moduleve të trajnimeve;
- Përgatitja e projekteve të përbashkëta për hulumtim;
- Bashkëpunimi me qëllim të lidhjes dhe afrimit të teorisë me praktikën për nevojat e studentëve.

Në lidhje me këto memorandume të lidhura për bashkëpunim gjatë vitit 2021, nga ana e këtyre institucioneve të arsimit të lartë kishin dorëzuar kërkesë për zhvillimin e programeve dhe moduleve studimore në fushën e revizionit të këtyre institucioneve të arsimit të lartë, ndërsa në të njëjtën kohë kishin dorëzuar pyetësorë, të cilët paraqesin bazë për përpilimin e publikimeve, punimeve shkencore ose analizave në fushën e revizionit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm.

### Organizata qytetare

### Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

Në vitin 2021, përfaqësuesit e Entit Shtetëror të Revizionit morën pjesë aktive në aktivitetet e Projektit "Bisedimet kundër Korrupsionit në Parlament", të realizuar nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, i cili synon të mbështesë procesin e reformave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke forcuar rolin mbikëqyrës të Parlamentit në lidhje me antikorrupsionin, duke krijuar

forum për diskutim midis Parlamentit dhe institucioneve që janë pjesë e sistemit kundër korrupsionit, ndërsa të raportojnë për punën e tyre në Parlament, ku do të bëjnë përpjekje dhe angazhime të përbashkëta për të siguruar sistem efikas për luftën kundër korrupsionit, sundimit të ligjit, prokurimeve publike dhe kontrollit financiar. Në këto punëtori pjesëmarrësit shkëmbyen mendimet dhe qëndrimet e veta, me deputetët dhe institucionet me përgjegjësi për luftë kundër korrupsionit në lidhje me planet afatgjate për luftën kundër korrupsionit, ndërmjet bashkëpunimit institucional, si dhe burimet e nevojshme për luftë efikase kundër korrupsionit, me qëllim të has në sfidat e ardhshme në luftën kundër korrupsionit.

### Instituti për Studime të Komunikimit dhe Aleanca për Përfaqësim dhe Lobim

Enti Shtetëror i Revizionit i dha mbështetje fushatës "Bëhu i qartë", të iniciuar nga Instituti për Studime të Komunikimit (ISK) dhe Aleanca për Përfaqësim dhe Lobim, e cila përbëhet nga disa organizata qytetare, media dhe fakultete. Kjo fushatë ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për pjesëmarrjen e tyre në miratimin dhe ndryshimin e politikave publike, si dhe t'i mundësohet dialog më i madh nga institucionet kompetente në procesin e krijimit të politikave. Veprimtaritë e parashikuara në kuadrin e fushatës do të përqendrohen në dy fusha të posaçme siç janë:

- Menaxhimi me burimet e ujit (si të përdoret dhe të mbrohet uji) dhe
- Vendosja e mbikëqyrjes efikase të inspektimit kundër përdorimit të tepruar të burimeve natyrore (lëndët e para minerale, pyjet, toka dhe uji).

Enti Shtetëror i Revizionit si Institucion Suprem i Revizionit, në vazhdimësi zbaton më shumë revizione që përfshin tema në fushën e përdorimit të ujit dhe të drejtën e ujit, si dhe revizione me temat në fushën e mjedisit jetësor dhe përdorimin e burimeve natyrore. Për këto situata, ESHR-ja në vazhdimësi njofton nëpërmjet raporteve përfundimtare të revizionit të publikuara.

### Qendra për Komunikime Qytetare

Enti Shtetëror i Revizionit në zbatimin e revizioneve, vazhdimisht i monitoron procedurat për zbatimin e prokurimeve publike në subjektet të cilat janë lëndë e revizionit dhe i tregon dobësitë dhe dështimet e konstatuara në fazën e planifikimit, realizimit dhe kryerjes së procedurave për prokurime publike.

Në vitin 2021, Enti Shtetëror i Revizionit e vazhdoi bashkëpunimin me Qendrën për Komunikime Qytetare, në fushën e prokurimeve publike në kuadër të projektit "Drejt ndërmarrjave publike llogaridhënëse"' e cila synon ndërtimin e kapacitetit për luftë kundër korrupsionit në ndërmarrjet publike të themeluara nga Qeveria e RMV-së, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Gostivarit, Kavadarit dhe Strugës.

Në këtë drejtim u organizua punëtoria njëditore në hapësirat e ESHR-së të revizorëve nga Enti Shtetëror i Revizionit në të cilën u paraqitën të dhënat nga hulumtimet e zbatuara "Hartëzimi i rreziqeve të korrupsionit në prokurimet publike të ndërmarrjeve në pronësi të qeverisë dhe të komunave". Në të njëjtën kohë punonjësit e ESHR-së, morën pjesë në punëtorinë me temë "Rreziqet e korrupsionit në prokurimet publike te ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të shtetit dhe NJVL-së", me prezantimin e temës "Përmirësimi i procesit të realizimit të marrëveshjeve për prokurimet publike dhe dobësitë kryesore në tërë procesin e prokurimeve publike përmes prizës së Entit Shtetëror të Revizionit".

Në konferencën përmbyllëse me temë "Nevojat dhe sfidat në forcimin e integritetit të prokurimeve publike" të organizuar nga Qendra për Komunikime Qytetare, në panelin e diskutimit mori pjesë edhe kryerevizori shtetëror mr. Maksim Acevski. Në fjalën e tij, kryerevizori shtetëror theksoi se në fushën e dhënies së kontratave të prokurimeve publike në thelb ekzistojnë dy qasje, parandalimi dhe represioni. Në këtë kontekst, ai shtoi se asnjë ligj, akt nënligjor apo strategji nuk do të japë rezultatet e pritura nëse nuk ka përkushtim të sinqertë për të lëvizur gjërat në drejtim të sigurimit të vlerës adekuate për paratë e dhëna. Si dobësi në procesin e dhënies së kontratave të prokurimeve publike, u theksua se në njësitë e vetëqeverisjes lokale ekziston mundësia e dhënies së prokurimeve publike në grup, por kjo mundësi zbatohet rrallë. Një veprim i tillë mund të kontribuojë në efekte më të mëdha duke siguruar profesionistë të cilët mund të përgatisin dokumentacionin e duhur profesional të tenderit dhe vlerësimin e ofertave, të cilat nga ana e tyre

do të kontribuojnë në racionalizimin e shpenzimeve dhe burimeve njerëzore të përfshira në dhënien e prokurimeve të caktuara publike.

### Transparensi Interneshënall

Në periudhën nga maji deri në qershor 2021, në organizim të Transparensi Interneshënall Maqedoni, janë mbajtur katër trajnime online, të cilat kanë për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për luftimin e korrupsionit dhe përmirësimin e bashkëpunimit dhe veprimit të ndërsjellë të institucioneve kompetente. Punonjësit e Entit Shtetëror të Revizionit i ndanë njohuritë dhe përvojën e tyre me pjesëmarrësit në këto trajnime në fushën e revizionit shtetëror, strukturën e raporteve të revizionit dhe metodologjinë e revizionit shtetëror, praktikat e mira për analizën e raporteve të revizorit dhe rolin e qeverisjes së mirë në luftën kundër korrupsionit dhe revizionit të partive politike.

### Opinioni i gjerë (qytetarët)

ESHR-ja përfaqëson institucionin e pavarur që u mundëson qytetarëve të monitorojnë se si shpenzohen paratë publike, duke i informuar për punën e institucioneve publike dhe për masat që duhet të ndërmerren për të siguruar menaxhim të mirë dhe transparent të fondeve publike. Në këtë drejtim, në përputhje me Ligjin për qasje të lirë te informatat me karakter publik, gjatë vitit 2021 janë pranuar 12 kërkesa për informata publike me karakter publik dhe atyre u është përgjigjur pozitivisht. Në të njëjtën kohë, ESHR-ja në përputhje me Plan Veprimin Nacional për Partneritet të Qeverisjes së Hapur dhe angazhimin "Publikimi pro aktiv i informacioneve me karakter publik në faqet e internetit të institucioneve", i publikoi në faqen e saj të internetit të gjitha dokumentet që janë lëndë me interes të opinionit të përgjithshëm.

## 2.3. BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE PËR REVIZIONET DHE EFEKTET E TYRE

Për arritjen e qëllimit themelor të revizionit - duke mbajtur kujdesin për fondet publike dhe përmirësimin e menaxhimit të tyre, zbulimin në kohë të devijimeve nga standardet e pranuara dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit në menaxhimin me fondet publike, ESHR-ja referon rekomandime të qarta dhe efektive, me qëllim të ndërmarrë hapa të parandalojë ose pengojë devijimet dhe shkëputjet në të ardhmen. Masat korrigjuese për zbatimin e rekomandimeve u mundësojnë udhëheqësve të subjektit lëndë të revizionit të përmirësojnë efektivitetin, efikasitetin dhe ekonomizimin në punë.

Enti Shtetëror i Revizionit edhe në vitin 2021, nëpërmjet informimit të qartë, real, objektiv dhe në kohë për parregullsitë e konstatuara, mospajtueshmërinë me rregullat ligjore, veprimin e paligjshëm me fondet publike dhe rastet e mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ka dhënë kontribut në plotësimin e pjesës së kompetencave të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

ESHR-ja i kushton vëmendjen e duhur përpunimit dhe analizës së informacioneve që rrjedhin nga Raportet Përfundimtare të Revizionit të revizorëve të autorizuar shtetërorë. Këto të dhëna në baza të rregullt i përpunon me aplikacion softuerik që është i integruar, autonom dhe funksional për përpunimin dhe analizimin e të dhënave nga Raportet Përfundimtare të Revizionit. Në këtë mënyrë sigurohen informacione të sigurta, të përditësuara, në kohë dhe relevante për nevojat e ESHR-së, organet kompetente dhe palët e tjera të interesuara.

Me dorëzimin e rregullt të raporteve përfundimtare të revizionit në Kuvend dhe organet kompetente, ESHR-ja e orienton vëmendjen ndaj dobësive të konstatuara në punën e subjekteve të reviduara.

Në vazhdimësi i evidentojmë, monitorojmë dhe analizojmë informacionet e marra kthyese nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, MF - Drejtoria e Policisë Financiare, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Zëvendëskryeministri i Qeverisë së RMV-së përgjegjës për

politikat e qeverisjes së mirë për veprim sipas Raporteve Përfundimtare të Revizionit të dorëzuara te ta.

Efekti i gjendjeve të konstatuara që tregojnë për parregullsi dhe paligjshmëri në punën e subjekteve ndaj menaxhimit më të mirë të fondeve publike mund të pritet vetëm nëse institucionet kompetente i ndërmarrin masat e nevojshme për tejkalimin e tyre.

Një nga qëllimet strategjike të ESHR-së është monitorimi dhe informimi për aktivitetet e ndërmarra të institucioneve kompetente për tejkalimin e parregullsive dhe paligjshmërive të konstatuara në punën e subjekteve.

Aktivitetet e ESHR-së lidhur me parandalimin e korrupsionit kryhen në përputhje me kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara me Ligjin për revizion shtetëror, Ligjin për Prokurorinë Publike, Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, memorandumet e lidhura për bashkëpunim si dhe rregullativat e tjera ligjore relevante.

Në kuadër të realizimit të Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021, raportet e revizionit janë dorëzuar në institucionet kompetente si vijojnë:

Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut 9 / raporte të revizionit, për 9 / subjekte të reviduara (revizione);

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit janë dorëzuar 2/raporte të revizionit;

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit janë dorëzuar 7/raporte të revizionit për 7/ partitë politike dhe koalicionet, të dorëzuara sipas detyrës zyrtare në përputhje me ndryshimet në Kodin Zgjedhor neni 85-b (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 42/20120 ) - detyrë zyrtare;

Zëvendëskryetari i Qeverisë së RMV-së i ngarkuar për politikat e qeverisjes së mirë është dorëzuar 2/raporte të revizionit.

Në muajin prill të 2022, ESHR-ja ka dorëzuar te autoritetet kompetente kërkesë për sigurimin e informacionet kthyese për masat e ndërmarra në lidhje me raportet përfundimtare të revizionit të dorëzuara.

Deri në ditën e njoftimit janë siguruar informacionet kthyese nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Financave – Drejtoria e Policisë Financiare.

Enti Shtetëror i Revizionit bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjitha organet shtetërore për parandalimin dhe zvogëlimin e korrupsionit, në kuadër të Protokollit për bashkëpunim për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Enti Shtetëror i Revizionit merr pjesë në realizimin e Programit Nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) nëpërmjet aktiviteteve të parapara në Kapitullin 3.23. Gjyqësori dhe të Drejtat Fondamentale, Fusha - Politika kundër Korrupsionit dhe Kapitulli 3.32 Kontrolli Financiar, Fusha - Revizioni i jashtëm, si dhe në punën e trupave dhe organeve të tjera për parandalimin e korrupsionit.

# 3

# KAPACITETET
ADMINISTRATIVE

# 3.1. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE

Enti Shtetëror i Revizionit në vazhdimësi investon në zhvillimin e burimeve njerëzore dhe siguron zhvillimin e vazhdueshëm të tyre kështu që:

- ka kryer specializimin e njësive të brendshme organizative;
- sistemimin e punonjësve në vendet e punës në përputhje me kualifikimet e tyre profesionale, përvojën e punës dhe aftësitë e fituara;
- siguron përparim të vazhdueshëm në karrierë nëpërmjet avancimit;
- punëson kuadër të ri në revizionin shtetëror dhe
- siguron zhvillim dhe përsosmëri të vazhdueshme profesionale të njohurive të revizorëve shtetërorë.

Në bashkëpunim me organet kompetente, Enti Shtetëror i Revizionit në vazhdimësi bën përpjekje për rritjen e numrit të të punësuarve, me çka siguron rritje të vazhdueshme të numrit të të punësuarve në përputhje me aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ESHR.

## Burimet njerëzore

### Struktura gjinore e punonjësve në ESHR

**115**

TË PUNËSUAR NË ESHR

prej të cilëve 71 punonjës janë gra dhe 44 punonjës janë burra




### Struktura e udhëheqësve në ESHR




### Struktura gjinore e udhëheqësve të ekipit të revizorëve



## **VLERËSIMI I PUNËS** SË ESHR-SË NGA KOMISIONI EVROPIAN

Në Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 është konstatuar se kuadri dhe kapaciteti institucional i ESHR-së shikuar përmes prizmit të raporteve të publikuara të revizionit, gjendja e konstatuar te subjektet e revizionit, zbatimet e metodologjive, mendimet e dhëna të revizorit në pajtim me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit - INTOSAI dhe niveli i cilësisë së punës së revizionit vlerësohen si të përshtatshme dhe të harmonizuara me standardet e INTOSAI-t.

Komisioni Evropian vlerëson se pas miratimit të akteve të reja për organizimin dhe sistemimin e vendeve të punës në vitin 2020 nga ana e kryerevizorit shtetëror, si dhe pas kryerjes së analizës së gjerë dhe të thelluar funksionale të ESHR-së dhe punësimet e realizuara, numri i punonjësve të ESHR-së është rritur për më shumë se 30% në krahasim me vitin 2019.

Në raportin, në pikën 2.4. nga Kapitulli i Prokurimeve Publike, theksohet se roli dhe kapaciteti i ESHR-së në kryerjen e revizioneve të prokurimeve publike janë përmirësuar përmes zbatimit të programit të ri të revizionit të prokurimeve publike dhe është theksuar veçanërisht revizioni i rregullshmërisë së prokurimeve publike urgjente të lidhur me krizën e KOVID-19. ndërsa në pikën 5.32 të Kapitullit 32. Kontrolli Financiar, është theksuar se pavarësia e Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) nuk është ende e garantuar me Kushtetutë dhe theksohet se bashkëpunimi mes ESHR-së dhe Kuvendit është përmirësuar, por duhet të zhvillohet edhe më tej, ndërsa kontrolli i Kuvendit mbi përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit duhet të forcohet më tej.



## 3.2. RRITJA E NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË REVIZORËVE SHETËROR

ESHR-ja si institucion suprem i revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke e njohur rolin dhe rëndësinë e njohurive dhe aftësive profesionale të punëtorëve, ndërmerr aktivitete të vazhdueshme për investime në burimet njerëzore.

Njëherazi për nevojat e përcaktimit dhe vetëdijesimit për përsosmërinë e vazhdueshme profesionale të punonjësve në ESHR, nëpërmjet anketës së zbatuar u përcaktuan fushat me prioritet për edukimin e punonjësve, në bazë të së cilës u përgatit dhe u publikua në publikë Plani Vjetor për përsosmëri dhe trajnim të vazhdueshëm profesional për vitin 2021 (PV për PVP)[4]. Ky aktivitet është një nga kërkesat e INTOSAI-t dhe ISSAI-t.

Pavarësisht pranisë së vazhdueshme të pasojave nga pandemia të shkaktuar nga virusi i koronës, plani u realizua plotësisht dhe u zhvilluan trajnime në fushat e mëposhtme:

4 https://dzr.mk/sites/default/files/2021-02/Godisen_plan_KPUO_2021.pdf.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| revizioni - trajnime metodologjike - niveli themelor dhe niveli i avancuar; | zbatimin praktik të standardeve të revizionit të ISR-së (INTOSAI); | parandalimit të korrupsionit, integritetit dhe komunikimit; | Teknologjisë së Informatikës; | SNK-së dhe SNRF-së; |
| tatimet dhe kontributet; | për mbrojtjen dhe sigurimin e qasjes te informatat me karakter publik; | trajnime përmes projekteve aktuale/ të reja të ESHR-së; | trajnime të organizuara në kuadër të punëtorive dhe seminareve; sipas aktiviteteve të planifikuara ndërkombëtare të ESHR-së për vitin 2021, dhe | trajnime të llojeve të tjera. |

PV-ja për PVP-në për vitin 2021 përmbante rritje të konsiderueshme të vëllimit të ngjarjeve të planifikuara edukative me qëllim të rritjes së njohurive dhe aftësive të punonjësve, kryesisht revizorëve shtetërorë me pjesëmarrjen e tyre në seminare, trajnime, punëtori dhe ngjarje të tjera edukative të organizuara nga ESHR-ja, nga organizatat ndërkombëtare, asociacionet profesionale, shoqatat dhe nismat ndërkombëtare, si dhe subjektet juridike private nga vendi dhe jashtë vendit ofrojnë arsimim në disa fusha që lidhen me revizionin shtetëror.

Në bazë të përvojës së fituar në vitin e kaluar, ndërsa për nevojat e zhvillimit profesional të punonjësve në Entin Shtetëror të Revizionit gjatë vitit 2021 janë organizuar dhe kanë siguruar pjesëmarrje në numër të madh të trajnimeve dhe punëtorive (67) me tema të ndryshme.

Enti Shtetëror i Revizionit ka arritur të tejkalojë synimin prej më së paku pesë ditëve në vit për trajnimin e lartë të përsosmërisë së vazhdueshme të revizorëve shtetërorë në fushën e kontabilitetit si segment jashtëzakonisht i rëndësishëm për të kuptuar revizionet, që është rekomandim i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve – IFAK. Njëherazi revizorët shtetërorë mesatarisht në vitin 2021 kanë realizuar 20 ditë përsosmëri të vazhdueshme profesionale në fushën e revizionit dhe kontabilitetit financiar.

Gjatë vitit 2021 janë zbatuar dhe trajnime të posaçme të dizajnuara për revizorët e rinj shtetërorë, me qëllim të lehtësimit dhe përshtatjes së tyre profesionale në mjedisin e ri të punës, duke u mundësuar atyre të fitojnë përvojë për vendin e punës përkatës nëpërmjet kryerjes së detyrave të ndryshme të revizionit, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime të synuara.

Nga shumica e edukimeve dhe pjesëmarrjes në seminare dhe punëtori të dizajnuara për punonjësit e Entit Shtetëror të Revizionit, por edhe për punonjësit në sektorin publik, theksojmë se gjatë vitit 2021, ka vazhduar bashkëpunimi aktiv me organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të institucioneve

supreme të revizionit dhe organizatave me renome ndërkombëtare dhe qendrave të specializuara të trajnimit ndërkombëtar.

Enti Shtetëror i Revizionit në vazhdimësi siguron qasje elektronike në bazën e të dhënave të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", dhe shfrytëzon shërbimet e shoqërive me renome për konsultime ekonomike-financiare dhe juridike nga vendi, nga të cilat në vazhdimësi janë siguruar informata të përditësuara dhe analiza të lajmeve dhe zhvillimeve të fundit në fushën e kontabilitetit dhe revizionit.

Me investimin në njohuritë dhe aftësitë e punonjësve, ESHR-ja siguron efekt të shprehjes së shumëfishtë nëpërmjet rritjes së cilësisë së detyrimeve të punës së kryer dhe në të njëjtën kohë nëpërmjet dhënies së rekomandimeve përkatëse në raportet përfundimtare të revizionit sigurojnë këshilla për mënyrën e veprimit të subjekteve të sektorit publik.



NDRIMI I SERVERËVE DHE SISTEMIT OPERATIV, PAJISJEVE PËR RRUAJTJEN E TË DHËNAVE DHE PAJISJE PËR LIDHJE TË RRJETIT



PROKURIME TË LAPTOPËVE



MBROJTJA E DETYRUESHME E TË DHËNAVE



PROKURIMI I SKENERËVE



TRAJNIM I SIGURUAR

## 3.3. BURIMET E TI-së

Në vitin 2021, Enti Shtetëror i Revizionit ndërmori hapa në fushën e modernizimit të burimeve të TI-së. U krye me sukses përmirësimi i plotë i sistemit të informacioneve, si më poshtë: ndërrimi i serverëve dhe sistemit operativ, zëvendësimi i burimeve të diskut, zëvendësimi i pajisjeve të rrjetit. Në mënyrë plotësuese, realizohet edhe instalimi dhe testimi i pajisjeve që duhet të përdor ESHR-ja në lokacionin sekondar, në rast të incidentit serioz të TI-së në lokacionin primar (Disaster Recovery Site).

Në pjesën e kujdesit për nevojat e punonjësve në Entin Shtetëror të Revizionit, u realizuan blerjet e laptopëve me çka u zëvendësuan të gjithë dhe revizorët shtetërorë u pajisën me laptop të ri, me versionin e fundit të sistemit operativ. Ky hap lehtëson plotësisht punën e revizorëve, njëkohësisht duke unifikuar pajisjet dhe mjetet që i përdorin në procesin e revizionit. Është futur edhe enkriptimi i detyrueshëm i të dhënave, me qëllim të mbrojtjes së proceseve të punës në revizion, si dhe mbrojtjes së të dhënave të marra nga subjektet që janë lëndë e revizionit.

Përdorimi i qasjes në distancë nga ana e subjekteve që janë lëndë e revizionit, për të siguruar të dhëna elektronike me kërkesë të revizionit, u tregua si pilot-projekt i suksesshëm. Në këtë mënyrë në kushtet e pandemisë u lehtësua ndjeshëm shkëmbimi i të dhënave me subjektet.

Në vitin 2021 ishin siguruar dhe skanerë me dimensione më të vogla dhe peshë të lehtë, të cilët revizorët i përdorin në procesin e revizionit, në pjesën e sigurimit të dëshmive në formë elektronike.

Për punonjësit e rinj, është siguruar trajnimi në pjesën e njohjes me sistemin e informacioneve, përdorimin e duhur të burimeve të TI-së, përdorimin e veglave softuerike, aplikacioneve dhe Sistemin për Menaxhimin me Proceset e Revizionit që përdoren në mënyrë aktive në procesin e revizionit, si dhe njohjen me politikat dhe procedurat e TI-së - baza për përdorim të suksesshëm, të drejtë dhe të sigurt të mjeteve dhe të dhënave.

Praktika e përdorimit të mjeteve teknike (platformës) për mbajtjen e video konferencave dhe takimeve me palët e brendshme dhe të jashtme ka vazhduar edhe këtë vit. Në këtë mënyrë u realizuan lehtësisht aktivitetet e projektit të tviningut, ku për shkak të ndalimeve të ndryshme lidhur me pandeminë, ishte e pamundur të realizohet prania fizike e të gjithë palëve të interesuar.

Zhvillimi i teknologjisë informatike dhe përdorimi i saj nga subjektet që janë lëndë e revizionit ka kontribuar në procesin e revizionit të përdoren teknikat e revizionit të ndihmuar me kompjuter të njohura si CAAT's.

CAAT's paraqesin vegla të bazuara kompjuterike, me ndihmën e të cilave revizorët kryejnë një sërë testesh të automatizuara për vlerësimin e sistemit të informacioneve të subjektit ose të të dhënave elektronike. CAAT's sigurojnë nivel më të lartë të sigurisë dhe sigurimin e dëshmive të përshtatshme dhe të mjaftueshme të revizionit. ESHR-ja në revizion e përdor softuerin IDEA për të analizuar të dhënat nga të cilat gjenerohen raportet financiare dhe për të zgjedhur mostrën për nevojat e procesit të revizionit.

Është siguruar funksionimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së sistemit të informacioneve dhe aplikacioneve, duke u kujdesur për parimet dhe rregullat për: dispozicionin e të dhënave të përdoruesit të autorizuar, besueshmërinë, integritetin, ruajtjen e sigurt të të dhënave në lokacionin qendror, pajtueshmërinë me ligjet, bërjen e rregullt të kopjes rezervë (backup), mbrojtjen nga qasja fizike dhe logjike e të dhënave.

Njëherazi, zbatohet në mënyrë konsekuente Politika e Sigurisë së Sistemit të Informacioneve të Entit Shtetëror të Revizionit, me vëmendje të veçantë drejt zbatimit të procedurave të sigurisë së TI-së dhe procedurave të TI-së për zbatimin e Sistemit për Menaxhim me Procesin e Revizionit.

## 3.4. MJETET FINANCIARE PËR PUNË TË ESHR-së

Në pajtim me Ligjin për revizion shtetëror, mjetet financiare për punën e Entit Shtetëror të Revizionit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Buxheti i plotë i planifikuar për vitin 2021 për të gjitha tri llogaritë (637, 631 dhe 785) është 116.295 mijë denarë, nga i cili është miratuar plani në shumën totale prej 114.068 mijë denarë dhe realizim 111.870 mijë denarë.

Prej tyre 112.623 mijë denarë ose 96,84% janë mjete të siguruara nga buxheti themelor i llogarisë (637), 2.970.000 denarë ose 2,55% janë mjete të llogarisë së buxhetit themelor (631) dhe 702.000 denarë ose 0,6% janë mjete të llogarisë së buxhetit të donacioneve - 785.

Buxheti i plotë i planifikuar

**116.295**

mijë denarë

**Llogaria 637 - buxheti themelor**

Buxheti i miratuar për vitin 2021 i llogarisë 637 në shumën totale prej 112.623 mijë denarë u zbatua në total 111,147 mijë denarë, gjegjësisht përqindja e realizimit të mjeteve është 98.68%.

Shpenzimet e planifikuara te llogaria 637 e Entit Shtetëror të Revizionit në shumë prej 94.898 mijë denarë ose 84,26% u referohen pagave, kontributeve dhe kompensimeve të punonjësve, 13.715 mijë denarë ose 12,17% u referohen mallrave dhe shërbimeve, transferet dhe donacionet janë planifikiuar në shumë prej 300.000 ose 0.26% nga shuma totale dhe 3.710 mijë denarë ose 3,29% u planifikuan për shpenzimet kapitale.

Nga aspekti i strukturës së shpenzimeve të realizuara të Entit Shtetëror të Revizionit, 93.797 mijë denarë ose 84% u referohen pagave dhe kompensimeve të punonjësve, 13.657 mijë denarë ose 13% u referohen mallrave dhe shërbimeve dhe 3.693 mijë denarë ose 3% për shpenzimet kapitale.

Në vitin 2021 në strukturën e realizimit të shpenzimeve për mallrat dhe shërbimet, përqindje më të madhe kanë shërbimet komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti në shumë prej 3.999 mijë denarë, për shpenzimet rrugore dhe mëditjet janë realizuar mjetet në shumë prej 1.582 mijë denarë, për materialet dhe inventarin e imët janë realizuar 1.141 mijë denarë, për riparimet dhe mirëmbajtjet e vazhdueshme janë realizuar 3.016 mijë denarë, për shërbimet me kontratë janë realizuar 2.418 mijë denarë, për shpenzimet tjera rrjedhëse 1.210 mijë denarë dhe për transferet e ndryshme janë realizuar mjetet në shumë prej 291 mijë denarë.

Te shpenzimet kapitale janë realizuar fonde prej 3.693 mijë denarë që kanë të bëjnë me prokurimin e pajisjeve të zyrës dhe të informatikës, mobiljeve të zyrave dhe investimeve në fondet jofinanciare. Për blerjen e makinave dhe pajisjeve janë realizuar mjete në shumë prej 2.162 mijë denarë, ndërsa për blerjen e mobiljeve të zyrës janë realizuar mjete në shumë prej 672 mijë denarë dhe për investimet në mjetet jofinanciare dhe për prokurimin e softuerëve dhe licencave për mbrojtjen antivirus të sistemeve dhe të dhënave, si dhe për licencat e BACK up, janë realizuar mjete në shumë prej 857 mijë denarë.

Enti Shtetëror i Revizionit si institucion përgjegjës shoqëror, për ndihmë dhe mbështetje të qytetarëve të prekur në fatkeqësinë e autobusit që ndodhi në Republikën e Bullgarisë në autostradën "Struma", pas sigurimit të Aktvendimit për vërtetimin e interesit publik në veprimet socio-humanitare, dhuroi mjete me para prej 100 mijë denarë në Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË LLOGARISË 637




- **Llogaria 631 - buxheti themelor**

Për vitin 2021, nga llogaria themelore e buxhetit 631 janë realizuar shpenzime në shumë prej 22 mijë denarë. Të ardhurat në vitin 2021 janë në shumën totale prej 2.516 mijë denarë ndërsa mjetet e pashpenzuara në fund të vitit janë në shumë prej 2.494 mijë denarë dhe të njëjtit si tepricë e të ardhurave janë transferuar për vitin e ardhshëm.

- **Llogaria 785 - buxheti i donacioneve**

Në vitin 2021 nga llogaria 785 janë realizuar mjete financiare në shumë prej 701 mijë denarë, të cilat janë pranuar si donacione nga Institucioni Ndërkombëtar i institucioneve supreme të revizionit INTOSAI.

Konkretisht, në tetor 2020, Institucioni Ndërkombëtar i institucioneve supreme të revizionit INTOSAI kishte shpallur thirrjen për aplikime për ndarjen e grantit për vazhdimësinë e institucioneve supreme të revizionit gjatë kohës së KOVID-19. Enti Shtetëror i Revizionit ka aplikuar dhe ka pranuar donacione në vlerë të përgjithshme prej 11.428 euro, gjegjësisht 701 mijë denarë të cilat janë dedikuar për blerjen e laptopëve për nevojat e revizorëve pas procedurës së zbatuar më parë për prokurim publik të pajisjeve informatike dhe video në vitin 2021.

- **Donacionet e pranuara në vitin 2021 - aktivitetet e financuara përmes donatorit**

Enti Shtetëror i Revizionit gjatë vitit 2021 pranoi donacione në pajisje harduerike dhe softuerike në vlerë të përgjithshme prej 311 mijë euro, gjegjësisht 19.134 mijë denarë në bazë të kontratave të lidhura përmes projektit IPA / 2020 / 421-614. Nga ky projekt janë marrë 50 laptopë së bashku me pjesën tjetër të pajisjeve softuerike dhe harduerike (licenca, serverë, etj.) për nevojat e Entit Shtetëror të Revizionit. Me këto kompjuterë u realizuan zëvendësimet e laptopëve të vjetëruar, të cilët për shkak të performancës së tyre të kufizuar nuk janë në gjendje të ofrojnë mbështetje efikase dhe cilësore në kryerjen e revizioneve në distancë, me çka u siguruan kushte të përmirësuara të punës për punonjësit në kryerjen e aktiviteteve të revizionit.

Me qëllim të përmirësimit dhe edukimit të vazhdueshëm të punonjësve të Entit Shtetëror të Revizionit në fushën e "Revizionit të raporteve financiare në bazë të parallogaritjes", nga ana e UNDP-së, ndërsa për këtë qëllim ka realizuar shpenzime në shumë prej 2,129 mijë denarë.

Enti Shtetëror i Revizionit pranoi donacione të licencave - Adobe Package për dizajn grafik në shumën totale prej 56 mijë denarë bazuar në marrëveshjen e lidhur me Fondacionin për Demokraci Vestminster, të cilat do të kontribuojnë në vizualizimin dhe përmirësimin më të mirë të aktiviteteve të revizionit të ESHR-së.

Raportet financiare të Entit Shtetëror të Revizionit i revidojnë shoqëritë e jashtme të revizionit të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Raporti nga revizioni i kryer i Entit Shtetëror të Revizionit nga ana e revizorit të pavarur është pjesë përbërëse e Raportit Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit.

# 4

BASHKËPUNIMI
**NDËRKOMBËTAR**

ESHR-ja, si ISR-të e tjera, është aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar. Ajo mundëson rritjen e njohurive dhe aftësive të punonjësve, shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e efektivitetit të proceseve të revizionit.

Në vitin 2021, për shkak të gjendjes së imponuar nga pandemia e KOVID-19, vazhdoi trendi i realizimit të ngjarjeve ndërkombëtare në distancë, përmes videokonferencave dhe në formë të uebinarit. Qasja e mbajtjes së ngjarjeve ndërkombëtare virtuale mundësoi që ato të ndiqen nga një numër i madh i punonjësve të ESHR-së. Gjatë vitit 2021, ESHR-ja ka marrë pjesë në 50 ngjarje ndërkombëtare (takime, punëtori, konferenca), nga të cilat mbi 90% janë realizuar me video link. Të gjithë pjesëmarrësit patën mundësinë të informohen për praktikat më të mira dhe të marrin pjesë në rrjetëzimin si mundësi për të zgjeruar njohuritë dhe aftësitë e tyre në disa fusha:

- revizioni i mjedisit jetësor;
- mbështetja e TI-së dhe revizioni i TI-së;
- përmirësimi i punës së ISR-së;
- borxhi publik;
- revizioni i komunave;
- pandemia e KOVID-19 si sfidë dhe mundësi për të rritur ndikimin e ISR-së, etj.

ESHR-ja është pjesëmarrëse aktive në shumë çështje ndërkombëtare, grupe operative ndër të cilat edhe:

# GRUPI I PUNËS **EUROSAI** DHE **INTOSAI**




Kontributi i ESHR-së në realizimin e aktiviteteve të grupeve të punës dhe programeve të EUROSAI-t, gjatë vitit 2021 ishte zhvilluar vazhdimisht në përputhje me kushtet e vendosura nga KOVID - 19.

Pjesëmarrja në revizionet kooperative me institucione të tjera supreme të revizionit nga BE-ja dhe më gjerë, mbetet edhe më tej një nga prioritetet e ESHR-së duke pasur parasysh faktin se ky lloj bashkëpunimi kontribuon ndjeshëm në forcimin e vazhdueshëm të aftësive të revizorëve dhe përmirësimin e cilësisë së revizionit të suksesit.

Përfitimet nga bashkëpunimet me ISR-të e tjera janë të shumëfishta, veçanarisht i theksojmë mundësinë që kanë revizorët të avancojnë veten në mënyrë profesionale në formën e aktiviteteve kolegjiale (peer-to-peer), qasja fleksibile dhe përdorimi i përvojave të pjesëmarrësve të tjerë dhe forcimi i vetëbesimit në kapacitetet personale për kryerjen e revizionit të suksesit nga njëra anë dhe promovimin e rezultateve të arritura të ESHR-së nga ana tjetër.

# EUROSAI

Delegacioni i Entit Shtetëror të Revizionit i kryesuar nga kryerevizori shtetëror mr. Maksim Acevski ka marrë pjesë në Kongresin XI të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Revizionit (EUROSAI), të mbajtur në prill 2021. Për shkak të rrethanave me pandeminë globale me KOVID-19, Kongresi u mbajt online nëpërmjet platformes së internetit. Kongresi u organizua nga ISR e Republikës Çeke, e cila është edhe kryesuese aktuale e EUROSAI-t, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të anëtarëve të ISR-së së EUROSAI-t, si dhe të organizatave ndërkombëtare dhe ISR-ve. Objektivat e Kongresit XI të EUROSAI-t ishin vlerësimi i rezultateve të punës së EUROSAI-t për periudhën 2017 - 2020 dhe sigurimi i vazhdimësisë në punën e EUROSAI-t.

Në dhjetor 2021, u publikua Raporti i Konsoliduar nga  revizioni paralel ndërkombëtar "Fuqia e punës 2030 - A është vendi juaj i përgatitur" - një projekt i EUROSAI SG1, ndërsa bartës të këtij aktiviteti janë ISR-të e Izraelit dhe Finlandës, dhe në të cilin marrin pjesë 7 ISR dhe Gjykata Evropiane e Revizionit. Enti Shtetëror i Revizionit merr pjesë në këtë aktivitet me revizion të suksesit me temën "Planifikimi qeveritar – Efektiviteti i masave të qeverisë për ballafaqimin me rreziqet e tregut të punës dhe mënyra e planifikimit të mjeteve për tejkalimin e tyre". Qëllimi i këtij raporti të konsoliduar është të jetë dokument dhe mjet udhëzues për të gjitha qeveritë në mbarë botën për sfidat e ardhshme të tregut të punës.

## GRUPI I PUNËS PËR MJEDISIN JETËSOR TË EUROSAI (WGEA)

Në kuadër të grupit të punës për mjedisin jetësor të EUROSAI WGEA, përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në seminarin pranveror "Menaxhimin me hedhurinat" (Spring Session on Waste management), ku mund të shkëmbeheshin përvoja për politikat e menaxhimit të hedhurinave në nivel qendror dhe lokal dhe zbatimi i tyre, respektimi i hierarkisë gjatë menaxhimit me hedhurinat në sektorë të ndryshëm, mënyra e financimit të aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit jetësor, roli i ISR-ve për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike, llojet e hedhurinave dhe mënyrat e mundshme të menaxhimit të tyre. Gjithashtu, në kuadër të këtij grupi të punës, përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në Takimin e 19-të Vjetor të grupit që u mbajt në tetor 2021 me titull "Tranzicioni i Gjelbër" (Green Transition), ku diskutimi qendror ishte Marrëveshja e Gjelbër Evropiane.

## TRUPI OPERATIV I EUROSAI-T PËR REVIZION TË KOMUNAVE (TFMA)

ESHR-ja ka treguar aktivitet të veçantë në punën e grupit operativ të EUROSAI (TFMA) për revizionin e komunave, veçanërisht në pjesën e zbatimit të planit të veprimit për 2021/22.

Në nëntor të 2021 në Mal të Zi u mbajt takimi i pestë vjetor i grupit TFMA, të cilën e ndoqën 28 ISR, ndërsa përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë aktive me dy prezantime:

- prezantimi i revizionit kooperativ me temë: "Të ardhurat personale të komunave në kushtet e pandemisë për sigurimin e shërbimeve cilësore të qytetarëve", në të cilën marrin pjesë 7 Institucionet Supreme të Revizionit: ISR-ja e Shqipërisë, Malit të Zi, Rumanisë, Sllovakisë, Polonisë, Turqisë dhe ESHR-ja në rolin e koordinatorit, për të cilat u nënshkrua Memorandumi dypalësh për bashkëpunim me të gjitha vendet pjesëmarrëse në revizion. Në kuadër të këtij aktiviteti në qershor 2021, ESHR-ja organizoi me sukses takimin e parë online të punës për revizionin kooperativ të suksesit, ndërsa shtatori 2021 është shënuar si fillimi i fazës së planifikimit.
- prezantimi i analizës "Mbledhja e të dhënave për mënyrën e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve në raportet e revizionit për NJVL", e përgatitur në kuadër të këtij grupi, nga ana e ESHR-së, e cila në fakt paraqet analizë të procedurave përmes të cilave ISR-të - anëtarë të TFMA e monitorojnë zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit për revizionet e kryera të komunave për lloje të ndryshme të revizionit. Analiza është përgatitur mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga pyetësori i cili u përgatit më parë nga ESHR-ja dhe i dorëzuar në të gjitha vendet anëtare të TFMA-së.[5] .



## GRUPI OPERATIV I EUROSAI-T PËR REVIZION DHE ETIKË (TFA&E)

Në mars 2021, në mënyrë virtuale u mbajt takimi i fundit i 11-të i grupit operativ i EUROSAI-t për revizion dhe etikë (TFA&E). Tema kryesore e takimit ishte përmbledhja e rezultateve nga aktivitetet e grupit dhe përgatitja e raportit përfundimtar për Kongresin XI të EUROSAI-t. Përfaqësuesit e grupit u informuan për Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet INTOSAI-t dhe OKB-së, Doracakun për integritet publik të OECD-së në vitin 2020 dhe për modelet e pjekurisë së integritetit publik të OECD-së, të cilat u përgatitën me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të TFA & E. Në mbledhjen e 11-të të TFA & E u vendos që të ndërpriten aktivitetet e grupit.

5 https://www.tfma.eu/page.aspx?id=110;

# INTOSAI

## GRUPI I PUNËS I INTOSAI-T PËR REVIZION TË MJEDISIT JETËSOR (WGEA)

Në kuadër të grupit të punës të INTOSAI WGEA, në janar 2021 u mbajt kuvendi i 20-të, në të cilën përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në diskutimet interesante të ekspertëve më të mirë mbi temat që lidhen me ekonominë qarkullues. Temat kryesore në të cilat u mbajtën diskutimet, mes tjerash ishin transporti i qëndrueshëm, financimi klimatik, diskutimi në panel mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) dhe përdorimi i tyre për të përcaktuar përfshirjen dhe kriteret e revizionit, mundësinë dhe ndikimin e tyre reciprok, si dhe aspektet e tjera të lidhura me qëllimet. Gjatë sesionit u prezantuan raste studimore me temën e menaxhimit me hedhurinat plastike dhe konceptin e ekonomisë qarkulluese nga ana e disa ISR-ve, mes tjerash edhe ESHR-ja ku përfaqësuesi i saj bëri pasqyrë të shkurtër të trajtimit dhe përpunimit të hedhurinave plastike në vend.

## GRUPI I PUNËS I EUROSAI DHE INTOSAI PËR TI (ITWG)

Përfaqësuesit e ESHR-së në Grupin e punës të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t për revizionin e TI-së, morën pjesë aktive në të gjitha seminaret online të organizuara nga ky grup, me të cilat i rritën aftësitë dhe njohuritë e tyre gjatë zbatimit të revizioneve të TI-së.

## GRUPI I PUNËS I INTOSAI PËR BORXHIN PUBLIK (WGPD)

ESHR-ja me përfaqësuesit e saj mori pjesë në Takimin Vjetor të grupit të punës INTOSAI WGPD, i cili u mbajt në mënyrë virtuale. Tema e takimit vjetor për vitin 2021 ishte revizioni i borxhit publik dhe ndikimi i krizës COVID-19 në borxhin publik dhe menaxhimin e tij në të cilin punonjësit e ESHR-së morën pjesë aktive me prezantimin e tyre.

Në kuadër të këtij grupi të punës, ESHR-ja merr pjesë aktive si udhëheqës i ekipit në zbatimin e dy aktiviteteve të Planit Strategjik të WGPD-së, si vijon:

- përgatitja e shumë procedurave praktike për autorizimin, miratimin dhe kornizën ligjore në menaxhimin me borxhin publik dhe
- përgatitja e Punimit Kërkimor për hartimin e mandateve të ISR-së për revizionin e borxhit publik, kapaciteteve institucionale dhe mbështetjes dhe burimeve të Organizatës Rajonale.

Grupi i punës INTOSAI WGPD, në bashkëpunim me Bankën Botërore, organizoi me sukses një sërë ngjarjesh si pjesë e "Javës së revizorëve për menaxhimin me borxhin publik" në qershor 2021, në të cilën ngjarje një punonjës i ESHR-së mori pjesë aktive si pjesëmarrës në panel diskutim.

## NISMA PËR ZHVILLIM TË INTOSAI (IDI)

Përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në ngjarjet ndërkombëtare në vitin 2021 të organizuara nga Nisma për Zhvillim të INTOSAI (IDI), në të cilën u prezantuan përvojat e institucioneve supreme të revizionit dhe ekspertëve ndërkombëtarë në lidhje me:

- Vendosjen e risive në punë nëpërmjet organizimeve të laboratorëve inovative;
- Përpunimin e sasive të mëdha të të dhënave tekstuale dhe përdorimin e mësimit mekanik;
- Përmirësimin e mësimit nëpërmjet përdorimit të njohurive nga kërkimet shkencore më moderne në neuroshkencë;
- Trajnimin për Kornizën e Vlerësimit të performancës së ISR (SAI PFM), në lidhje me konceptin, fazat e vlerësimit dhe çështjet kryesore që duhen marrë në konsideratë gjatë vlerësimit;
- Prezantimin e Raportit të Rishikimit Global të ISR-s për vitin 2020.

## RRJETI I ISR-VE I VENDEVE KANDIDATE DHE KANDIDATËVE POTENCIALË PËR ANËTARËSIM NË BE DHE GJYKATA EVROPIANE E REVIZORËVE

Në mbledhjen e rregullt vjetore të oficerëve për lidhje të IRS-së e cila u mbajt në mënyrë virtuale në shtator 2021, vëmendje qendrore u kushtua aktiviteteve për realizimin e planit kornizë të aktiviteteve të rrjetit për vitin 2021 e më tej. Në kuadër të projektit për revizion paralel të suksesit janë realizuar pesë punëtori virtuale. Ndihma profesionale dhe financiare për projektin siguroi ISR-ja e Suedisë, në koordinim me Grupin e Punës të Komitetit të Kontaktit për revizion të përbashkët (JWGAA) dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Gjykatës Evropiane të Revizorëve.

## BASHKËPUNIMI DYPALËSH DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL

Çështjet që lidhen me sfidat me të cilat përballen ISR-të në situatën e re për shkak të KOVID-19, kanë qenë edhe në fokus të takimeve dypalëshe të cilat i ka zhvilluar delegacioni i ESHR-së i kryesuar nga kryerevizori shtetëror, dhe atë:

- në shkurt 2021, në hapësirat e ESHR-së është mbajtur takimi dypalësh me ISR-në e Kosovës;
- në shtator 2021, u zhvillua takimi dypalësh me ISR-në e Republikës së Shqipërisë në Tiranë, Shqipëri, dhe
- në dhjetor 2021, në Vraje u mbajt takimi dypalësh me ISR-në e Republikës së Serbisë.

Përfaqësuesit e ESHR-së së bashku me kryerevizorin shtetëror morën pjesë në vizitë studimore në Republikën e Sllovakisë. Fokusi i vizitës studimore ishte decentralizimi fiskal, gjatë së cilës u përfshin edhe çështjet për kryerjen e kontrollit dhe revizionit të njësive të vetëqeverisjes lokale. Vizita u realizua si pjesë e projektit të zbatuar nga Ministria e Financave e Republikës së Sllovakisë me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Kjo ngjarje u përdor për realizimin e takimit dypalësh me përfaqësues të ISR-së së Republikës së Sllovakisë.

Qendra për përsosmëri në financa - CEF dhe ESHR forcuan partneritetin në zhvillimin e kapaciteteve të revizionit shtetëror. Si rezultat i këtyre aktiviteteve kryerevizori shtetëror së bashku me 16 revizorë shtetërorë nga Enti Shtetëror i Revizionit morën pjesë në trajnim për standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik IPSAS, e cila u mbajt në Ohër në tetor 2021. Gjatë kohës së trajnimit revizorët shtetërorë patën mundësinë të njihen me standardet individuale të IPSAS, si dhe sfidat dhe mundësitë e zbatimit të IPSAS nga vendet e rajonit, Italia, Mali i Zi, Shqipëria dhe Kosova.

# KËSHILLI NDËRKOMBËTAR I REVIZORËVE TË NATO-S (IBAN)

Me marrjen e statusit të Republikës së Maqedonisë së Veriut si anëtare e plotë e NATO-s në vitin 2020, Enti Shtetëror i Revizionit me përfaqësuesit e tij është ftuar dhe merr pjesë në takimin e Këshillit Ndërkombëtar të Revizorëve të NATO-s (IBAN). Ky takim në vitin 2021 është mbajtur në mënyrë virtuale dhe ESHR-ja ka marrë pjesë për herë të dytë me përfaqësuesit e saj. Në takim morën pjesë 29-të nga gjithsej 30-të përfaqësuesit nacionalë të Trupave Kompetentë Nacionalë të Revizionit (CNAB), me qëllim të diskutojnë për Raportin Vjetor të Aktiviteteve për vitin 2020, si dhe për çështjet e revizionit me interes të përbashkët.

### Aktivitetet tjera ndërkombëtare

Me ftesë të delegacionit monitorues të **Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (CLRAE)**, i kryesuar nga bashkësekretari i Komitetit të Monitorimit, në prill 2021 u mbajt takimi virtual me delegacionin e ESHR-së të kryesuar nga kryerevizori shtetëror. Lëndë e interesit të misionit monitorues ishin masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Kongresit 329 në fushën e demokracisë lokale në vendin tonë, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve nga revizionet e kryera nga ana e ESHR-së.

Me kërkesë të **Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN)** në vendin tonë, në maj 2021, u mbajt takimi i punës online në fokus të cilit ishin aktivitetet që i realizon ESHR-ja, si dhe revizionet e kryera për përdorimin e fondeve publike në lidhje me prokurimet e mjeteve mjekësore dhe pajisjeve për mbrojtjen e qytetarëve nga virusi korona.

Përfaqësuesit e ESHR-së gjatë vitit 2021 kanë mbajtur takime të shumta me ekspertë të **SIGMA-OECD**, në lidhje me zbatimin e vlerësimit vjetor të progresit të administratës publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe në lidhje me vlerësimin e shpenzimeve publike dhe llogaridhënies financiare, në bazë të metodologjisë PEFA.

Më 29 dhe 30 qershor 2021, në Shkup u mbajt konferenca ndërkombëtare me temë "Mbështetja e aktiviteteve të kontabilitetit e revizionit dhe sinergjitë", e organizuar nga **Instituti i Autorizuar për Financa Publike dhe Kontabilitet (CIPFA) dhe Qendra për Përsosmëri në Financat (CEF).** Konferenca u mbështet nëpërmjet financimit të projektit të trajnimit për certifikimin e kontabilistëve publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të mundësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Sllovenisë – Slovenian Aid.

Qëllimi i konferencës është që të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të personave zyrtarë në krye të financave në nivel rajonal dhe global nëpërmjet të mësuarit. Në konferencë pjesëmarrësit patën mundësinë të dëgjojnë përvojat ndërkombëtare në më shumë fusha, si: menaxhimi me fondet publike, lufta kundër korrupsionit, udhëheqja për reformat, si dhe promovimi i të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive te kontabilistët dhe revizorët. Ditën e dytë të konferencës, me fjalim u paraqit edhe kryerevizori shtetëror, në të cilin i njoftoi pjesëmarrësit për rolin e rëndësishëm të ESHR-së në shtet si institucion suprem i revizionit, mandej duke potencuar transparencën dhe llogaridhënien e rritur të institucionit për punën dhe rezultatet e revizionit, drejt të gjitha palëve të jashtëm të interesuar.




Në shtator 2021 në Tiranë, Shqipëri, Kryerevizori shtetëror, bashkë me përfaqësuesit e ESHR-së, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale nga Republika e Maqedonisë së Veriut morën pjesë në **ngjarjen rajonale për vendosjen e perspektivës gjinore në menaxhimin me financat publike dhe njohuritë e sistemit integrues për menaxhimin me financat.** Në ngjarje u prezantua përparimi në zbatimin e buxhetimit me përgjegjësi gjinore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe proceset në vazhdim për avancimin e kornizës institucionale dhe juridike për avancimin e barazisë gjinore. Ngjarja rajonale ishte mundësi e madhe për të shkëmbyer përvoja, praktika të mira dhe dialog mbi sfidat me të cilat përballen vendet e Ballkanit Perëndimor, por në të njëjtën kohë edhe duke zhvilluar takim dypalësh me ISR-në e Republikës së Shqipërisë.

Në kuadër të **Projektit të Tviningit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e së Drejtës**" Komponenta 3 e cila fokusohet në përmirësimin e parandalimit dhe luftën kundër korrupsionit përveç shumicës së aktiviteteve është edhe aktiviteti për të sponsorizuar studimet e magjistraturës në Akademinë me renome ndërkombëtare për antikorrupsion (IACA) në Laksemburg, Austri. Projekti mbështet gjithsej 12 kandidatë – nëpunës shtetërorë të punësuar në institucione të zgjedhura gjatë pesë viteve, ndërmjet tyre edhe dy punonjës të Entit Shtetëror të Revizionit. Kandidatët e zgjedhur do të marrin diplomë me njohuri ndërkombëtare për studime të magjistraturës në fushën kundër korrupsionit.

Programi i magjistraturës ofron program të ndryshëm dhe inovativ për luftë kundër korrupsionit. Programi në vete përmban disiplina të ndryshme akademike të nevojshme për të siguruar vështrim tërësor në parandalimin e korrupsionit dhe sistemin e pajtueshmërisë me rregullativat, njëkohësisht duke ofruar njohuri praktike dhe ekspertizën. Qëllimi është nëpërmjet rrjetëzimit dhe ndërtimit të ekipit, që të diplomuarit t'i bashkohen rrjetit të gjerë të aluminëve të profesionistëve kundër korrupsionit.

## 4.1. AKTIVITETET E PROJEKTIT

### TVINING PROJEKTI "PËRMIRËSIMI I REVIZIONIT TË JASHTËM DHE MBIKËQYRJA PARLAMENTARE"

Enti Shtetëror i Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Revizionit të Republikës së Kroacisë (ESHR i Kroacisë) si partner i vjetër dhe Enti Nacional i Revizionit të Republikës së Bullgarisë (BNAO), si partner i ri, më 1 shkurt 2021 filloi të zbatohet Projekti i Tviningit "Përmirësimi i Revizionit të Jashtëm dhe Mbikëqyrja Parlamentare". Periudha e parashikuar për implementimin e këtij Projekti të Tviningit është 21 muaj dhe pritet të realizohet deri më 31 tetor 2022.

Vlera e Projektit të Tviningit është 1.5 milionë euro dhe financohet nga fondet IPA 2018 të Bashkimit Evropian.

Qëllimi i Tvining Projektit është të përmirësojë efikasitetin dhe ndikimin e revizionit të jashtëm nëpërmjet harmonizimit të kornizës juridike dhe zhvillimin e mjeteve metodologjike, si dhe nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të ESHR-së për kryerjen efikase të revizionit të jashtëm. Përveç kësaj, projekti ka për qëllim të përmirësojë kontrollin parlamentar mbi fondet publike dhe të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit dhe Kuvendit të RMV-së.

Aktivitetet e Tvining Projektit janë organizuar dhe strukturuar në katër komponentë, si vijojnë: (në infografik)

Komponenti 1: Forcimi i kornizës juridike relevante për revizionin e jashtëm;

Komponenti 2: Përmirësimi i kapaciteteve administrative dhe proceseve të revizionit të jashtëm;

Komponenti 3: Përmirësimi i funksionit të kontrollit legjislativ të Parlamentit të bazuar në shqyrtimin dhe diskutimin e raporteve të revizionit të ESHR-së; dhe

Komponenti 4: Përmirësimi i komunikimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe TI-së dhe kapacitetet e revizionit të TI-së.

Aktivitetet e zbatuara në Tvining Projektin në periudhën prej 12 muaj ishin planifikuar në kuadër të katër planeve të punës rrjedhëse.

Zbatimi i aktiviteteve në Tvining Projektin vazhdon edhe në vitin 2022 në përputhje me Planet rrjedhëse të punës.

## FONDACIONI PËR DEMOKRACI VESTMINSTER (WFD) NË SHTET

Enti Shtetëror i Revizionit dhe Fondacioni për Demokraci Vestminster (WFD) në shtet, në bashkëpunim me Institutin për Hulumtime të Zhvillimit Social RESIS, edhe në rrjedhën e vitit 2021 e vazhduan historinë e suksesit dhe bashkëpunimin cilësor në kuadër të projektit "Mbështetja për zbatimin e strategjisë për komunikimin e Entit Shtetëror të Revizionit".

Në vitin e kaluar janë organizuar dhe zbatuar me sukses 3 punëtori për forcimin e njohurive dhe aftësive të revizorëve të ESHR-së.

Enti Shtetëror i Revizionit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zhvillimit të Komonuelthit Britanik dhe Fondacioni për Demokraci Vestminster në shtet, nënshkruan Memorandum për Mirëkuptim me të cilën u formalizua bashkëpunimi i suksesshëm i deritanishëm dhe aktivitetet të cilat janë në vijim në periudhën e mëtutjeshme.

Në fund të vitit, më 20 dhjetor 2021, Enti Shtetëror i Revizionit në bashkëpunim me Fondacionin për Demokraci Vestminster, organizuan dhe realizuan me sukses ngjarjen – Takim pune me palët e interesuara, i cili ishte mundësi e shkëlqyer për të forcuar komunikimin dhe për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet përfaqësuesve të mediave, organizatave qytetare dhe institucioneve kompetente.

## TRUPI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR BARAZINË GJINORE DHE FORCIMIN E GRAVE - UN WOMEN

Enti Shtetëror i Revizionit dhe Trupi i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Forcimin e Grave - UN Women në qershor 2021 nënshkruan Memorandum për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim. Ky memorandum u nënshkrua me qëllim që të dyja palët të bashkëpunojnë në avancimin e zbatimit të detyrimeve për barazinë gjinore në përputhje me ligjet dhe politikat nacionale, si dhe detyrimet e ndërmarra ndërkombëtare dhe promovimin e përgjegjësisë gjinore dhe menaxhimit me mjetet publike dhe llogaridhënien nëpërmjet zbatimit sistematik të buxhetit të përgjegjësisë gjinore si mjet për krijimin e politikave.

Në drejtim të plotësimit të qëllimeve të përcaktuara u mbajtën punëtori të shumta ku morën pjesë 90 punonjës të ESHR-së, ku pjesëmarrësit u njohën me metodologjinë e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe nismat për përmirësimin e programeve të sektorëve në shumë institucione shtetërore nga perspektiva gjinore, nëpërmjet përgatitjes së procesit të deklaratës buxhetore gjinore. Enti Shtetëror i Revizionit është një nga institucionet në të cilin ka shkallë të lartë të balancimit gjinor, si në udhëheqësin e institucionit, ashtu edhe në mesin e revizorëve të autorizuar shtetërorë.

## PROGRAMI I ZHVILLIMIT I KOMBEVE TË BASHKUARA (UNDP)

Në vitin 2021, Enti Shtetëror i Revizionit realizoi bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), në kuadër të projektit "Mbështetja për reformat në financimet publike", të financuar nga Ministria e Financave e Republikës së Sllovakisë. Në fokus të këtij bashkëpunimi është forcimi i kapaciteteve të Entit Shtetëror të Revizionit në kryerjen e revizioneve të raporteve financiare në bazë akruale, në drejtim të zbatimit me sukses të programit të reformës për menaxhimin me financat publike nëpërmjet promovimit të transparencës, llogaridhënies, disiplinës fiskale dhe efikasitetit në menaxhimin dhe përdorimin e fondeve publike. Në drejtim të vazhdimit të bashkëpunimit të ndërsjellë, Enti Shtetëror i Revizionit dhe UNDP-ja në vitin 2022, nënshkruan Memorandum për Mirëkuptim në të cilën definohen aktivitetet e ardhshme të përbashkëta që synojnë ndërtimin e sistemit më efikas dhe efektiv të revizionit shtetëror.

# 5

# REVIZIONET E KRYERA

Rezultatet nga aktivitetet e konstatuara të revizionit me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021 janë përfshirë në grafikonin e theksuar të paraqitur më poshtë si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **97** | **7** | **3** |
| Raportet e revizorit për revizionin e rregullshmërisë | Raportet e revizorit për revizionin e suksesit | Revizioni i pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit |
| **2** | **109** | **9** |
| Revizioni i TI-së | Raportet e revizionit të dorëzuar Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut | Raportet e revizionit të dorëzuar Prokurorisë Publike të RMV-së |
| **9** | **2** | **136** |
| Raportet e revizionit të dorëzuar Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit në RMV. | Raportet e revizionit të dorëzuar te Qeveria e RMV-së - Zëvendëskryetarja e Qeverisë e ngarkuar për politikat e qeverisjes së mirë | Subjektet e përfshira me revizion |
| **1.170** | **654** | **511.923** |
| Gjetjet në raportet e revizionit | Rekomandimet në raportet e revizionit | Të hyrat publike të përfshira me revizion (në milion denarë) |
| **236.060** | **135.320** | **3.923** |
| Shpenzimet publike të përfshira me revizion (në milion denarë) | Aktive/pasive të reviduara nga Bilanci i gjendjes (në milion denarë) | Regjistrimet të përgjithshme korrektuese në Bilancet e gjendjes (në milion denarë) |
| **33** | **97** | |
| Janë kryer kontrolle për përcaktimin e statusit të rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit (follow up) | Janë lëshuar raportet për kontrollet e zbatuara për përcaktimin e statusit të rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit (follow up) | |

# AKTIVITETET E REVIZIONIT PËRMES NUMRAVE

**109** RAPORTE TË REVIZIONIT

**MENDIME TË REVIZIONIT REVIZIONI I RREGULLSHMËRISË**

**96** mendime për raportet financiare:

- **31** pa rezervë
- **26** me rezervë
- **31** mendime të pavolitshme dhe
- **8** mendime të përmbajtura

**92** mendime për pajtueshmëri me rregulla dhe ligje

- **23** pa rezervë
- **35** me rezervë
- **32** mendime të pavolitshme dhe
- **2** mendime të përmbajtura

**PËRFUNDIMET REVIZIONI I PAJTUESHMËRISË/ REVIZIONI I SUKSESIT**

- **3** përfundime për revizionin e pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit
- **7** përfundime për revizionin e suksesit
- **2** përfundime për revizionin e TI-së

**1.170** ⚠ GJETJE TË KONSTATUARA ME REVIZION

- **942** revizione të rregullshmërisë
- **144** revizione të suksesit
- **71** revizione të pajtueshmërisë
- **13** revizione të TI-së

**136** SUBJEKTE TË PËRFSHIRA ME REVIZION

- **56** revizione të rregullshmërisë
- **63** revizione të suksesit
- **15** revizione të pajtueshmërisë
- **2** revizione të TI-së

**72** GJETJE TE PROKURIMET PUBLIKE

NË MIJË DENARË VLERA E PËRGJITHSHME E KONTRATAVE TË NDARA PËR PROKURIMET PUBLIKE

**40.357.958**

në 000 denarë

NË MIJË DENARË PROKURIME PUBLIKE TË REVIDUARA

**36.497.709**

në 000 denarë

**5.975.562** ⚠ NË MIJË DENARË PARREGULLSI TË KONSTATUARA TE PROKURIMET PUBLIKE

në 000 denarë

- dobësi në realizimin e kontratave të lidhura për prokurimet publike;
- Dobësi në fazën e lidhjes së kontratës për prokurimet publike,
- parregullsi gjatë përgatitjes së dokumentacionit të tenderit/specifikime teknike;
- dokumentacioni i tenderit e cila në vete përfshin elemente të kufizuara në lidhje me konkurrencën;
- parregullsi në vlerësimin e ofertave;
- dobësi në fazën e planifikimit të prokurimeve publike

# TË HYRAT DHE SHPENZIMET

Me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021 në të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme publike të reviduara të cilat janë shfaqur në grafikun më poshtë, janë përfshirë edhe të hyrat publike në shumë prej 15.683 milion denar dhe shpenzime publike 17.173 milion denarë, të cilat i referohen personave juridik në të cilat shteti është pronari që dominon (SHA ELEM dhe SHA QTQ), ndërmarrje publike dhe institucione tjera.

Gjithsej **511.923 MILION DENARË** të ardhura publike të reviduara dhe **236.060 MILION DENARË** shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021



Me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021, përfshirja e shpenzimeve të reviduara të Buxhetit të RMV-së për vitin 2020, është 80%. Në strukturën e shpenzimeve të reviduara, janë përfshirë shpenzimet me revizionin e rregullshmërisë në vlerë prej 129.478 milion denarë gjegjësisht 53%, shpenzime me revizionin e suksesit në vlerë prej 61.844 milion denarë gjegjësisht 26% dhe shpenzime me revizion të pajtueshmërisë në vlerë prej 2.416 milion denarë gjegjësisht 1%.

**Përfshirja e Buxheteve nëpërmjet shpenzimeve të reviduara me PV të ESHR-së për 2021**

| Shpenzimet e reviduara sipas llojet e buxheteve (në milion denarë) | Buxhet i kryer për 2020 | Të reviduar | Pjesëmarrja në % |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| Shpenzimet e buxhetit të RMV-së për vitin 2020 (Llogaria përfundimtare e Buxhetit të RMV-së për 2020 Gazeta Zyrtare e RMV-së 71/2022 nga 22.03.2022) | 243.241 | 193.738 | 80% |
| Buxheti i njësive të vetëqeverisjes lokale | 33.048 | 2.829 | 9% |

# REKOMANDIMET DHE ZBATIMI I TYRE

Në përputhje me Ligjin për revizion shtetëror, përfaqësuesi ligjor i subjektit është i detyruar të informojë ESHR-në dhe organin përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin, për masat e ndërmarra në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet në raportet e revizionit në afat prej 90 ditëve nga pranimi i raportit përfundimtar. ESHR-ja e ndjek zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e revizionit në kuadër të kryerjes së revizioneve të rregullta, revizioneve të veçanta dhe kontrollin e zbatimit të rekomandimeve, si dhe përmes informacionit të marrë nga subjektet.

## 2021

**654** REKOMANDIMET E DHËNA:

- **300** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE;
- **354** REKOMANDIME PËR TË CILAT NUK KA SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE;
- **93** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE NUK ËSHTË PËRCAKTUAR STATUSI

**207** REKOMANDIME ME STATUS TË PËRCAKTUAR

**88%** ËSHTË VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE;

**182** REKOMANDIME PËR TË CILAT JANË NDËRMARRË MASA;

**23** nuk janë zbatuar;

**2** të pazbatueshme;

# 2020

**604** REKOMANDIMET E DHËNA

- **604** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE

**81%** ËSHTË VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE

**542** REKOMANDIME ME STATUS TË PËRCAKTUAR

- **62** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE NUK ËSHTË PËRCAKTUAR STATUSI

**439** REKOMANDIME PËR TË CILAT JANË NDËRMARRË MASA

**90** nuk janë zbatuar

**13** të pazbatueshme

# 2019

**498** REKOMANDIMET E DHËNA

- **498** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE

**83%** ËSHTË VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE

**441** REKOMANDIME ME STATUS TË PËRCAKTUAR

- **57** REKOMANDIME PËR TË CILAT ËSHTË SKADUAR AFATI PREJ 90 DITËVE PËR DORËZIMIN E INFORMATAVE KTHYESE NUK ËSHTË PËRCAKTUAR STATUSI

**364** REKOMANDIME PËR TË CILAT JANË NDËRMARRË MASA

**73** nuk janë zbatuar

**4** të pazbatueshme

## 5.1. VLERA E SHTUAR E REVIZIONEVE

Me Programin Vjetor për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2020 janë përcaktuar qëllimet dhe detyrat për punën, të cilat janë në drejtim të realizimit të qëllimeve strategjike. Aktivitetet e ndërmarra për realizimin e qëllimeve strategjike sigurojnë përfshirje përkatëse të mjeteve publike të reviduara, përmirësimin e kapaciteteve të punonjësve për zbulimin e parregullsive, si dhe kryerjen e revizioneve të suksesit në programet dhe projektet e ndryshme që janë në funksion të realizimit të objektivave të revizionit, përkatësisht përgjegjësisë dhe menaxhimit të mirë, rishikimit të rezultateve në bazë të aktiviteteve ekonomike, efikase dhe efektive të sektorit publik.

Rezultatet kryesore nga puna e Entit Shtetëror të Revizionit në vitin 2020 përbëhen nga:

- mbështetja e Kuvendit të RMV-së në përmbushjen e kompetencave të tij nëpërmjet identifikimit dhe prezantimit të parregullsive, resteve të paligjshme të punës dhe rasteve të mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimit të funksionit;
- dhënia e rekomandimeve të qarta dhe efektive për institucionet shtetërore dhe të tjera nga sektori publik në avancimin e menaxhimit me mjetet publike;
- duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së përdorimit të fondeve publike / fondeve të tatimpaguesve, ndërsa me to edhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes shërbimeve të ofruara me respektimin e parimeve të sigurisë në ofrimin e shërbimeve, vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimit, transparencës, qasjes dhe shërbimit universal, mbrojtjes së përdoruesve dhe qytetarëve;
- gjendja e konstatuar e evazionit fiskal, mospagimi i detyrave dhe shtesave publike në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me çka ESHR-ja siguron kthimin e fondeve të investuara nga Buxheti i RMV-së në ESHR.
- revizioni në ndarjen e marrëveshjeve për PP me theks të veçantë në ndarjen e marrëveshjeve për PP në kushtet e pandemisë;
- dhënien e udhëzimeve për mënyrën e planifikimit të investimeve kapitale, sigurimin e mjeteve të nevojshme dhe monitorimin e realizimit të tyre (me vështrim të veçantë të mjetev të siguruara nga kreditorët ndërkombëtar) dhe përcaktimin e efekteve nga investimet e theksuara;
- monitorimi i shkallës së huamarrjes dhe kontributit të dhënë në mënyrën menaxhimi me financat publike.

# VLERA E SHTUAR E REVIZIONEVE

VLERA E SHTUAR E REVIZIONEVE

**1.743.644**
Kompensimet e papaguara më pak të paguara në Buxhetin e RMV-së

**121.838**
Kompensimet e papaguara më pak të paguara në Buxhetin e RMV-së të komunave të reviduara

**1.323.941**
Përdorimi i mjeteve në kundërshtim me ligjin

**5.975.562**
Shuma e përgjithshme nga parregullsitë e konstatuara te PP-ja

**36.497.709**
Përfshirja e PP-së me revizionet

**135.320.350**
Aktiva/ pasiva e përgjithshme

**3.922.995**
Regjistrimet korrektuese në Bilancet e gjendjes

në 000 denarë

## 5.2. BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2020

### 5.2.1. BUXHETI THEMELOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2020

Menaxhimi i mirë me financat publike është një nga prioritetet kryesore të shtetit me të cilat mundëson stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë e tyre. Përgatitja, miratimi dhe realizimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është proces që ka për qëllim ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik nacional.

Në Ligjin për buxhete janë rregulluar mënyra dhe afatet për aktivitetet kryesore të procedurës për përgatitjen dhe miratimin e Buxhetit të RMV-së. Nga marsi i vitit 2020, zbatimi i Ligjit për buxhete është përshtatur me gjendjen e krijuar të shkaktuar nga pandemia globale e virusit COVID-19.

Me revizionin konstatuam se aktivitetet për përgatitjen e Buxhetit të RMV-së për vitin 2020, në pjesën më të madhe janë zbatuar në përputhje me rregullativën ligjore, por është e nevojshme të forcohen aktivitetet dhe të plotësohen kërkesat buxhetore nga shfrytëzuesit buxhetorë me planet strategjike, për t'i harmonizuar me qëllimet strategjike të Qeverisë dhe për të përmirësuar cilësinë e procesit të përgjithshëm të planifikimit të buxhetit të shtetit.

Ashtu si në vitet e kaluara, mjetet të cilat janë ndarë nga Buxheti i vitit 2020 për financimin e Pushtetit Gjyqësor nuk e arrijnë përqindjen e përcaktuar me ligj. Gjithashtu, për mjetet e dedikuara për zhvillimin e barabartë rajonal, nuk ekziston kufizimi i qartë, as koordinimi ndërmjet institucioneve kompetente, për të konfirmuar shpërndarjen e duhur të tyre në përputhje me përqindjen e përcaktuar me ligj.

Buxheti Themelor i RMV-së për vitin 2020 është miratuar në shumë prej 191.003.525 mijë denarë dhe në krahasim me vitin 2019 është më i lartë për 23%.

Kriza shëndetësore dhe ekonomike ka ndikuar në Buxhetin për vitin 2020, gjegjësisht me ndryshimet dhe plotësimet e tij është rritur në 204 miliardë denarë, përkatësisht për rreth 5% në krahasim me planifikimin fillestar. Në mënyrë evidente u rrit edhe deficiti buxhetor në 8.11% të BPV-së, që para pandemisë ishte projektuar në 2.35% të BPV-së.

Struktura e shpenzimeve në Buxhetin Themelor të RMV-së (llogaria 637) me ndryshimet dhe plotësimet në vitin 2020, sipas klasifikimit funksional të shpenzimeve, është paraqitur në grafikonin e mëposhtme:

## STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT THEMELOR PËR VITIN 2020 - LLOGARIA 637, SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL



Gjatë planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve respektohet parimi i baraspeshës buxhetore, që nënkupton totalin e të ardhurave dhe të hyrave për t'i mbuluar mjetet e miratuara me buxhet. Të hyrat nga huamarrja përdoren për të mbuluar deficitin buxhetor, në drejtim të mbajtjes së likuiditetit buxhetor. Në vitin 2020 financimi i deficitit si dhe shlyerja e borxhit, janë siguruar nëpërmjet huamarrjes nga burime të huaja dhe të brendshme.

Të ardhurat dhe të hyrat e përgjithshme në vitin 2020 janë realizuar në shumë prej 214.889.324 mijë denarë, gjegjësisht për 35% më shumë në krahasim me vitin 2019. Rritja e tyre në pjesën më të madhe vjen si pasojë e rritjes së të hyrave nga huamarrjet në vend (91%) dhe jashtë vendit (663%), si dhe realizimit të reduktuar të të ardhurave në krahasim me vitin 2019, dhe atë të të ardhurave tatimore prej 8%, të të ardhurave jotatimore për 15% dhe të të ardhurave kapitale për 23%.

Të ardhurat dhe të hyrat e realizuara në vitin 2019 dhe 2020 janë paraqitur në grafikonin e mëposhtme:

## TË ARDHURAT DHE TË DALAT E REALIZUARA NË VITIN **2019 DHE VITIN 2020**




Të ardhurat tatimore të cilat janë në kompetencën e Drejtorisë Doganore dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe në vitin 2020 kanë pjesëmarrjen më të madhe prej 49% në totalin e të ardhurave dhe të hyrave, por dukshëm më të ulëta se në vitin 2019, kur pjesëmarrja e tyre ishte 71%, që i përket rritjes së huamarrjes së shtetit brenda dhe jashtë vendit.

Të ardhurat tatimore në vitin 2020 janë realizuar në shumë të përgjithshme prej 104.377.674 mijë denarë, ku pjesëmarrjen më të madhe prej 45% e kanë të ardhurat nga TVSH-ja. Nën ndikimin e krizës shëndetësore dhe ekonomike, në vitin 2020 te të gjitha llojet e të ardhurave tatimore është shënuar ulje në krahasim me vitin 2019, ndërsa një pjesë e aktiviteteve të DAP-it janë të orientuara drejt realizimit të masave të Qeverisë së RMV-së të miratuara për t'u përballur me krizën.

Duke i pasur parasysh kompetencat aktuale dhe shtesë të cilat i kryen DAP-i, si dhe strukturën e punonjësve të saj, revizioni në vazhdimësi jep rekomandime për analizën e nevojës për forcimin dhe ndarjen adekuate të burimeve të

stafit të DAP-it, si dhe përmirësimin e sistemeve të TI-së, në drejtim të realizimit efikas të kompetencave parësore me administrimin dhe kontrollimin e të ardhurave tatimore dhe taksave publike, si të ardhurave të Buxhetit të RMV-së.

Me revizionin konstatuam se shuma bruto e arkëtuar e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar - TVSH është ulur për 7%, krahasuar me vitin 2019. Në drejtm të përcaktimit të mbulimit të kthimit të TVSH-së me kontrollet nga DAP-i, në ekzemplarin e përzgjedhur prej 122 tatimpaguesve të cilëve u është kthyer TVSH-ja në vitin 2020, kemi vërtetuar se në periudhën 2016-2020 te 8 tatimpagues (7%) nuk është kryer kontrolli. Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e të ardhurave tatimore bazohen në pagesën e TVSH-së, si dhe te 40% e tatimpaguesve që kanë bërë kthimin e TVSH-së janë konstatuar parregullsi, përcaktuam se rritja e numrit të kontrolleve do të ulte rrezikun e veprimit të paligjshëm të tatimpaguesve në krahasim të pagesës dhe llogaritjes së saktësisë dhe tërësisë së TVSH-së, që do të ndikonte në rritjen e të ardhurave buxhetore, për të cilin qëllim rekomanduam forcimin e ekipimit kadrovik me rritjen e numrit të inspektorëve tatimorë.

Gjithashtu, konstatuam nevojën për rregullimin e rregullativës për mënyrën e veprimit të DAP-it në rast të marrjes së kompetencës së komunave gjatë konstatimit të parregullsive në punën e tyre në fushën e tatimit mbi pronë, të cilat edhe pse nuk janë të ardhura të drejtpërdrejta të Buxhetit të RMV-së, duke e pasur parasysh situatën me jostabilitetin financiar dhe nevojën e vazhdueshme për ndihmën financiare të komunave nga ana e buxhetit qendror, është e domosdoshme të forcohet mbikëqyrja e tyre nga ana e DAP-it.

Në Buxhetin Themelor akcizat, administrimi i të cilave është në kompetencën e Drejtorisë Doganore, janë arkëtuar në shumë të përgjithshme prej 22.118.581 mijë denarë, që është për 11% më pak në krahasim me vitin 2019.

Një nga kompetencat themelore të Drejtorisë Doganore është zbatimi i kontrollit doganor dhe akcizës në përputhje me Planin Vjetor për kontrollin e shoqërive tregtare. Revizioni konstatoi se gjithsej 567 shoqëri tregtare i nënshtrohen kontrollit të akcizës, gjatë të cilit me Planin Vjetor për vitin 2020 janë përfshirë vetëm 5% të shoqërive tregtare për kontrollin e akcizës. Arsye e rëndësishme, e cila ndikon në funksionimin e departamentit për kontrollin e shoqërisë tregtare dhe mbi numrin e kontrolleve të kryera, është ekipimi i pamjaftueshëm kadrovik i tyre.

Sistemet e informacioneve të vendosura të Drejtorisë Doganore kontribuojnë në zbatimin efikas të kontrolleve rreth taksave doganore, akcizave, tarifave dhe taksave të tjera të arkëtuara dhe të kthyera, lehtësimin e tregtisë përmes qarkullimit të përshpejtuar të mallrave si dhe përmirësimin e sigurisë së zinxhirit të furnizimit, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe Organizatës Botërore të Doganave, por përqindja e ulët e plotësimit të vendeve të parapara të punës në Sektorin e TIK-së nga 37% mund të ndikojnë te efikasiteti i realizimit të kompentecave, duke pasur parasysh si vëllimi i punës ashtu edhe mbështetja e numrit të madh të aplikacioneve të cilat janë në zbatim në Drejtorinë Doganore.

Në vitin 2020, në bazë të huamarrjeve në vend, janë evidentuar të hyra në shumë të përgjithshme prej 36,346,854 mijë denarë, që është 91% më shumë se në vitin 2019, si rezultat i të hyrave nga obligacionet shtetërore të lëshuara dhe nga huamarrjet afatshkurta te bankat e brendshme. Të hyrat nga huamarrjet e brendshme përfshijnë 38% të totalit të të hyrave në bazë të huamarrjes së shtetit.

Në bazë të huamarrjes jashtë vendit në vitin 2020 janë realizuar të hyra në shumë prej 58.531.061 mijë denarë, të cilat në krahasim me vitin 2019 janë rritur për 663%. 73% janë të hyra nga eurobondi i lëshuar i RMV-së në tregun ndërkombëtar të kapitalit.

Në strukturën e shpenzimeve dhe të dalave të kryera të Buxhetit Themelor të RMV-së për vitin 2020, pjesëmarrjen më të madhe kanë shpenzimet për pagesën e kryegjësë me 20.78%, transferet aktuale te fondet jashtëbuxhetore me 19.49% shpenzimet për subvencionet dhe transferet me 15.21% si dhe shpenzimet për paga, mëditje dhe kompensime me 13.89%.

Të gjitha shpenzimet dhe të dalat në vitin 2020 janë realizuar në shumë prej 201.058.216 mijë denarë dhe në krahasim me vitin paraprak janë më të larta për 32%.

Pjesëmarrja e llojeve individuale të shpenzimeve dhe të dalave të tjera në krahasim me totalin e shpenzimeve dhe të dalave të kryera në Buxhetin Themelor të RMV-së për vitin 2020 është paraqitur në grafikën e mëposhtme:

## STRUKTURA E SHPENZIMEVE DHE DALJEVE TË BUXHETIT THEMELOR TË RMV-**SË PËR VITIN 2020**




Në Fondin e SPIMV-së gjatë vitit 2020 janë transferuar mjete buxhetore në shumë prej 31.142.043 mijë denarë, përkatësisht për 10,81% më shumë në krahasim me vitin 2019.

Me revizionin konstatuam se deficiti i Fondit të SPIMV-së për pagesën e pensioneve në vitin 2020 është 17.286.020 mijë denarë, që është 29% nga gjithsej burimet e mjeteve për pagesën e pensioneve dhe është rritur për 3% në krahasim me vitin 2019.

Trendi i pjesëmarrjes me përqindje të mjeteve buxhetore për mbulimin e deficitit të Fondit të SPIMV-së për pagesën e pensioneve për periudhën 2011-2020, i paraqitur në grafikën e mëposhtme, tregon nevojën e vazhdueshme për mbështetje financiare të Fondit të SPIMV-së për pagesën e pensioneve në vend, me mjete nga Buxheti i RMV-së..

## PJESËMARRJA NË PËRQINDJE E TRANSFEREVE NGA BUXHETI THEMELOR PËR MBULIMIN E DEFICIDIT RRJEDHËS TË FONDIT TË SPIMV-SË NGA **VITI 2011-2020**



Nga Buxheti Themelor i RMV-së në vitin 2020, përmes ministrive kompetente, si transfere rrjedhëse për NJVL-të, janë realizuar dotacione në shumë të përgjithshme prej 21,373,057 mijë denarë, që paraqet 11% të shpenzimeve totale të Buxhetit Themelor të RMV-së për vitin 2020. Në krahasim me vitin 2019, këto transfere janë rritur për 11%.

Pjesëmarrjen më të madhe në transferet kanë bllok-dotacionet, të cilat përfaqësojnë 87% të mjeteve totale të paguara ndaj NJVL-së, dotacionet e TVSH-së marrin pjesë me 11%, ndërsa pjesëmarrja e dotacioneve me dedikim është 2%.

Me revizionin konstatuam se Grupi Punues Ndërresor, i ngarkuar për analizimin e gjendjeve dhe ridefinimin e kritereve për dotacionet e dedikuara dhe bllok-dotacionet për komunat ka përgatitur Raport me propozime për ministritë kompetente, por deri në ditën e revizionit rekomandimet e propozuara ende nuk janë zbatuar.

Në totalin e shpenzimeve të realizuara të Buxhetit Themelor për vitin 2020, shpenzimet për subvencione dhe transfere marrin pjesë me 15%, gjegjësisht janë realizuar në shumë totale prej 30,574,427 mijë denarë, që është për 32% më shumë në krahasim me vitin 2019.

Në periudhën 2016–2020 shpenzimet për subvencione dhe transfere janë rritur ndjeshëm dhe në vitin 2020 krahasuar me vitin 2016 janë 3 herë më të larta.




Më të rëndësishme janë shpenzimet për transfere të ndryshme në shumë prej 27.618.662 mijë denarë, të cilat paraqesin 90% nga shpenzimet totale për subvencione dhe transfere, në të cilat në vitin 2020 pjesëmarrje të konsiderueshme prej 46% kanë shpenzimet nga nënprogrami i Qeverisë së RMV-së P1- Masat për menaxhimin me krizën COVID-19.

Në pjesën e shpenzimeve kapitale, 55% janë shpenzime për pagesën e garancive, prej të cilave 78% i referohen pagesës së borxhit të jashtëm për "NP për Rrugë Shtetërore" për ndërtimin e segmentit rrugor të autostradës Milladinovci-Shtip dhe segmentit rrugor Kërçovë-Ohër, 20% për "Hekurudhat e RMV-së Transport" SHA Shkup për Projektin për prokurimin e mjeteve të reja tërheqëse dhe 2% për Projektin për reforma në hekurudhën.

Me Ligjin për buxhete është rregulluar se huamarrja është procedurë për krijimin e detyrimeve financiare me lidhjen e marrëveshjeve për hua, emetimi i letrave me vlerë shtetëror dhe detyrimeve me garanci shtetërore të aktivizuara. Në Ligjin për borxhin publik është rregulluar se për huamarrje të Buxhetit të RMV-së, MF-ja në emër të RMV-së, mund të hyjë në borxh deri në shumën e nevojshme maksimale për financimin e deficitit buxhetor dhe rifinancimin e detyrimeve nga borxhi shtetëror për dy vitet rrjedhëse dhe të ardhshme fiskale, të përcaktuara në Buxhetin e RMV-së dhe Strategjinë Fiskale.

Në përputhje me të dhënat e MF-së, kemi krahasuar deficitin buxhetor, nivelin e borxhit publik dhe normën e rritjes ekonomike në periudhën 2010-2020, të paraqitur në grafikën e mëposhtme:

## BORXHI PUBLIK, DEFICITI BUXHETOR (% NGA BPV) DHE RRITJA EKONOMIKE%




Është evidente, borxhi publik në periudhën 2010-2020 ka trend të vazhdueshëm të rritjes si përqindje të BPV-së, trend i cili vërehet edhe te deficiti, i cili për shkak të funksionimit të ekonomisë në kushtet e pandemisë në vitin 2020 është më i madh dhe është 8,11% të BPV-së.

Me analizën e portfolios së borxhit publik nëpërmjet synimit të huamarrjes, përcaktuam se nga shuma totale e borxhit publik prej 6.483 milion euro, 75% gjegjësisht 4.842 milion euro është krijuar për financimin e deficitit buxhetor, ndërsa 25% gjegjësisht 1.641 milion euro është borxhi për financimin e projekteve dhe investimeve.

Ministria e Financave nëpërmjet vendosjes së veglës - sistemi elektronik për paraqitjen dhe evidentimin e detyrimeve, në faqen e saj të internetit në bazë tremujore publikon raporte përmbledhëse për paraqitjen e detyrimeve nga subjektet, për të cilat duhet të kryhej mbikëqyrja me qëllim që të konfirmohet nëse shuma që është paraqitur i pasqyron detyrimet reale të subjekteve.

Konstatuam se deri në ditën e përfundimit të revizionit nuk është kryer asnjë mbikëqyrje nga ana e Sektorit për Inspektim Financiar, ndonëse është dorëzuar lista e subjekteve që nuk i kanë paraqitur detyrimet, në mënyrë që të veprojmë më tej. Gjendjet e theksuara sugjerojnë rrezik nga të dhënat e plota për detyrimet e paraqitura më 31 dhjetor 2020, që mund të ketë ndikim gjatë përpilimit të dokumenteve strategjike, të nevojshme për fillimin e procedurës për miratimin dhe planifikimin e buxhetit të Republikës për periudhën e ardhshme.

Në lidhje me jostabilitetin financiar të komunave, me revizionin konstatuam se në dhjetor 2020 nga gjithsej 81 komuna, 11 janë me llogari të bllokuara, ndërsa deri në periudhën e revizionit nuk është dorëzuar asnjë vendim për shpalljen e jostabilitetit financiar, për shkak që Ministria e Financave nuk ka formuar trup koordinativ për tejkalimin e jostabilitetit financiar të komunave.

Kjo gjendje mundëson që komunat të gjenerojnë detyrime të reja në baza të ndryshme, të fillojnë projekte të reja kapitale, që mund të ndikojë në përkeqësimin e likuiditetit të tyre dhe të gjendjes së përgjithshme financiare në të ardhmen, ndërsa kjo mundëson për nevojën plotësuese për ndarjen e mjeteve nga Buxheti i RMV-së si ndihmë financiare të tyre, që do të thotë ngarkesë plotësuese në Buxhetin e RMV-së.

## 5.2.2. MENAXHIMI ME BORXHIN PUBLIK – HUAMARRJA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Revizioni i suksesit me temë "Menaxhimi i borxhit publik – Huamarrja e Republikës së Maqedonisë së Veriut" që përfshin periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2020 deri në ditën e njoftimit për revizionin e kryer, me qëllim që t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme: **a është i qëndrueshëm niveli i borxhit publik që kalon 60% të BPV-së në vitin 2020 dhe pritet të arrijë në 65% të BPV-së deri në vitin 2025? dhe nëse sistemi për menaxhimin me borxhin publik mundëson menaxhim efikas të borxhit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke siguruar mjete për financimin e buxhetit të shtetit me kosto sa më të ulët, në afat të mesëm dhe afatgjatë dhe me nivel të qëndrueshëm të rrezikut dhe lëshimi i garancive shtetërore në mënyrën që korrespondon me nivel të qëndrueshëm të rrezikut dhe mbajtjen e tregut efikas dhe likuid të letrave shtetërore me vlerë?**

Subjektet të cilat janë të përfshira me revizion janë Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore e RMV-së.

Nëpërmjet analizës së politikës fiskale dhe portofolit të borxhit, konstatuam se 75% e totalit të borxhit publik, përkatësisht 88% e borxhit të shtetit është me dedikim për financimin e deficitit buxhetor, ku parashikohen shpenzime më të larta se të ardhurat, ndërsa burimet për financimin janë përmes huamarrjes nga burime të brendshme dhe të huaja që kanë ndikim të madh në krijimin, çmimin, qëndrueshmërinë dhe menaxhimin me borxhin publik.




Mungesa e proceseve kryesore në menaxhimin me investimet publike ndikon në rritjen e çmimit të projekteve, ndërsa me ato edhe të menaxhimit efikas me borxhin publik.

Në kushtet e COVID-19, borxhi publik u rrit për 15% të BPV-së dhe është arritur limiti i borxhit publik prej 60% të BPV-së, që mund të shpie në pikëpyetje qëndrueshmërinë dhe maturinë e borxhit publik në të ardhmen. Mungesa e ligjit të veçantë / aktit nënligjor ose dokumentit strategjik për mbajtjen e financave publike në rrethana ekskluzive / gjendje krize / gjendje të jashtëzakonshme përbën rrezik në menaxhimin me borxhin publik.

# GJENDJA E BORXHIT SHTETËROR DHE PUBLIK NË % NGA BPV




Sistemi për menaxhimin me borxhin publik, me përjashtim të disa mangësive, mundëson menaxhim efikas me borxhin publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për shkak të mundësisë së dhënë për huamarrje për financimin e deficitit buxhetor për vitin aktual dhe dy vitet e ardhshme, kontribuon në miratimin e vendimeve për huamarrje kur kushtet e tregut janë më të volitshme, por ekziston rreziku i huamarrjes që nuk është miratuar nga Kuvendi i RMV-së. Në procesin e përgatitjes së buxhetit nuk është paraparë miratimi i planit të posaçëm i huamarrjes nga Kuvendi i RMV-së dhe procedura për lëshimin e eurobondit, procedura e negociatave të kushteve të huas dhe procedura e ndarjes së huave on-lending[6] të bartësve të borxhit publik nuk rregullohet plotësisht nëpërmjet dispozitave në rregullativën ligjore, aktet nënligjore ose procedurën e brendshme. Huamarrja me hua bilaterale për ndërtimin e autostradave varet nga kushtet në Kontratën e Ndërtimit e cila është miratuar në Kuvendin e RMV-së si ligj i veçantë, për këtë huamarrje është i nevojshëm riklasifikimi i garantuesit në borxhin shtetëror. Kapaciteti i pamjaftueshëm në Sektorin e Marrëdhënieve Financiare Ndërkombëtare dhe Menaxhimit me Borxhin Publik në Ministrinë e Financave dhe vendosja e tij institucionale ndikon në efikasitetin e menaxhimit me borxhin publik.

Revizioni i suksesit do të ketë efekt në përmirësimin e pjesës së kuadrit ligjor për menaxhimin me financat publike me miratimin e rregullave fiskale, miratimin e planit për huamarrje dhe menaxhimin më efikas me borxhin publik të NP-së për Rrugë Shtetërore. Përmirësimi i procesit buxhetor në procedurën e planifikimit dhe analizimit të detyrueshëm të qëndrueshmërisë së borxhit përpara miratimit ose rebalancit të buxhetit me projeksione të kujdesshme të deficitit të shtetit. Në pjesën e investimeve publike, ndërmarrja e veprimtarive për uljen e rrezikut të lartë nga zgjedhja dhe realizimi i projekteve. Në lidhje me procedurat e huamarrjes, është i nevojshëm ndryshimi i Ligjit për borxhin publik me qëllim të harmonizimit të tij me Propozim-ligjin për buxhete, parashikimi i akteve nënligjore për huamarrjen me letra shtetërore me vlerë në tregun ndërkombëtar, të rregullohet procedura për on lending huamarrje, hartimi i Metodologjisë për vlerësimin e projekteve përpara lidhjes së marrëveshjes për hua ose lëshimin e garancive shtetërore. Revizioni do të ketë efekt në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve për rritjen e burimeve për zbatimin e menaxhimit efikas me borxhin publik dhe uljen e rrezikut të lartë organizativ të identifikuar për shkak të statusit të punonjësve në sektorin e ministrisë.

## 5.2.3. HUAMARRJA E SUBJEKTEVE TË SEKTORIT PUBLIK, SHKALLA E PËRDORIMIT TË KREDIVE DHE HUAVE DHE SHPENZIMET E PAGUARA DHE TË KRIJUARA

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e suksesit me temën ***"Huamarrja e subjekteve të sektorit publik, shkalla e shfrytëzimit të kredive dhe huave dhe shpenzimet e paguara dhe të krijuara"***

Revizioni ka përfshi periudhën e marrëveshjeve të lidhura për hua të cilat janë në fazën e tërheqjes për periudhën 2010 - 2020, edhe pse disa fusha, çështje dhe ngjarje të caktuara janë përfshirë njëpasnjëshëm deri në ditën e njoftimit të revizionit të kryer.

Revizioni është kryer me qëllim që t'i përgjigjet pyetjes së mëposhtme:

***A realizohen në mënyrë efikase dhe ekonomike investimet publike të cilat financohen me mjetet e huave?***

Dëshmitë dhe vëllimi të siguruara përmes zbatimit të teknikave dhe metodologjisë nga ana e revizionit na mundësojnë të shprehim përfundimin e mëposhtëm:

Me zbatimin e revizionit të suksesit fituam bindje se financimi i investimeve publike me mjetet e huave të kreditorëve zyrtarë shkakton mundësinë e sigurimit të fondeve për investime të mëdha me kushte të volitshme, për të cilat ka grejs-periudhë dhe periudhë më të gjatë për servisimin e borxhit. Për subjektet e sektorit publik, përparësitë e financimit me huat e kreditorëve zyrtarë janë financimi i kombinuar i projekteve me mundësinë e granteve investuese nëpërmjet Instrumentit IPA dhe Instrumentit WBIF, veçanërisht për infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, si dhe përjashtime nga taksat veçanërisht të volitshme për NP për Rrugët Shtetërore.

Konstatuam se sistemi i menaxhimit me investimet publike është i fragmentuar me ligjet individuale për huamarrje dhe marrëveshjet për huat, mungon rregullativa e veçantë për realizimin e investimeve publike. Planifikimi strategjik i investimeve publike ka shumë dobësi, mungon metodologjia nacionale dhe kriteret për zgjedhjen e projekteve. Në kornizën ligjore ekzistuese nuk është disenjuar sistemi efikas për monitorimin dhe mbikëqyrjen e projekteve me procedura dhe institucione kompetente dhe nuk janë vendosur indikatorët për monitorimin e projekteve, për shkak që për një pjesë të projekteve nuk janë ndërmarrë masa korrigjuese me kohë për uljen e rreziqeve.

Janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e projektit që ndikojnë ndjeshëm në afatin e përfundimit të punimeve. Gjithashtu, veprimi i pakoordinuar i institucioneve dhe mungesa e menaxhimit aktiv me proceset ndikon në vlerën totale të punimeve dhe kostot më të larta sipas marrëveshjeve për huat. Për projektet e infrastrukturës hekurudhore ekziston pasiguria e madhe në lidhje me përdorimin e fondeve të granteve të marra për shkak të dinamikës së ngadalshme të realizimit të projekteve.

Gjendja e konstatuar me revizionin të udhëzon në konstatimin për dinamikën e ngadalshme të realizimit të projekteve strategjike të infrastrukturës, rritjes së kostove të projektit nëpërmjet rritjes së çmimeve të ndërtimit dhe kostove më të larta për huat, për shkak të së cilës realizimi i investimeve publike të cilat financohen me hua nuk është zbatuar në tërësi në mënyrë efikase dhe ekonomike.

Për shkak të zgjatjes së afateve për realizimin e projekteve, efektet e investimeve publike për realizimin e qëllimeve për të cilat realizohen investimet prolongohen për periudha të ardhshme.

Për një pjesë të projekteve që ishin lëndë të revizionit në grafikonin e paraqitur i japim informacionet themelore dhe gjendjet e konstatuara për të njëjtën dhe atë si vijon:

**PROEKTI:**

Ndërtimi i autostradës Kërçovë – Ohër

**2013** MARRËVESHJA E LIDHUR PËR NDËRTIM

**411.287.800€**

JANAR 2018

FINANCIM ME HUA

505.044.967€



**2018**

**ANEKS I LIDHUR NR. 1**

prolongimi i afatit deri më

**30.06.2021**

**ANEKS I LIDHUR NR. 2**

**205.928.220€**

të shfrytëzohen për variacione

**ANEKSI I LIDHUR NR. 3**

**186.786.870€**

rritja e vlerës për punë plotësuese

**2019**

VLERA E RE E MARRËVESHJES

**598.074.670€**

FINANCIME PLOTËSUESE ME HUA

179.694.572$



**2020**

**ANEKSI I LIDHUR NR. 4**

renditja e re e shpenzimeve të mjeteve

**ANEKSI I LIDHUR NR. 5**

prolongimi i afatit deri më

**31.12.2023**

**2022**

SHPENZIMET SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA

**38.634.018$**

rreziku për VAZHDIMIN e afatit

**PROJEKT:**
Ndërtimi i Qendrës Klinike Rajonale në Shtip



## 01

**MARRËVESHJA E LIDHUR PËR NDËRTIM**

Shkurt 2016
**1.790.884** mijë denarë pa TVSH

**29.028.403** euro pa TVSH

janë përfshirë punimet plotësuese dhe të paparashikuara

Mars 2018

## 02

**NDRYSHIMET E MARRËVESHJES PËR NDËRTIM**

3 ndryshimet e miratuara

**2.221.384** mijë denarë pa TVSH

## 03

**ANEKSET E MARRËVESHJES PËR NDËRTIM**

Aneksi nr. 1

vazhdimi i afatit
**31.12.2020**

Aneksi nr. 2

rritja e vlerës së marrëveshjes
**430.500 mijë denarë**

Aneksi nr. 3

vazhdimi i afatit
**30.06.2023**

## 04

**REALIZIMI I PROJEKTIT**

tërheqja e fundit e mjeteve nga huamarrja është e vitit 2017 **13.500.000 euro,**

Gjithsej **30%** nga punimet e planifikuara janë realizuar në shtator 2021,

Nëntor 2021 **banka ka hequr dorë** nga financimi i projektit, anulohen **13.437.458 euro** mjete të patërhequra;

## 05

**AKTIVITETET E ARDHSHME**

Tetor 2021 është dorëzuar ndryshimi nr. 4 te Qeveria e RMV-së **464.527** mijë denarë,

Shpenzimet e reviduara të projektit do të **rriten** për **49,97%**



Projektet e NP HRMV infrastrukturës kanë filluar në periudhën 2012-2014, të njëjtit janë në ngecje, nuk kanë përfunduar, ndërsa prej 2018-2019 shkalla e realizimit në përqindje është vetëm 1% në nivel mujorë dhe në 2019-2020.

Marrëveshjet për Koridorin X dhe VIII janë ndërprerë. Në periudhën e kryerjes së revizionit në rrjedhë ishte vlerësimi për zgjedhjen e kontraktuesve të rinjë për Koridorin X dhe VIII.

## PROJEKT:

Rehabilitimi i pjesës lindore t**ë vijës hekurudhore** të Korridorit VIII – **segmenti i parë**

**FAZA 1**

Marrëveshja e lidhur për realizimin e çështjeve të ndërtimit në **dhjetor 2013**

afati i përfundimit
**14.09.2016**

**39.753.619€**

**Aneksi nr. 1**

Vazhdohet afati deri më
**20.02.2020**
janë miratuar kërkesat e dëmit

**4.134.145€**

**Realizimi i marrëveshjes**

**27.730.000€**

NDËRPRERJA E MARRËVESHJES
**QERSHOR 2020**

Është shpallur tenderi i ri për kontraktues në korrik 2021,

### RREZIKU NGA VAZHDIMI I AFATIT

Vlera e huamarrjes: **46.400.000€**

Mjetet e tërhequra: **31.900.955€**

**SHPENZIMET SIPAS MARRËVESHJES PËR HUAMARRJE**

**2.766.377€**
- provizioni i njëhershëm
- kamatë për mjetet e tërhequra
- kamatë për mjetet e patërhequra



## FAZA 2

# NDËRTIMI I RI DHE RIKONSTUIMI I SEGMENTIT EKZISTUES **BELLAKOVCË – KRIVA PALLANKË** KORRIDORI VIII

**2014**

marrëveshja e lidhur për huamarrje me BERZH

**145.000.000€**

## PROVIZIONE TË PAGUARA 6.385.202€

provizioni i njëhershëm **1.450.000€**

provizioni për mjetet e patërhequra **4.929.000€**

kamatë për mjetet e tërhequra **6.202€**

---

**2016**

procedura e zbatuar **pa sukses** për **zgjedhjen e kontraktuesit**, nuk është marrë **"no objection"** nga BERZH

---

**2018**

është ndarë **grant** nga instrumenti **WBIF**

**68.558.824€**

---

**2020**

procedura **e anuluar** për zgjedhjen e kontraktuesit

### Arsyeja

ngecja e fazës 1 – ndërprerja e marrëveshjes me kontraktuesin

---

**2021**

**Kushtet e plotësuara për efektivitet të huamarrjes**

- marrëveshja e nënshkruar me konsultantin për mbështetjen e EIP
- marrëveshja e nënshkruar për mbikëqyrje

### EFEKTET NGA PROJEKTI,

- marrëveshja e nënshkruar për huamarrje, **shpenzimet e paguara** me marrëveshjen për huamarrje
- **nuk është zgjedhur kontraktuesi**, në fazën e zgjedhjes
- **faza 1 është në ngecje**, kushtet për fillimin e ndërtimit të fazës 2
- projekti duhet të jetë operativ deri vitin 2025
- **rreziku nga humbja e mjeteve grant**



Për projektet të përfshira me këtë revizion janë krijuar shpenzime në vlerë prej 58 milion euro që i referohen provizionit të njëhershëm, kamatë për mjetet e tërhequr dhe provezion për mjetet e patërhequr. Në ligjet e vetme për huamarrje dhe ligjet për garancion për një pjesë të projekteve janë pararparë përjashtime nga tatitmet që e ulin çmimin e vlerës së investimeve.

| 11 projekte të reviduara | HUAMARRJE | MJETE TË TËRHEQURA | SHPENZIME |
|---|---|---|---|
| Ndërtimi i segmentit të autostradës Kërçovë-Ohër | 505.044.966$ | 382.598.046 | 38.634.019$ |
| Programi për rrugët nacionale | 181.000.000€ | 90.774.210€ | 7.091.325€ |
| Kërçovë Ohër, financime plotësuese | 179.694.573$ | / | / |
| Ndërtimi i ri dhe rikonstuimi i segmentit ekzistues Bellakovcë – Kriva Pallankë | 145.000.000€ | 1.450.000€ | 6.384.940€ |
| Zhvillimi dhe mbindërtimi Rankovcë – Kriva Pallankë | 73.000.000€ | 32.347.299€ | 1.655.085€ |
| Ndërtimi i rrugës ekspres Shtip - Radovish | 64.000.000€ | 64.000.000€ | 2.890.219€ |
| Furnizimi me ujë dhe tharja e ujërave të zeza në komunat e RMV-së | 50.000.000€ | 40.140.000€ | 3.038.865€ |
| Rehabilitimi i segmentit të parë të vijës hekurudhore Kumanovë - Bellakovcë | 46.400.000€ | 31.900.955€ | 2.766.377€ |
| Ndërtimi dhe modernizimi i Qendrës Klinike Rajonale – Shtip | 26.937.458€ | 13.500.000€ | 320.098€ |
| Remonti i vijës hekurudhore të Korridorit 10 | 17.600.000€ | 16.318.013€ | 1.308.761€ |
| Segmenti rrugor Kriva Pallankë - Deve Bair | 10.000.000€ | 5.100.000€ | 255.129€ |

# GJITHËSEJ SHPENZIME: 57.998.830€

Për tejkalimin egjendjës së lartëpërmendur, deri te institucionet kompetente dhamë rekomandime të cilat bazohen te rezultatet nga revizionet e kryera dhe janë në funksion të përmirësimit dhe avancimit të ekonomisë dhe efikasitetit të procesit gjithëpërfshirës të menaxhimit me investimet publike.

## 5.2.4. EFEKTIVITETI I MASAVE TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR BARAZINË GJINORE DHE NISMAT BUXHETORE GJINORE PËRKATËSE

Qëllimi i vendosjes së konceptit të barazisë gjinore të grave dhe burrave në të gjitha institucionet është të zvogëlohet hendeku midis grave dhe burrave në të gjitha pjesët e shoqërisë, i cili duhet të mbështetet në praktikat më të mira nacionale dhe ndërkombëtare, sepse barazia gjinore është një nga aspektet kryesore për prosperitetin e të gjithë shoqërisë dhe detyrim për shtetin që buron nga Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2020 - 2030.

Në drejtim të sigurimit të informacioneve dhe të dhënave të nevojshme se nëse veprimet të cilat ndërmerren nga institucionet kompetente në nivel qendror sigurojnë kushte për avancimin e barazisë gjinore, ndërsa në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2021, kemi kryer revizionin e suksesit me temën "Efektiviteti i masave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për barazinë gjinore dhe nismat buxhetore gjinore përkatëse", për periudhën 2018-2020, ndërsa janë dhënë kushtet dhe ngjarjet dhe në mënyrë të njëpasnjëshme deri në ditën e raportimit nga revizioni i kryer.

Revizioni i suksesit është kryer me qëllim të vlerësimit të gjendjes me barazinë gjinore në vend dhe institucionet në RMV dhe për të kontribuar në rritjen e efektivitetit të procesit të vendosjes së barazisë gjinore, nëpërmjet përcaktimit të disa dobësive/zbrazëtirave në rregullativën ligjore dhe nënligjore, kompetencat, financimin, ekipimin e kuadrit, komunikimin dhe bashkëpunimin e institucioneve përgjegjëse për vendosjen e barazisë gjinore në RMV, monitorimin e nivelit të realizimit të qëllimeve dhe masave dhe veprimtarive të cilat i ndërmarrin institucionet kompetente për përmirësimin e gjendjes në fushën e lëndës së revizionit..

### GJENDJA E POPULLSISË NË RMV SIPAS **GJINISË**[1]

në vitin **2021**




7 Regjistrimi i popullsisë, amvisrisë dhe banesave në RMV në vitin 2021 ka 1.836.713 banorë

Me revizionin e suksesit u përfshin: Qeveria e RMV-së - Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së; Kuvendi i RMV-së; Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Financave; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Ekonomisë; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe Agjencia për Rini dhe Sport, ndërsa për gjendjen dhe masat e ndërmarra për përparimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në partitë politike, janë dorëzuar pyetësorë për gjashtë parti politike.

Zbatimi i aktiviteteve të revizionit dhe sigurimi i dëshmive të revizionit na mundësojnë të shprehim përfundimin e mëposhtëm:

Masat dhe veprimtaritë e ndërmarra nga institucionet kompetente nuk janë të mjaftueshme për të siguruar vendosjen efektive të konceptit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në proceset e krijimit dhe zbatimit të politikave, monitorimi i arritjes së qëllimeve të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit të krijimit të politikave: identifikimi dhe vlerësimi i problemit, buxhetimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi dhe arritja e qëllimeve të Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2020 - 2030.

Institucionet kompetente në RMV në nivel nacional nuk i kanë zbatuar plotësisht masat dhe veprimtaritë e planifikuara dhe të përcaktuara me miratimin e Strategjisë aktuale për barazinë gjinore, Planet Nacionale për aksion dhe Planet Operative dhe për shkak të mungesës së indikatorëve matës, nuk mund të jetë i plotë monitorimi i përparimit të rezultateve të arritura dhe përmbushjes së qëllimeve specifike.

Nga ana e Kuvendit të RMV-së nuk është miratuar Strategjia Nacionale për Barazinë Gjinore 2021 - 2026.

Konstatuam koordinimin dhe komunikimet e pamjaftueshëm mes institucioneve kompetente, mungesën e burimeve financiare për implementimin dhe zbatimin e procesit të barazisë gjinore dhe përgjegjësinë buxhetore gjinore.

Në nivel institucional është e nevojshme të ndërmerren veprime për ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e barazisë gjinore të personave udhëheqës në institucionet, përmirësimin e ekipimit të kuadrit për zbatimin e procesit të barazisë gjinore, si dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve në institucionet për barazinë gjinore.

Nuk janë të përcaktuar saktësisht veprimet, mënyra se si duhet të zbatohen dhe nuk janë krijuar kushtet e plota për zbatimin e procesit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha fazat që përfshin vlerësimin e problemit, buxhetimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin nga ana e institucioneve kompetente në shtet.

Në Ligjin për buxhete nuk është rregulluar koncepti i përgjegjësisë buxhetore gjinore dhe ligjet e tjera në fushën e barazisë gjinore nuk janë të harmonizuara, që kontribuon në përmbushjen e parakohshme dhe të plotë të qëllimeve gjinore.

Në programet e parapara me deklaratën buxhetore gjinore nuk përcaktojnë indikator matës përkatës dhe nuk është kryer sublimimi i rezultateve të arritura dhe progresit me qëllim të miratimit të vendimeve për rrjedhjen e mëtejshme të programeve. Kemi vërejtur mungesë te sistematizimi i vendeve të punës koordinator për barazinë gjinore në ministritë dhe organet më të mëdha të administratës shtetërore, me të cilat nuk është siguruar vazhdimësia në zbatimin e procesit të barazisë gjinore dhe përgjegjësinë buxhetore gjinore.

Ekziston nevoja për të forcuar rolin e Komisionit për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave, kryerjen e vlerësimit të ndikimit të rregullativës mbi gratë dhe burrat dhe për të zbatuar mbikëqyrjen post-ligjvënëse.

## Struktura gjinore e nëpunësve administrativë udhëheqës nëpër institucionet




## Struktura **gjinore e punonjësve nëpunës administrativë nëpër institucionet**




E theksuara ka ndikim në efektivitetin e zbatimit të procesit të barazisë gjinore dhe në dinamikën e ngadalshme në zbatimin e përgjegjësisë buxhetore gjinore nga organet e administratës shtetërore në nivel qendror, i cili ka për qëllim të sigurojë se mjetet e alokuara dhe të parapara në mënyrë të barabartë t'i marrin parasysh dhe t'u përgjigjen nevojave, interesave, prioriteteve të grave dhe burrave.

Me realizimin e veprimeve të nevojshme në fushën që është lëndë e revizionit do të kontribuojë në përmirësimin e barazisë gjinore në RMV, ndërsa me këto edhe i gjithë procesi i barazisë gjinore në RMV.

Veprimet e revizionit të suksesit kanë për qëllim të ndihmojnë në të ardhmen institucionet kompetente që të fokusohen në përmbushjen e postulateve të vendosura për përmirësimin e gjendjes me barazinë gjinore në RMV.

## 5.3. KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut është organ përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës të Republikës, i cili përbëhet nga 120 deputetë të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë.

Kemi kryer revizionin e raporteve financiare të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2020.

Në pajtim me Ligjin për shfrytëzimin dhe disponimin me sende në pronësi shtetërore dhe sende në pronësi komunale, në pajtim me të cilin Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të lejojë përkohësisht ose përgjithmonë shfrytëzimin e sendeve të patundshme në pronësi shtetërore, me ose pa kompensim për organet shtetërore, personave juridikë të themeluar nga shteti, komunave, komunave në Qytetin e Shkupit, Qytetit të Shkupit, shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve.

Konstatuam nevojën e intensifikimit të veprimeve dhe bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për sigurimin e fletëpronësisë me të drejtën e përcaktuar të pronësisë ose shfrytëzimin e tokës dhe objektit në të cilin është vendosur Kuvendi dhe i kryen kompetencat e tij.

Në raportin e revizionit kemi njoftuar se është e nevojshme që Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes lokale të sigurojë kushte të përshtatshme për vendosjen e kontakteve të deputetit me qytetarët në njësinë e tij zgjedhore, në përputhje me numrin e planifikuar të zyrave për kontakt me qytetarët.

Të drejtat dhe kompetencat e deputetëve janë të përcaktuara në Ligjin për deputetë dhe në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Deputeti është i obliguar të marrë pjesë në seancat e Kuvendit dhe të trupit punues në të cilin është anëtar, si dhe të marrë pjesë në punën dhe vendimmarrjen e tyre, ndërsa në rast të pengesës është i obliguar që me kohë ta njoftojë Kryetarin e Kuvendit, gjegjësisht kryetarin e trupit punues dhe t'i theksojë arsyet e mungesës. Konstatuam se në Rregulloren e Punës është rregulluar mënyra e evidentimit të pranisë së deputetëve, mënyra e informimit për mungesat, si dhe veprimet dhe masat që do të ndërmerren në rast të mungesës për të cilën Kryetari i Kuvendit nuk është njoftuar, por nuk janë përcaktuar rastet në të cilat mungesa konsiderohet e justifikuar ose e pajustifikuar.

Prania e deputetëve të përbërjes së parë dhe të dytë parlamentare në seancat e Kuvendit të mbajtura në vitin 2020, në pajtim me të dhënat e dorëzuara për pjesëmarrje, është paraqitur në grafikonin e mëposhtëme:

### Prania e deputetëve nga përbërja e parë dhe e dytë parlamentare, në seancat e Kuvendit të mbajtura në vitin 2020



# 5.4. MENAXHIMI ME PRONËN

## 5.4.1. REGJISTRIMI I MJETEVE, KËRKESAVE DHE DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PËR PUNË TË PËRGJITHSHME DHE TË PËRBASHKËTA TË QEVERISË SË RMV-së

Është kryer revizioni i pajtueshmërisë me temën "Regjistrimi i mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve të Shërbimit për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të RMV-së".

Me revizionin e kryer janë kostatuar më shumë gjendje ndër të cilët edhe:

- regjistrimi i mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve në SHPPP është i paplotë dhe në segmente të caktuara nuk veprohet në përputhje me rregullativën ligjore;
- disa nga listat e regjistrimit janë nënshkruar të pakompletuara;
- për shkak të mosvendosjes së evidentimit të brendshëm të sendeve të paluajtshme dhe mosvendosja e njësisë organizative që do të ngarkohet me regjistrimin e sendeve të paluajtshme të cilat shfrytëzohen nga SHPPP, ato nuk mund të regjistrohen në evidencat e kontabilitetit;
- nuk është përcaktuar gjendja faktike me regjistrimin dhe harmonizimi i të dhënave në librat afariste / evidencën e kontabilitetit me gjendjen faktike të kërkesave, detyrimeve dhe evidentimit jashtë bilancit;
- nuk janë përcaktuar arsyet për dallimet e konstatuara me regjistrimin, dhe
- raportet e komisioneve të regjistrimit në mënyrë joreale e paraqesin gjendjen me mjetet dhe detyrimet në SHPPP edhe pse raporti nga regjistrimi i KQR-së është miratuar nga personi përgjegjës.

## 5.4.2. QENDRA TREGTARE E QYTETIT SH.A. SHKUP

Objekti i Qendrës Tregtare të Qytetit Shkup gjendet në zonën më atraktive qendrore të qytetit dhe është kompleks i rëndësishëm komercial dhe administrativ, veçanërisht me kushte të volitshme të lokacionit. Filloi të punojë në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar, si rezultat i shtrirjes së re urbane të Qytetit të Shkupit pas tërmetit dhe përpjekjes për të integruar vlerat ekonomike dhe sociale me vlerat arkitektonike dhe estetike.

Qendra Tregtare e Qytetit SHA - Shkup (QTQ SHA Shkup), është transformuar në shoqëri aksionare në vitin 1996, e themeluar nga Ndërmarrja Publike për Ekonimizimin me Hapësirën Banesore dhe Afariste të Republikës së Maqedonisë.

Gjendja dhe lëvizja e kapitalit aksionar në vitet 2019 dhe 2020 është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

| Lëvizja e kapitalit aksionar në vitet 2019/2020 në QTQ SHA Shkup | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Aksionarët | Numri i aksioneve | | Numri i aksionerëve | Të shitur | Të blerë | të marrë pjesë % |
| | 2020 | 2019 | | | 2020 | 2020 |
| SHA për ekonimizim me hapësir afariste në pronësi të shtetit | 1.801.589 | 1.801.589 | 1 | | | 97,58 |
| QTQ SHA Shkup | 19.470 | 19.470 | 1 | | | 1,05 |
| Të punësuar në QTQ SHA Shkup | 10.558 | 10.764 | 79 | 206 | | 0,57 |
| Persona fizik | 9.086 | 8.880 | 51 | | 206 | 0,49 |
| Persona juridik | 5.544 | 5.544 | 43 | | | 0,3 |
| QTQ SHA Shkup - aksioner i paidentifikuar | 78 | 78 | 1 | | | 0 |
| **Gjithësej** | **1.846.325** | **1.846.325** | **176** | **0** | **206** | **100** |

Objekti i QTQ Shkup me gjendje më 31.12.2020 është me sipërfaqe të përgjithshme prej 119.553,78 m2 dhe është në pronësi të përzier. QTQ SHA Shkup zotëron 70,20% të sipërfaqes së përgjithshme, ndërsa 29,80% është hapësirë e shitur afariste.

Kompleksi ka 588 njësi afariste në të cilat kryhet veprimtari, me sipërfaqe totale të shfrytëzueshme prej 46,418.95 m2, nga të cilat:

- 59 njësi afariste me sipërfaqe prej 5,402.38 m2, janë dhënë me qira,
- 56 njësi afariste me sipërfaqe prej 5,394.04 m2 janë hapësira të lira afariste dhe
- 473 njësi afariste me sipërfaqe totale prej 35.622,53 $m^2$ janë shitur.

## Hapësira në metra katrorë e kompleksit të SHA QTQ me gjendjen më 31.12.2020




Pjesa më e madhe e hapësirës së mbetur në pronësi të QTQ SHA - Shkup prej 55.110 m2 ose 66% i takon hapësirës së komunikimit (kejit, tarracave dhe pasarelës) për të cilën bëhen shpenzime për mirëmbajtjen aktuale dhe investuese dhe higjienën, 26,877 m2 ose 32% i takon hapësirës afariste nga bodrumi deri në katin e tretë dhe 1,944 m2 ose 2% i takon hapësirës afariste në kullat e banimit (1 deri në 5). Pjesa më e madhe e hapësirës atraktive afariste që mund të jepet me qira dhe të fitohen të ardhura është shitur.

Projektet kapitale për të cilat kanë filluar veprimtaritë e projektit në vitin 2020 janë: "**Përshtatja e fenerëve në çatinë e fasadës së pestë**", "**Riparimi i mbulesës së çatisë në fasadën e pestë"** dhe në bashkëpunim me SHA ESM **"Ndërtimi i fotovoltaikëve në çatinë e Qendrës Tregtare të Qytetit."**

SHA QTQ Shkup çdo muaj pronarëve dhe qiramarrësve të hapësirave afariste u faturon shpenzimet komunale (energjinë elektrike, ngrohjen dhe ftohjen, ujin e konsumuar dhe mbeturinat), ndërsa vetëm pronarëve të hapësirave afariste edhe për mirëmbajtjen aktuale dhe investuese të hapësirës së përbashkët dhe funksionet që i shërbejnë godinës së Qendrës Tregtare të Qytetit.

Këto të ardhura në vitin 2020 janë realizuar në shumë prej 151.032 mijë denarë, ku pjesa më e madhe ose 50% u referohen të ardhurave të realizuara nga faturimi i shpenzimeve për mirëmbajtjen aktuale dhe investuese.

## Të ardhurat e realizuara nga rifaturimi i shërbimeve komunale në vitin 2020



Me revizionin e kryer i kemi konstatuar gjetjet si vijojnë:

- nuk janë miratuar dokumentet për planifikim strategjik afatgjatë me qëllim të përcaktimit të qëllimeve strategjike afatgjate të zhvillimit;
- nuk është vendosur mekanizëm kontrolli gjatë lëshimit të faturave të daljes që ndikon në plotësinë dhe saktësinë e tyre;
- revizioni i brendshëm i cili duhet të kontribuojë në përmirësimin e funksionimit dhe rritjen e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm të SHA QTQ Shkup nuk është vendosur;
- mënyra e vendosur e përgatitjes së faturave për mirëmbajtjen aktuale dhe investuese nuk është plotësisht në përputhje me vendimin e miratuar për mënyrën e faturimit, që ndikon në saktësinë dhe transparencën e realizimit të të ardhurave në bazë të tyre;
- faturimi i shpenzimeve për: mirëmbajtjen aktuale, energjinë elektrike dhe ngrohjen nuk është plotësisht në përputhje me vendimin dhe metodologjinë e miratuar dhe të njëjtit nuk janë ndryshuar për një kohë të gjatë, edhe pse rregullativa ligjore në këtë pjesë është ndryshuar;
- konstatuam mospërputhje në mënyrën e zbatimit të regjistrimit të mjeteve dhe burimeve të mjeteve;
- janë paraqitur në mënyrë joreale mallrat dhe materialet për shkak të vjetërsimit të tyre teknologjik;
- nuk është kryer regjistrimi i së drejtës së pronësisë së tokës dhe një pjese të hapësirës afariste të objektit të Qendrës Tregtare të Qytetit, që mund të ndikojë në sigurinë juridike të pronësisë;
- vlera e objektit afarist nuk është pasqyruar realisht dhe objektivisht në raportet financiare, për pjesën që i takon SHA QTQ Shkup;
- me themelimin e SHA QTQ Shkup u ndërmorën veprime për privatizimin e saj dhe janë bërë shitje të pjesës së rëndësishme nga hapësirat atraktive afariste ose nëpërmjet shitjes së aksioneve ose me ankand, deri në shkurt të vitit 2007 kur këshilli i atëhershëm i drejtorëve miratuan vendim për ndalimin e shitjes së hapësirave afariste. Shitja e hapësirave afariste, veçanërisht me aksione, shkaktoi çekuilibër në mes të numrit të aksioneve në Depozitën Qendrore të Letrave me Vlerë dhe pronësinë e hapësirës afariste, duke pasur parasysh se 29.80% e hapësirës afariste të objektit të Qendrës Tregtare të Qytetit është shitur;
- mospërputhje ndërmjet vlerës së kryegjësë themelore të regjistruar në librat tregtare dhe investimit themelues të regjistruar në Regjistrin Qendror të RMV-së dhe në Statutin e shoqërisë dhe
- mospërputhje në zbatimin e prokurimeve publike.

## 5.5. EFEKTET NGA PANDEMIA COVID-19

Për t'i zbutur pasojat e krizës socio-ekonomike të shkaktuar nga virusi Covid-19, Qeveria e RMV-së në vitet 2020 dhe 2021 miratoi gjashtë pako masash ekonomike, me të cilat u përfshin dhe mbështetën subjektet afariste nga sektori privat dhe publik, si dhe qytetarët, për mbrojtjen e likuiditetit të ekonomisë, mbrojtjen e vendeve të punës, përkujdesjen për kategoritë e pambrojtura të popullsisë, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së ekonomisë vendase dhe krijimin e mjedisit për tejkalim më të lehtë të pasojave ekonomike të virusit COVID-19.

Në pajtim me Programin Vjetor të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2021 janë kryer tre revizione të suksesit, me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të masave ekonomike të miratuara nga Qeveria e RMV-së për përballimin me krizën e COVID-19, nëpërmjet përcaktimit të gjendjes dhe problemeve me të cilat ballafaqohen institucionet e përfshira, si dhe të japim rekomandime për krijimin e sistemit efikas të planifikimit, realizimit, raportimit dhe monitorimit në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme ose krizës, për shkak të përballimit pa pengesë me pasojat mbi ekonominë në nivel shtetëror.

I kemi përfshirë mjetet e planifikuara për ndihmë për përballimin me pasojat nga pandemia për vitet 2020 dhe 2021 të cilat shkaktojnë shpenzime, gjegjësisht kanë **implikime direkte fiskale në Buxhetin e RMV-së**, në shumë të përgjithshme prej 35,409,940 mijë denarë, gjegjësisht rreth **576 milionë euro**, nga të cilat për masa për mbështetje financiare për subvencionim të kontributeve dhe pagesën e pagave janë kthyer më pak para në Buxhetin e RMV-së në shumë prej 988.307 mijë denarë, si dhe 448.698 mijë denarë mbështetje financiare të njëhershme të personave juridik dhe fizik të veprimtarisë së veçantë pa të dhëna për kthim, të cilët shkaktuan zvogëlimin e të ardhurave buxhetore në shumë të përgjithshme prej 1.437.005 mijë denarë ose rreth 23 milionë euro, si dhe masat ekonomike që kanë ndikim ekonomik, por nuk kanë implikime fiskale, të cilat përfundimisht më 30.10.2021 janë planifikuar në shumë të përgjithshme prej 3.473.250 mijë denarë, ose **56,5 milionë euro.**

## 5.5.1. MASAT EKONOMIKE TË QEVERISË SË RMV-së PËR BALLAFAQIMIN ME KRIZËN E SHKAKTUAR NGA VIRUSI KOVID-19

Është kryer revizioni i suksesit me temën "Masat ekonomike të Qeverisë së RMV-së për ballafaqimin me krizën e shkaktuar nga virusi Kovid-19" për t'iu përgjigjur pyetjes "*A është siguruar sistemi efikas i planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit për masat e miratuara ekonomike nga shteti për ballafaqimin me pasojat nga Kovid-19*".

Me revizionin e suksesit kemi përfshirë periudhën nga 18 mars 2020 deri në tetor 2021, ndërsa disa çështje dhe ngjarje të caktuara deri në ditën e raportimit nga revizioni i kryer.

Duke respektuar veprimet e ndërmarra të Qeverisë së RMV-së për reagim të shpejtë dhe amortizimin e pasojave të krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga virusi Kovid-19, në lidhje me sigurimin e **kushteve normative për ballafaqimin me pasojat nga pandemia të shkaktuar nga Kovid-19** konstatuam se:

- Kuvendi i RMV-së nuk i ka konfirmuar pesë Vendimet e Presidentit të vendit për përcaktimin e ekzistimit të gjendjes së jashtëzakonshme në të gjithë teritorin e vendit për mbrojtjen dhe ballafaqimin me pasojat e përhapjes së virusit korona Kovid-19, ndërsa Gjykata Kushtetuese e RMV-së ka miratuar Aktvendime për mosfillimin ose refuzimin e iniciativave për fillimin e procedurës për vlerësimin kushtetutshmërisë të disa vendimeve dhe
- me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe deri në përfundimin e saj, Qeveria e RMV-së ka miratuar 250 Rregullore me fuqinë e ligjit, nga te cilat 43% janë për ndryshimin dhe plotësimin e Rregulloreve ekzistuese, si rezultat i dinamikës së pasigurt në zhvillimin e pandemisë, por edhe tregues se miratimi i Rregulloreve është bërë pa planifikim, analizë dhe vlerësim gjithëpërfshirës.

### Llojet e rregulloreve me fuqi ligjore

- Rregulloret burimore
- Rregulloret me fuqinë e ligjit për zbatimin e ligjit konkret
- Rregulloret për ndryshimin dhe plotësimin e rreguloreve ekzistuese me fuqinë e ligjit
- Rregulloret me fuqinë e ligjit për shfuqizimin e Rregullores së mëparshme të miratuar me fuqinë e ligjit



**Gjatë planifikimit të masave ekonomike për ballafaqimin me krizën dhe pasojat nga Kovid-19**, konstatuam nevojën që krijimi i politikave dhe miratimi i masave të Qeverisë për ballafaqimin me krizën nga virusi Kovid-19 të bëhet në bazë të planifikimit strategjik me afat të mesëm dhe të gjatë në nivel shtetëror, me definimin e prioriteteve strategjike dhe qëllimeve prioritare, veprimeve për arritjen e tyre dhe rezultateve të pritura, që do të sigurojnë monitorim të rezultateve dhe suksesit nga zbatimi i masave ekonomike dhe efekteve në ekonominë e Maqedonisë, respektivisht:

- gjatë planifikimit dhe hartimit të gjashtë pakove të masave ekonomike, nuk janë bërë vlerësime dhe analiza për impaktin dhe ndikimin e mundshëm që masat do të kishin në ekonominë në tërësi;
- planifikimi i masave ekonomike që kanë implikime të drejtpërdrejta fiskale në Buxhetin e RMV-së, nuk pasqyrohet me ndryshimin dhe plotësimin e planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë në nivel shtetëror;
- nuk është miratuar dokumenti strategjik afatgjatë për ballafaqimin me krizën shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia, me qëllime, politika, veprime dhe masa të përcaktuara, me qëllim të sigurimit të gatishmërisë më të mirë dhe aftësisë më të madhe për të dhënë përgjigje më efektive ndaj krizës në të ardhmën dhe
- ekziston mungesa e qëllimeve, veprimeve dhe indikatorëve përcaktues për matjen e efekteve të masave të ndërmarra për të krijuar "rrugë drejt rimëkëmbjes ekonomike" nga kriza Kovid-19, e bëri më të vështirë monitorimin e suksesit të zbatimit të tyre si dhe mosekuostencën e udhëzimeve të ardhshme për të vepruar.

Pjesa më e madhe nga mjetet e realizuara janë për mbështetjen financiare për pagesën e pagave, pastaj mjetet e ndara për mbështetje në zhvillimin dhe rimëkëmbjen e ekonomisë maqedonase, mjetet për sektorin shëndetësor dhe social, të paraqitur veçmas në grafikën e mëposhtme:

## Masat ekonomike të Qeverisë së RMV-së për vitet 2020 dhe 2021 të kategorizuar sipas raporteve (%)

- Mbështetje financiare për pagesën e pagave
- Mbështetje me para për kategori të ndryshëm të qytetarëve dhe profesioneve
- Mbështetje të drejtpërdrejt ekonomisë së maqedonisë
- Ndihmë financiar në bujqësi
- Masa për mbështetje të sektorit social dhe shëndetësor
- Mbështetje financiare të NP, SHA në pronësi të shtetit dhe NJVL



Në lidhje me realizimin, monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të masave ekonomike për ballafaqimin me pandeminë, konstatuam gjendjen që çuan në uljen e transparencës dhe llogaridhënies dhe e vështirësuan kryerjen e vlerësimit të efikasitetit të realizimit të mjeteve financiare dhe ndikimin e masave në ekonominë shtetërore, si dhe gjendje që i referohen vendosjes të sistemit jo të plotë të raportimit dhe monitorimit të realizimit të mjeteve të alokuara, gjegjësisht gjendje që vështirësojnë monitorimin e efekteve të masave ekonomike dhe kontributin e tyre në stabilizimin dhe rikuperimin efikas të ekonomisë së brendshme dhe atë:

- ekziston mungesa e sistemit integrues të regjistrimit të masave ekonomike me të dhëna për mjetet e planifikuara, dedikimin e tyre, numrin e subjekteve afariste ose qytetarëve për të cilët është dedikur masa, burimin e mjeteve, numrin e kërkesave të paraqitura dhe të miratuara, disponueshmërinë e masës, shkallën e shfrytëzimit dhe të pashfrytëzimit të tyre, arsyet për mosrealizimin e tyre;
- vëllimi i mjeteve të planifikuara për linjat e kredisë pa interes, zgjedhja e veprimtarive të prekura nga pandemia, si dhe kriteret e pabarabarta për miratim në të gjitha linjat e kredisë së krijuara nga organet kompetente shtetërore, nuk krijojnë mundësi të barabarta për "rikuperim" nga pasojat e Kovid-19 te subjektet afariste në shtet;
- është bërë pagimi i mjeteve për mbështetje financiare të subjekteve të sektorit publik në shumë prej 918.328 mijë denarë, gjegjësisht 15 milionë euro pa kritere të përcaktuara në bazë të të cilave është bërë zgjedhja e institucioneve dhe komunave të cilave u është dhënë mbështetja financiare, për shumën e mjeteve të miratuara, nuk janë përcaktuar dedikimet për të cilat mjetet duhet të përdoren dhe nuk janë kryer kontrolle;
- te masa ekonomike për tregjet e reja, konkurrencën dhe likuiditetin, kemi përcaktuar se deri më 31 tetor 2021, 69% nga subjektet afariste të cilave u është dhënë mbështetja financiare nuk kanë paraqitur raport për rrjedhën e realizimit të projektit (plani investitues), ndërsa nga Ministria e Ekonomisë dhe Sekretariati i Përgjithshëm nuk janë kryer kontrolle dhe pavarësisht veprimeve të filluara për vendosjen e perspektivës gjinore, vendosjen e mundësive të barabarta midis grave dhe burrave të njejtat kontribuojnë në masë të vogël në uljen e pabarazisë gjinore në sferën ekonomike në periudhën e krizës Kovid-19.

Për institucionet kompetente kemi dhënë rekomandime të cilat bazohen në rezultatet e revizioneve të kryera dhe janë në funksion të përmirësimit të realizimit të kompetencave të institucioneve në vend, me qëllim të sigurimit të vlerës së shtuar në drejtim të forcimit dhe krijimit të sistemit efikas të planifikimit, realizimit, raportimit dhe monitorimit, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së krizës për t'u ballafaquar pa pengesë me pasojat e tyre në ekonominë në nivel shtetëror.

Pas rekomandimeve nga Draft-Raporti i revizorit të autorizuar shtetëror, nga Ministria e Ekonomisë dhe Qeveria e RMV-së, janë zbatuar kontrolle, gjatë së cilës disa nga subjektet afariste që nuk i kanë përmbushur detyrimet kontraktuese, i kanë kthyer mjetet e marra nga mbështetja financiare në Buxhetin e RMV-së në shumë prej 24.825 mijë denarë, gjegjësisht 400 mijë euro. Për subjektet e tjera afariste janë iniciuar veprime për aktivizimin e kambialit dhe deklaratës së kambialit në formë të aktit noterial me klauzolë ekzekutive, në mënyrë që në Buxhetin e RMV-së të rimbursohen mjetet në shumën totale prej 238.684 mijë denarë, gjegjësisht rreth 3,8 milionë euro.

## 5.5.2. MASAT DHE POLITIKAT E NDËRMARRA PËR MBËSHTETJEN E PUNËSIMIT DHE PROFESIONEVE TË PREKURA NGA KRIZA SHËNDETËSORE DHE EKONOMIKE TË SHKAKTUAR NGA KOVID-19

Revizioni i suksesit me temën "Masat dhe politikat e ndërmarra për mbështetjen e punësimit dhe profesioneve të prekura nga kriza shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga Kovid-19" është kryer në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2021. Qëllimi i revizionit është t'i përgjigjet pyetjes: **"A janë krijuar, zbatuar, kontrolluar, monitoruar në mënyrë efektive masat për mbështetjen financiare të punësimit dhe profesioneve të prekura nga kriza shëndetësore dhe ekonomike nga KOVID-19 dhe a është siguruar raportimi përkatës për efektet e masave të ndërmarra?"** në drejtim të rritjes së efektivitetit të masave dhe politikave për t'u ballafaquar me sukses me pandeminë Kovid-19 dhe për të mbështetur vendet e punës.

Pandemia e shkaktuar nga virusi korona Kovid-19 që u shfaq në dhjetor 2019 në Kinë dhe preku territorin e RMV-së, shkaktoi krizë shëndetësore, ekonomike dhe sociale në mbarë botën dhe krijoi sfida të rëndësishme me pasoja të theksuara shëndetësore, socio-ekonomike, me ndikim në fuqinë punëtore të tregut dhe rritjen e papunësisë.

Për ballafaqimin me pasojat e krizës së shkaktuar nga virusi Kovid-19, Qeveria e RMV-së në periudhën prej 19.03.2020 deri më 20.04.2021 ka miratuar gjashtë pako masash ekonomike. Me revizionin kemi përfshirë planifikimin dhe zbatimin e gjashtë pakove të masave ekonomike të miratuara nga Qeveria e RMV-së në vitet 2020 dhe 2021 në pjesën e masave për mbështetjen financiare për subvencionimin e kontributeve për sigurimet e detyrueshme sociale, mbështetjen financiare për punëdhënësit për pagesën e pagave, mbështetjen financiare për personat fizikë të cilët kryejnë veprime të pavarura, kompensime me para për të gjithë personat që kanë humbur vendin e punës nga 11 mars deri më 30 prill 2020, si dhe masa për mbështetjen e profesioneve të prekura nga kriza ekonomike shëndetësore - mbështetje për sportistët, artistët e pavarur dhe punonjësit e kulturës.

Me këtë revizion të suksesit kemi përfshirë 36% të mjeteve totale të planifikuara për vitet 2020 dhe 2021 përmes programit të Qeverisë P – Masat për ballafaqimin me krizën Kovid-19, në vlerë prej 12.637.534 mijë denarë (rreth 205 milionë euro) nga të cilat janë realizuar 11.512. 447 mijë denarë.

Kriza e shkaktuar nga përhapja e virusit korona Kovid-19 shkaktoi humbje të vendeve të punës në RMV dhe humbje të mëdha të të ardhurave të punëtorëve, që ka ndikim në uljen e konsumimit të mallrave dhe shërbimeve. Sipas të dhënave të siguruara nga Agjencia e Punësimit në RMV nga fillimi i pandemisë deri më 31.12.2020, gjithsej 17.022 punëtorë i kanë humbur vendet e punës . Arszet e ndërprerjes është paraqitur në grafikën e mëposhtme:

### Struktura e ndërprerjes të marrëdhënies së punës



Duke theksuar rëndësinë e masave ekonomike të miratuara për të mbështetur punëdhënësit, personat fizikë të cilët kryejnë veprime dhe profesione të pavarura, si dhe ndikimin e tyre në zbutjen e efekteve të pandemisë, konstatuam gjendje të caktuar në fushat që janë lëndë e revizionit si në vijim:

**Në fushën e kornizës ligjore dhe krijimit të masave dhe politikave për mbështetjen e punësimit dhe profesioneve të prekura nga kriza shëndetësore dhe ekonomike, i kemi përcaktuar gjendjet si vijojnë:**

- mungesa e rregullimit ligjor të termit pandemi dhe lidhja e saj me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe planifikimin strategjik me qëllime të qarta dhe indikatorë të definuar për sukses:
- mungesa e analizave dhe vlerësimeve me shkrim gjatë krijimit të masave për mbështetjen e punësimit në procesin e vendimmarrjes dhe
- dobësi dhe paqartësi në rregulloret me fuqinë e ligjit dhe ligjet e miratuara në aspekt të definimit të kushteve për ndarjen e mbështetjes pa paraqitur dëshmi, monitorimin e kthimit të mjeteve financiare dhe qasjen e pabarabartë në rast të shkeljeve të kryera në periudha të ndryshme kohore.

**Në fushën e procedurave për ndarjen dhe zbatimin e masave për mbështetjen financiare të punësimit dhe profesioneve të prekura nga kriza shëndetësore dhe ekonomike, kemi përcaktuar gjendjen si vijon:**

- me revizionin e procedurave për ndarjen e mbështetjes për masat[8] përcaktuam se ulja e të ardhurave mbi 30% për muaj për të cilët aplikon kërkuesi, si kusht për ndarjen e mbështetjes, nuk kontrollohet nga DAP-i, për shkak të pamundësisë për kontrollin sistematik, që krijon rrezik për të ndarë mbështetjen financiare për përdoruesit të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara;
- kemi përshirë 422.851 mijë denarë mjete financiare të paguara në sektorin publik dhe sektorin privat, si plotësim të pakos së katërt të masave ekonomike për pagesën e pagave dhe ndihmës së njëhershme për të punësuarit, në bazë të Vendimeve të Qeverisë së RMV-së për vitin 2020. Mjetet janë ndarë pa kritere të përcaktuara për përzgjedhjen e subjekteve shfrytëzuese, kushtet për ndarjen, shumën e mjeteve financiare të miratuara dhe detyrimin për kthim, që mundëson transparencë të pamjaftueshme dhe mundësi për subjektivizmin dhe trajtimin e pabarabartë të shfrytëzuesve;
- në Vendimet për miratimin e mjeteve nga Buxheti i RMV-së për vitin 2021 si mbështetje e njëhershme financiare, në bazë të thirrjeve publike në shumë prej 448.698 mijë denarë nuk është paraparë mënyra e raportimit nga subjektet juridike për konfirmimin e gjendjes së numrit të punëtorëve, si dhe të mënyrës së kryerjes së kontrollit pas shfrytëzimit të mjeteve të ndara, që krijon rrezik subjektet juridike që nuk i kanë plotësuar kushtet mos t'i kthejnë mjetet në Buxhetin e RMV-së;
- ekziston mungesa e mënyrës gjithëpërfshirëse, reciprokisht e harmonizuar dhe e integruar e mbajtjes së evidencës së Qeverisë së RMV-së për mbështetjen dhe realizimin e masave të miratuara financiare, si dhe qasje jo të harmonizuar për informimin e institucioneve kompetente lidhur me zbatimin e masave që zvogëlojnë transparencën dhe llogaridhënien në shpenzimin e mjeteve dhe nuk krijon kushte për matjen e efekteve të tyre.

**Në fushën e mekanizmave të kontrollit, monitorimit dhe vlerësimit të rezultateve të arritura kemi përcaktuar gjendjen si vijon:**

- pas zbatimit të masave të realizuara për mbështetjen financiare të punëdhënësve për pagesën e pagave, DAP-i ka konstatuar se një numër i caktuar i punëdhënësve - shfrytëzuesve të mbështetjes nuk kanë paguar paga për punëtorët. Numri i punëdhënësve të cilët nuk i kanë paguar pagat deri në janar 2022 është 135 për gjithsej 435 punëtorë për shumën e mbështetjes së shfrytëzuar prej 6.317 mijë denarë, që ka për efekt disponimin padedikim të mjeteve të ndar nga mbështetja financiare;
- nga gjithsej 36.837 punëdhënës - shfrytëzues të mbështetjes për periudhën prill-qershor dhe tetor-dhjetor 2020, me kontrollet e jashtme nga DAP-i dhe/ose ISSH-ja janë përfshirë gjithsej 103 shfrytëzues me 1404 të punësuar nga të cilët pjesa më e madhe janë zbatuar si kontrolle të koordinuara bashkarisht. Pjesëmarrja e kontrolleve në lidhje me shumën e përgjithshme të mbështetjes financiare për periudhën

8 subvencionimi i kontributeve, mbështetja financiare për punëdhënësit për pagesën e pagave, duke përfshirë mbështetjen për personat fizikë të cilët kryejnë veprime të pavarura

e lartpërmendur është 0,53%, ndërsa shfrytëzuesit e mbështetjes për periudhën shkurt-mars 2021 për të cilat janë paguar 1,665,917 mijë denarë nuk janë të përfshirë me kontroll të jashtëm;

- detyrimet totale të llogaritura për kthimin e mjeteve nga shfrytëzuesit e masave për vitin 2020 janë në vlerë prej 1.356.062 mijë denarë, ndërsa të dhënat veçanti janë paraqitur në pasqyrën tabelare si vijon:

në (000) denarë

<table>
<tr><th rowspan="2">detyrimi për kthim</th><th colspan="2">personat juridikë</th><th colspan="2">personi fizik që punëson punëtorë</th><th colspan="2">personi fizik që kryen veprimtari të pavarur</th><th rowspan="2">Shuma e përgjithshme e llogaritur për kthim</th></tr>
<tr><th>numri</th><th>shuma e llogaritur për kthim</th><th>numri</th><th>shuma e llogaritur për kthim</th><th>numri</th><th>shuma e llogaritur për kthim</th></tr>
<tr><td>masa e subvencionim-it të kontributeve</td><td>688</td><td>32.647</td><td>137</td><td>2.779</td><td></td><td></td><td>35.426</td></tr>
<tr><td>Mbështetje financiare për pagesën e pagave - prill, maj dhe qershor 2020</td><td>6.154</td><td>877.276</td><td rowspan="2">760</td><td rowspan="2">55.207</td><td rowspan="2">1.480</td><td rowspan="2">41.267</td><td rowspan="2">1.236.002</td></tr>
<tr><td>Mbështetje financiare për pagesën e pagave - tetor, nëntor dhe dhjetor 2020</td><td>3.274</td><td>262.252</td></tr>
<tr><td>Kërkesat e refuzuara për grant dhe detyrim për kthim të mbështetje financiare</td><td>428</td><td>84.634</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>84.634</td></tr>
<tr><td>Gjithsej sipas të gjitha masave</td><td>10.544</td><td>1.256.809</td><td>897</td><td>57.986</td><td>1.480</td><td>41.267</td><td>1.356.062</td></tr>
</table>

Institucionet në RMV nuk kanë vendosur evidencë në bazë të kthimit të mbështetjes financiare për shfrytëzuesit dhe nuk disponojnë me të dhëna të plota për numrin e punëdhënësve që kanë përmbushur/nuk kanë përmbushur detyrimin për kthimin e mbështetjes financiare brenda afateve dhe shumës së përcaktuar, që ka për efekt realizimin e të ardhurave më të ulëta në Buxhetin e RMV-së;

- sipas të dhënave të marra nga MF-ja, konstatuam se për periudhën prill-qershor dhe tetor-dhjetor 2020 në Buxhetin e RMV-së nga subjektet juridike shfrytëzues të mbështetjes financiare për pagesën e pagave dhe subvencioneve të kontributeve janë kthyer mjetet në shumën prej 367.755 mijë denarë që është 29% nga detyrimi i llogaritur për kthim (shuma prej 1.256.809 mijë denarë). Për personat fizikë, vendimet për kthim (gjithsej 99.253 mijë denarë) janë lëshuar në dhjetor 2021, ndërsa të dhën për shfrytëzuesit nuk i janë paraqitur revizionit;
- gjatë shndërrimit të mbështetjes financiare në grant të pakthyeshëm, janë pranuar prokurime për veprime të zakonshme afariste të shfrytëzuesit të cilat nuk janë paraparë si kusht për mbështetjen e pakthyeshme, që ka të bëj me atë se me rregulloren për mbështetjen financiare për pagesën e pagave nuk është rregulluar saktësisht se cilat prokurime nuk do të njihen;
- mungesa e analizës gjithëpërfshirëse për të matur efektet nga masat në ruajtjen e vendeve të mbështetura të punës që krijojnë rrezik për reduktimin e llogaridhënies, vlerësimi i suksesit të masave të mbështetjes financiare për pagesën e pagave dhe subvencioneve të kontributeve, si dhe mundësia e ndërmarrjes së masave për përmirësim në kushtet kur paraqitet nevoja për krijimin e masave të reja për mbështetjen e punësimit.

Konstatuam se edhe përkundër numrit të madh të punëdhënësve të mbështetur për pagesën e pagave të të punësuarve, trendi i lëvizjes së të ardhurave të personave të papunë nga marrëdhëniet e punës sipas të dhënave të marra nga APRMV-ja duke filluar nga marsi i 2020 deri më shkurt të 2020 është vazhdimisht në rritje, ndërsa përfundimisht me tetorin e 2021 trendi i tij është i ndryshueshëm, është shfaqur në grafikën si vijon:

## NUMRI i PAPUNËSUARVE



Mangësitë e përcaktuara të masave për mbështetjen financiare të punësimit dhe profesioneve të prekura nga kriza shëndetësore dhe ekonomike të KOVID-19, sugjerojnë se është i nevojshëm përmirësimi i efikasitetit të institucioneve kompetente në planifikimin dhe zbatimin e masave të ardhshme për ruajtjen e vendeve të punës dhe uljen e pasojave ekonomike nga pandemia.

Masat për mbështetje financiare për subvencionimin e kontributeve dhe pagesën e pagave dhe mbështetje financiare të njëhershëm të personave fizik dhe juridik të veprimeve të veçanta pa të dhëna për kthim shkaktojnë zvogëlimin e të hyrave buxhetore në shumë të përgjithshme prej 1.437.005 mijë denarë ose rreth 23 milionë euro.

Gjithashtu, konstatuam se punëdhënëst dhe personat fizik shfrytëzues të masave për subvencionimin e kontributeve dhe pagesën e pagave, të cilët nuk e kanë plotësuar detyrimin për kthimin e mbështetjes financiare në afatet dhe shumën e caktuar në Buxhetin e RMV-së arrinë vlerë prej 988.307 mijë denarë, që ka efekt realizimin e më pak të të hyrave në Buxhetin e RMV-së. Mënyra e paparashikuar e vërtetimit të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga pakëti i gjashtë i masave për vitin 2021, për mbështetje të njëhershme financiare të personave fizik dhe juridik të veprimeve të veçanta, shkaktojnë zvogëlimin e të hyrave buxhetore në shumë prej 448.698 mijë denarë.

## 5.5.3. EFIKASITETI I MASAVE DHE POLITIKAVE TË NDËRMARRA PËR ZVOGLIMIN E EFEKTEVE TË PANDEMISË NË SEKTORIN E TURIZMIT

Është kryer revizioni i suksesit me temë "Efikasiteti i masave dhe politikave të ndërmarra për zvogëlimin e efekteve të pandemisë në sektorin e turizmit" me qëllim që t'i përgjigjemi pyetjes **"Masat dhe politikat e ndërmarra nga Qeveria e RMV-së dhe institucionet kompetente a janë në funksion të zhvillimit të turizmit dhe zbutjes së efekteve të krizës nga pandemia në sektorin e turizmit?"**

Bartës të politikave dhe veprimeve për zhvillimin e turizmit dhe zbutjen e efekteve të krizës nga pandemia në sektorin e turizmit janë:

- Qeveria e RMV-së - e përcakton politikën ekonomike dhe zhvillimore të vendit dhe i krijon masat ekonomike që janë të dizajnuara për t'u ballafaquar me krizën nga Kovid-19;
- Sektori për Turizëm dhe Hotelieri pranë Ministrisë së Ekonomisë - ndërmerr masa për zbatimin e ligjeve në fushën e turizmit, përgatit dhe zbaton programet e punës dhe dokumentet strategjike, propozon masa sistematike dhe zbatimin në krijimin e politikës turistike dhe
- Puna primare e Agjencisë për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit është promovimi i qendrave dhe objekteve turistike maqedonase jashtë vendit.

Në lidhje me kornizën e vendosur ligjore e cila rregullon sektorin e turizmit me revizionin konstatuam nevojën për ndryshimin e rregullativës ligjore për shkak të vështirësive në zbatimin e zgjidhjeve ligjore, që sjell vështirësi në zbatimin e programeve për zhvillimin e turizmit.

Me analizën e Strategjisë Nacionale për zhvillimin e turizmit 2016-2021 dhe Planit Aksional 2019-2021 kemi konstatuar se zbatimi i veprimeve të planifikuara nuk monitorohet dhe ekziston shkallë e pamjaftueshme e zbatimit të veprimeve të Planit Aksional, që ndikon në planifikimin, krijimin, miratimin dhe zbatimin e politikave dhe masave në fushën e turizmit.

Në pjesën e realizimit të veprimtarive programore të institucioneve kompetente për turizmin, është përcaktuar reduktimi i vazhdueshëm i Buxhetit për periudhën 2018-2021, me përjashtim të vitit 2020.

Kjo pikë ka të bëj me Programet Vjetore të Ministrisë së Ekonomisë për të cilët revizorët konstatuan se çdo vit zvogëlohen mjetet financiare. Në vitin 2020 për shkak të masave të Qeverisë nuk ka zvogëlim të mjeteve financiare për aktivitetet e programeve për fushat lëndë të revizionit.

Me revizionin është përcaktuar nevoja për përmirësimin e kapaciteteve institucionale, bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimtarive në nivel qendror dhe lokal dhe formimin e Komitetit të Turizmit si organ i rangut më të lartë përgjegjës për turizmin në vend. Me ndërprerjen e punës së Trupit Koordinues për Turizmin nuk ekziston koordinimi i plotë ndërmjet institucioneve dhe bartësve të sektorit të turizmit, ndërsa veprimi individual ka reduktuar ndikimin e sektorit gjatë krijimit të politikave ndërhyrëse për ballafaqimin me krizën nga Kovid-19, lloji i masave, miratimi i tyre në kohë dhe realizimi i shpejtë.

Në lidhje me krijimin e masave ekonomike për ballafaqimin me pandeminë është konstatuar munges të dokumentacionit për analizat dhe vlerësimet e kryera paraprake gjatë krijimit të masave mbi të cilat bazohet përfshirja e planifikuar dhe fondet e nevojshme për secilën masë ekonomike, kushtet dhe kriteret për ndarjen e tyre, si dhe analiza për ndikimin e masave dhe përcaktimin e qëllimit që duhet të arritet në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë, që e bën të vështirë monitorimin e suksesit të zbatimit të tyre, si dhe mungesën e udhëzimeve të ardhshme për veprim.

Qeveria e RMV-së nuk ka vendosur sistem për monitorimin e secilës masë veçmas dhe nuk është zhvilluar dhe publikuar baza qendrore e të dhënave në të cilën në nivel ditor ose mujor do të publikoheshin informacionet për nivelin e realizimit të secilës masë individuale me të dhënat për fondet e planifikuara, numrin e qytetarëve dhe subjekteve afariste për të cilët është dedikuar masa, burimi i mjeteve, shkalla e shfrytëzimit dhe mosshfrytëzimit të tyre, arsyet për mosrealizimin e masës.

Është konstatuar shkallë e ulët e zbatimit të masave në sektorin e turizmit, të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

000 denarë

| Masa të cilat shkaktojnë shpenzime të drejtpërdrejta buxhetore gjegjësisht implikime të drejtpërdreta fiskale | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Paketi | Masa | Plani i mjeteve për masën (1) | Mjetet e përdorura (2) | Mjetet e papërdorura (3) | Përdoruesit (4) | Përqindja e implementimit (5)=(2)/(1) |
| I | Vauçer për turizmin e brendshëm | 704.106 | 386.172 | 317.934 | 64.788 | 55% |
| II | Grant për udhërrëfyes turistik | 9.800 | 5.070 | 4.730 | 78 | 52% |
| III | Grant për agjenci turistike | 116.850 | 79.820 | 37.030 | 276 | 68% |
| IV | Kthimi i tatimit turistik për vitin 2019 | 120.000 | 57.824 | 62.176 | 214 | 48% |
| V | Mbështetja financiare për hotelet të cilat funksionojnë jashtë qendrave turistike, të cilat nuk kanë shfrytëzuar vauçerë | 64.600 | / | / | / | / |
| VI | Mbështetja financiare për agjencitë turistike | 86.100 | 52.300 | 33.800 | 258 | 61% |
| VI | Mbështetja financiare për udhërrëfyesit turistikë | të dhëna të përmbledhura | 2429 | / | 79 | / |
| VI | 50.000 PCR teste falas | nuk ka të dhëna | / | / | / | / |

Në lidhje me kontrollin mbi plotësimin e kushteve për ndarjen e mbështetjes financiare të agjencive turistike nga pakoja e gjashtë e masave, konstatuam se nuk është përcaktuar mënyra se si do të kryet kontrolli për plotësimin e kushteve, nuk është përcaktuar institucioni kompetent që do ta kryejë kontrollin dhe masat që do të ndërmerren në rast të mospërmbushjes së kritereve dhe moskryerjes së rimbursimit të mjeteve.

# 5.6. SHËNDETËSIA

## 5.6.1. FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I RMV-së

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (FSSHRMV) për vitin 2020, gjatë së cilës konstatuam:

- dobësi në kontrollet e brendshme dhe në terren gjatë konfirmimit të objektivitetit të ndërhyrjeve të faturuara mjekësore të realizuara nga ISHP-ja. Për shkak të krizës shëndetësore në vitin 2020 numri i kontrolleve në terren tek institucionet shëndetësore është ulur për 74% me çka është rrit rrezikun i njohjes dhe pagesës së shërbimeve shëndetësore në formë dhe lloje të ndryshme nga ato që realisht janë ekzekutuar. Sipas informacioneve të paraqitura, në vitin 2020 janë kryer gjithsej 83 kontrolle në institucionet shëndetësore, krahasuar me 472 në vitin 2019.



- numri më i vogël i kontrolleve janë kryer në institucionet shëndetësore të kujdesit shëndetësor spitalor, kompensimet kontraktuese të të cilave janë më të larta, ndërsa te të njëjtit janë konstatuar parregullsi në 85% raste;
- dobësi në funksionimin e sistemit të TI-së së FSSHRMV, para se gjithash në pjesën e mungesës së vazhdueshme të stafit të TI-së, mungesës së strategjive të TI-së dhe politikave dhe procedurave të papërditësuara të TI-së për sigurinë e TI-së, strukturës së vjetërsuar të serverit dhe funksionalitetit jo të plotë të moduleve aplikative;
- parregullsi dhe mosrespektim të afateve në pjesën e kryerjes së kontrolleve dhe shqiptimit të dënimeve kontraktuese, të cilat kanë ndikuar që të mos sanksionohen institucionet shëndetësore të cilat nuk veprojnë në përputhje me marrëveshjet e lidhura me FSSHRMV;
- gjatë pagesës së kompensimeve për pushimin e lindjes nuk janë vendosur kontrolle për shkak të të cilave janë paguar kompensimet edhe kur personat e siguruar kanë marrë pagë për orarin efektiv të punës;
- dobësi në procedurën e referimit për trajtim jashtë vendit të personave të siguruar, gjegjësisht nuk është siguruar mbrojtje adekuate juridike të personave dhe nuk është vendosur kontrollë, përkatësisht sistemi për monitorim dhe analizë të suksesit të trajtimit. FSSHRMV ka evidentuar paradhënie për trajtim jashtë vendit ndaj institucione të huaja shëndetësore në shumë prej 209,772 mijë denarë, për të cilat nuk ka informacione të sakta për gjendjen e trajtimit për shkak të mossigurimit të dokumentacionit mjekësor dhe financiar;
- parregullsi në zbatimin dhe realizimin e kontratave të prokurimeve publike, si dhe dobësi gjatë angazhimit të personave të huaj me kontratë pune.

Në pjesën e çështjeve të theksuara për pasiguri dhe vazhdimësi revizioni zbulon për:

- mënyrën e pagesës për shërbimet e kryera në institucionet shëndetësore, duke sugjeruar se nuk është siguruar blerja reale e shërbimeve të parapara me Ligjin për sigurim shëndetësor. Njëkohësisht në këtë pjesë u referohemi edhe situatave të ndodhura në ISHP si rezultat i krizës shëndetësore të shkaktuar nga pandemia COVID-19 në vitin 2020. Në të vërtet, në vitin 2021, 106 nga gjithsej 116 ISHP kanë marrë statusin e paqëndrueshëm për shkak të vëllimit dukshëm më të ulur të realizuar të shërbimeve në krahasim me kompensimin e dakorduar;
- mungesën e informacionit të plotë për kërkesat në bazë të kontributit të papaguar për sigurim shëndetësor dhe arkëtimit jashtëzakonisht të pasigurt të kërkesave të cilat kanë ndodhur përfundimisht më 31 dhjetor 2008.

Në pjesën e çështjeve të tjera raportojmë si vijon:

- në kushtet e pandemisë, për shkak të mossigurimit të më shumë termineve në ISHP dhe marrëveshjeve të palidhura me ISHP-në për diagnostikimin e COVID-19, nuk janë siguruar shërbime të mjaftueshme shëndetësore për të siguruarit në barrë të Fondit. Sipas të dhënave të publikuara nga Instituti i Shëndetit Publik, nga fillimi i pandemisë në nivel të RMV-së, në 33 laboratorë ISHP dhe ISHP janë kryer gjithsej 1.962.489 analiza, nga të cilat 1.337.238 PCR teste, ndërsa pjesa tjetër janë teste të shpejta të antigjenit. Lëvizja e trendit dhe struktura e testeve PCR të kryera dhe numri i laboratorëve në ISHP dhe ISHP nga fillimi i pandemisë në mars 2020 deri në mars 2022 janë paraqitur në info-grafikët e mëposhtëm:

## Numri i testeve PCR




## Numri i laboratorëve




Numri i testeve të kryera dhe shuma e çmimit të këtyre shërbimeve në laboratorët privatë në periudha të ndryshme thekson shpenzimet e fondeve financiare të qytetarëve në shëndetësinë private. E llogaritur me çmimin më të ulët të arkëtuar, sipas informacioneve të disponueshme publike, prej 1.400 denarë dhe 819.240 teste[9] të bëra në Institutin e Shëndetit Privatë për dy vite, bëhet fjalë për shumë jo më pak se 18,6 milionë euro, duke mos i marrë parasysh testet e shpejta të antigjenit dhe çmimet më të larta të arkëtuar të cilat lëviznin deri në 5.500 denarë për test;

- ekziston raport i pabarabartë gjatë kryerjes së shërbimeve shëndetësore kardiovaskulare-kirurgjikale në vitet 2019 dhe 2020 ndërmjet ISHP-së dhe Institutit të Shëndetit Privatë. Pikërisht, Fondi ka lidhur marrëveshje me tri ISHP dhe dy Institute të Shëndetit Privatë për të cilat janë paguar 1.254.330 mijë denarë, prej të cilave 95% nga shërbimet kryhen në Institutet të Shëndetit Privatë, ndërsa pjesa tjetër në ISHP. Pjesa më e madhe nga shërbimet në ISHP kryhen nga ISHP KU për kardiokirurgji shtetërore, e cila edhe pse ka staf të kualifikuar, nuk i ka kushtet e nevojshme hapësinore, që ndikon negativisht në formën e kryerjes së kujdesit shëndetësor. Për këtë arsye është e nevojshme që Ministria të ndërmarrë aktivitete për sigurimin e kushteve të nevojshme në ISHP, me çka do të arrihej konkurrencë më e madhe e shëndetit publik në fushën e kryerjes së shërbimeve shëndetësore kardiovaskulare-kirurgjikale. Veçanarisht për arsye se vëllimi i shërbimeve të kryera në ISHP është dukshëm më i ulët se tarifa e kontraktuar që ia paguan Fondi, kështu që rritja e vëllimit të shërbimeve shëndetësore nuk do të shkaktojë dalje shtesë të fondeve të konsiderueshme ndaj ISHP-së, ndërsa do të ndikojë në zvogëlimin e daljes së fondeve financiare ndaj Instituteve të Shëndetit Privatë;
- çmimet referente të shërbimeve shëndetësore dhe Lista e barnave në barrë të Fondit nuk përditësohen;
- nuk është miratuar Strategjia Nacionale për E-Shëndetësi, ndërsa Kartela Shëndetësore Elektronike është jofunksionale.

9 Të dhënat e publikuara nga Instituti i Shëndetit Publik;

## 5.6.2. AGJENCIA E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Agjencisë për Barna dhe Pajisjeve Mjekësore të RMV MALMED për vitin 2020 janë konstatuar këto gjendje:

- nuk janë vendosur të gjitha regjistrat e parashikuar me ligje, që ndikon në transparencën e procedurave të cilat i mban MALMED si dhe në informimin e publikut të gjerë dhe profesional;
- nuk është zbatuar plotësisht regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve;
- janë angazhuar persona me kontratë pune pa definuar qartë dhe saktë kualifikimet profesionale dhe detyrat dhe detyrimet e punës, ndërsa pagesat bëhen pa dorëzimin e dëshmisë/raport të punës së kryer, ose dëshmi të pranisë në vendin e punës;
- janë formuar 13 komisione të parakohshme dhe grupe pune, veprimtaritë e të cilëve nuk janë të karakterit të përkohshëm, në të cilat marrin pjesë edhe punonjësit e MALMED. Puna dhe angazhimi i tyre gjatë vitit 2020 zhvillohet në vazhdimësi, ndërsa ka të bëjë me aktivitetet që janë pjesë e detyrave të rregullta të punës së punonjësve;
- mënyra e evidencës, llogaritjes dhe arkëtimit të të ardhurave nuk është e rregulluar dhe as nuk është vendosur evidenca analitike e të ardhurave, dhe si rrjedhojë nuk ka të dhëna mbi sasinë e të ardhurave të arkëtuara për çdo lloj të certifikatës ose lejes që lëshohet;
- në procedurën për vendosjen e barnës në treg, nuk parashikohen mekanizma kontrolli me të cilat do të sigurohet përditësimi në procedurën e vlerësuesve për dhënien e vlerësimit të ekspertëve, për këtë arsye një numër i madh kërkesash nuk janë zgjidhur;
- në procedurat për regjistrimin e mjeteve mjekësore, nuk janë vendosur mekanizma kontrolli që do të sigurojnë trajtim të saktë dhe të barabartë të kompensimeve të paguara dhe si rrjedhojë janë arkëtuar më pak të ardhura në shumë prej 12.861 mijë denarë që ndikon te të ardhurat e kompletuara dhe i sjell në pozitë të pavolitshme kërkuesit;
- në procedurat për klasifikimin dhe regjistrimin e barnave të cilat jepen pa recetë, nuk është vendosur praktikë e barabartë e veprimit, gjegjësisht ekzistojnë produkte me emër të njëjtë gjenerike dhe fuqi nga prodhuesi i regjistruar si barnë, ndërsa nga prodhuesi tjerë janë regjistruar si produkt kufitar;
- në një pjesë të procedurave të zbatuara të prokurimeve publike kemi konstatuar zbatim të papërshtatshëm të dispozitave të Ligjit për prokurime publike, etj.

Në pjesën e theksimit të çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë revizioni zbuloi për:

- mënyrën e pamjaftueshme të rregulluar të shfrytëzimit dhe realizimit të të ardhurave të tepërta që e realizon MALMED
- monitorimin e pamundësuar të shkallës së përdorimit të lejeve të lëshuara për import në sistemin EXIM në të cilat janë theksuar sasitë e lejuara, as qasje te të dhënat kolektive me të cilat kufizohet kryerja e analizave që do të shërbenin për të përmbledhur rezultatet e punës dhe për të ndërmarrë veprimtari për të përmirësuar procesin e lëshimit të lejeve për importet e barnave dhe pajisjeve mjekësore
- kryerjen e pakontrolluar të kontrolleve klinike, trajtimin e pamjaftueshëm, shpërfilljen e interesit publik dhe përcaktimin subjektiv të kompensimit për ISHP-në ku kryhet i njëjti.
- gjatë vitit 2021 është miratuar ndryshimi i Ligjit për barnat dhe pajisjet mjekësore me të cilën mundësohet që kërkesa për vendosjen në qarkullim të vaksinës t'i parashtrojnë edhe personat juridikë të cilët nuk kanë përfaqësi të regjistruar në RMV me çka u mundësua prokurimi dhe importi i vaksinave për trajtimin e COVID 19, por me këtë zgjidhje ligjore nuk tejkalohet problemi nëse paraqitet nevoja për vendosjen në qarkullim të barnave për trajtim të sëmundjes tjetër që do të shkaktonte epidemi ose pandemi.

## 5.6.3. INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE

Me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2021 janë përfshirë pesë institucione shëndetësore publike në fushën e sigurimit shëndetësor primar dhe terciar, si Shtëpia e Shëndetit Manastir, Qendra për Shëndet Publik Manastir, Qendra Klinike Stomatologjike, Klinika Universitare për Kardiokirurgji Shtetërore dhe Instituti Universitar për Tomografi me Emision Pozitron.

Me revizionet e kryera të raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë u konstatuan gjendjet të cilat në pjesën më të madhe përsëriten edhe në raportet e viteve të mëparshme tek institucionet tjera të shëndetit publik, që kanë të bëjnë me:

- dobësitë në kontrollin e brendshëm në pjesën e procedurave të shkruara për punë, aktivitetet kontrolluese gjatë realizimit dhe lidhjes së kontratave për prokurime publike dhe përcaktimin e vërtetësisë dhe objektivitetit të dokumentacioneve financiare, definimi i përgjegjësive dhe kompetencave të personave të përfshirë në procesin e punës;
- parregullsitë në zbatimin e regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve;
- të drejtën e papërcjellur të përdorimit të përhershëm të tokës dhe të objekteve ndërtimore;
- parregullsitë në mënyrën e evidentimit të mjeteve materiale dhe mirëmbajtjen e pajisjeve;
- parregullsitë në evidentimin dhe monitorimin e konsumimit të barnave dhe materialeve të tjera mjekësore;
- evidentimin dhe pagesen e detyrimeve jo në kohë;
- aktivitetet e pandërmarra për arkëtimin në kohë të kërkesave për shërbimet e kryera shëndetësore dhe kompletimin e pasigurt të të ardhurave për shërbimet e kryera shëndetësore;
- parregullsitë në mënyrën angazhimit të personave të jashtëm me kontratë në vepër;
- respektimin e pasiguruar konsekuent të dispozitave të Ligjit për prokurime publike në procedurat për dhënien e kontratave të prokurimeve publike dhe monitorimin e realizimit të kontratave të lidhura.

Në pjesën **Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi,** është raportuar për:

- kërkesat e paarkëtuara të institucioneve të shëndetit publik nga Ministria e Shëndetësisë për shërbimet e kryera shëndetësore sipas Programeve për mbrojtjen shëndetësore nga vitet e mëparshme për të cilat me programet për vitin 2020 nuk parashikohen fonde për pagesën e kërkesave nga vitet e mëparshme, prandaj arkëtimi i këtyre kërkesave nga ministria kompetente në periudhën e ardhshme është i pasigurt.
- mënyra se si zbatohet programi për parandalimin e sëmundjeve kardiovaskulare është i papërshtatshëm dhe është e nevojshme që Ministria e Shëndetësisë ta rishqyrtojë nevojën për të vazhduar më tej programin edhe në vitet e ardhshme në të njëjtin vëllim dhe mënyrë si edhe më parë.
- Hapësira në të cilën funksionon Klinika Shtetërore për Kardiokirurgji është e pamjaftueshme dhe me marrëdhënie ligjore të pazgjidhura të pronës për çka Ministria e Shëndetësisë duhet të ndërmarrë veprime për tejkalimin e këtyre gjendjeve.

Në pjesën e **çështjeve të tjera**, revizioni raporton si vijon

- Edhe përkundër ekzistimit të detyrimeve ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë për vendosjen e Sistemit Nacional për Punën Materiale-Financiare dhe Kontabilitet dhe Sistemin qendror për regjistrimin e orëve të punës për nevojat e institucioneve të shëndetit publik, ato nuk janë në funksion. Është e nevojshme të ndërmerren aktivitete për rishqyrtimin e këtyre zgjidhjeve ligjore dhe mundësitë për zbatimin dhe funksionalitetin e tyre.
- Është e nevojshme që Ministria e Shëndetësisë të ndërmarrë veprime për të zbatuar aktivitetet e parashikuara me ligj për të rregulluar funksionimin e laboratorëve dhe veprimtarisë laboratorike për të ofruar siguri dhe krahasueshmëri të rezultateve nga analizat laboratorike të zbatuara në laboratorët e vendit.

# 5.7. ENERGJETIKA

## 5.7.1. EKSPLOATIMI I BURIMEVE TË UJIT GJATË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN PREJ 2012 DERI MË 2021

Është kryer revizioni i pajtueshmërisë, me qëllim që të vlerësojë nëse institucionet kompetente sigurojnë ligjshmëri në procesin e planifikimit dhe dhënies së koncesioneve, dhënien e lejeve për të drejtën e ujit, monitorimin e tyre, komunikimin dhe shkëmbimin e ndërsjellët të informacioneve, si dhe arkëtimin e plotë dhe të saktë të kompensimeve të koncesionit dhe kompensimeve për përdorimin e ujit.

Me revizionin e kryer të fushës së theksuar konstatuam më shumë gjendje ndër të cilët:

Është konstatuar se dokumentet strategjike janë miratuar pa vlerësim strategjik të ndikimit në mjedisin jetësor dhe nuk janë përmbushur objektivat e vendosura për ndërtimin e hidroelektraneve të mëdha, me ç'rast nuk janë përmbushur objektivat e përcaktuara të detyrueshme për pjesëmarrjen në ripërtëritjen e burimeve të energjisë në konsumimin total të energjisë finale.

Në të vërtetë, edhe pse për shfrytëzim më të madh të potencialit hidroteknik me strategjitë është paraparë ndërtimi i 7 hidroelektranave të mëdha, me të cilat do të arrihej pjesëmarrja shtesë prej mbi 26% në totalin e nevojave për energji elektrike, aktivitetet në periudhën e deritanishme janë fokusuar kryesisht në ndërtimin e hidroelektraneve të vogla edhe përkundër asaj që me ndërtimin e plotë të tyre do të arrihej pjesëmarrja margjinale në nevojat totale.

Thirrjet publike për 61% të numrit  total të koncesioneve të dhëna për HEV janë shpallur në periudhën para miratimit të dokumenteve strategjike. Atyre u garantohet blerja e të gjithë prodhimit të energjisë elektrike sipas tarifave preferenciale të parashikuara me ligj, për të cilat janë paguar 41 milionë euro më shumë në raport me vlerën e tregut të energjisë së prodhuar elektrike, ndërsa marrin pjesë me 4% në totalin e prodhimit vendas të energjisë elektrike në vitin 2020.



Procedurat për ndarjen e koncesioneve për përdorimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike janë zbatuar pa vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor, ndërsa një pjesë pa studim të projektit koncesionar, në bazë të të dhënave të parashkruara hidrologjike. Me këtë rast nuk janë lidhur marrëveshje për koncesion për 62% gjegjësisht 70% të totalit të lokacioneve të shpallura nga ME-ja dhe MMJPH-ja për shkak të dobësive gjatë planifikimit dhe përzgjedhjes së lokacioneve.

Dobësitë gjatë dhënies së lejeve dhe kontrollit joefikas nga ana e institucioneve kompetente kanë mundësuar shfrytëzimin e ujit pa lejen e siguruar për të drejtën e ujit, ndërsa për shkak të mosvendosjes së librit të ujit, MMJPH-ja nuk disponon me të dhëna të plota për kërkesat e pranuara dhe lejet e lëshuara për të drejtën e ujit dhe nuk është siguruar disponueshmëria e tyre për shërbimet inspektuese.

Miratimi i elaborateve për mbrojtjen e mjedisit jetësor është bërë pa përcaktimin adekuat të ndikimit të mundshëm në mjedisin jetësor, që sjell rrezik ndërtimi i hidroelektranave të vogla të ketë ndikime të caktuara negative mbi ekosistemet e lumenjve dhe biodiversitetin natyror.

Planifikimi joadekuat, procedura e ndërlikuar në disa institucione dhe mosrespektimi i afateve për veprimin e tyre kanë ndikuar që dokumentacioni i nevojshëm për disa nga hidroelektranet e vogla të mos sigurohet brenda afatit të përcaktuar dhe të shtyhet fillimi i punës ose të ndërpriten kontratat, dhe me këtë një pjesë e koncesionerëve të vendosen në pozitë të pabarabartë.

Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor nuk kanë kapacitete të mjaftueshme dhe koordinim të ndërsjellë për monitorimin e veprimtarisë koncesionare, në kushtet kur regjistri i koncesioneve për shfrytëzimin e ujit nuk është i rregulluar, ndërsa regjistri i kontratave të dhëna për PPP që udhëhiqet në ME është i paplotë.

ISHMJ-ja nuk kanë inspektorë të mjaftueshëm të ekonomisë së ujit, nuk zbaton koordinim dhe planifikim efikas gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese të hidroelektraneve dhe nuk ka siguruar mbrojtje të dokumentacionit dhe transparencë për punën e saj.

Dispozita aktuale ligjore për llogaritjen e kompensimit si përqindje të çmimit të prodhimit të energjisë elektrike, pa e definuar atë, ka kontribuar që përdoruesit të zbatojnë çmimet e prodhimit të llogaritura në mënyrën e tyre ose të zbatojnë çmimet e shitjes.

Mënyra e vendosur e llogaritjes dhe pagesës mujore të kompensimit për të drejtën e ujit dhe evidentimi i saj vetëm në librat tregtare të prodhuesve të energjisë elektrike nuk ofron monitorim dhe kontroll të vazhdueshëm dhe as mundësi për të siguruar arkëtimin e plotë dhe të rregullt të kompensimit.

Si rrjedhojë revizioni ka konstatuar se nga hidroelektranat e vogla që janë prodhues preferencialë, në Buxhetin e RMV-së nuk janë paguar 22.841 mijë denarë, që paraqet 41% nga kompensimi i përgjithshëm i llogaritur.



Revizioni thekson se për disa nga lokacionet e ndara ka vonesë në procedurën e cila nuk mund t'i atribuohet si faj koncesionerit, ndërsa disa janë përfshirë në zonën e mbrojtjes së Parkut Nacional, për çka ekziston siguria se kontratat do të ndërpriten me implikime të mundshme fiskale për Buxhetin e RMV-së.

## 5.7.2. SHA PËR PRODHIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE ESM NË PRONËSI SHTETËRORE

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së SHA për prodhimin e energjisë elektrike ESM, në pronësi shtetërore Shkup (SHA ESM Shkup), për vitin 2020.

Me revizionin e kryer kemi konstatuar më shumë gjendje ndër të cilat:

- Në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2020, një shumë e konsiderueshme fondesh janë investuar në projekte të cilat nuk kanë përfunduar dhe pajisje të cila nuk përdoren. Për realizimin e projekteve dhe prokurimeve janë lidhur kontrata për të cilat janë paguar gjithsej mjete në vlerë prej 1.328.104 mijë denarë ose rreth 21,5 milionë euro. Këto projekte dhe prokurime i referohen: sistemit informativ afarist, pajisjeve për përmirësimin e telekomunikimit dhe rrjetëzimit, mallrave nga "sistemi për monitorimin e lëvizjes dhe matjen e sasive të thëngjillit dhe matjen e aktiviteteve të makinerive shoqëruese për njësinë prodhuese Minierat në REK Manastir", ndërtimit të digës dhe formimit të akumulacionit, propozim-projektit për energji të rinovueshme, ndërtimit të objektit të ri administrativ, rikonstruimit dhe rindërtimit të fasadës së objektit administrativ të EVN Maqedoni SHA dhe SHA ESM Shkup dhe shpenzimeve të tjera që u referohen shërbimeve konsultante, mendimeve për studime fizibiliteti dhe hulumtimeve të tjera, të cilat nuk janë përdorur për realizimin e projekteve konkrete.
- Projekti për modernizimin e Bllokut 1 në REK Manastir nuk është realizuar dhe i njëjti në periudhën nga viti 2011 deri në periudhën e publikimit të raportit ka shkaktuar shpenzime joproduktive në vlerë të përgjithshme prej 1.296.211 mijë denarë (rreth 21 milionë euro). Pjesa më e madhe e shpenzimeve ose 55% janë shpenzime të avokatit për përfaqësim në procedurat e arbitrazhit dhe shpenzime të cilat rrjedhin nga procedurat e humbura, 39% e shpenzimeve janë në bazë të avansit të paguar dhe mjeteve kreditore të tërhequra për sigurimin e kreditit dhe 6% provizion i paguar për mostërheqjen, mjetet të miratuara nga linja kreditore për financimin e këtij projekti.
- Regjistrimi i mjeteve dhe i detyrimeve në fund të vitit nuk është zbatuar në tërësi dhe në pajtim me Rregulloren për kryerjen e regjistrimit. Ndër të tjera, konstatuan se për një periudhë më të gjatë kohore ka pasur mosharmonizim të sasisë prej 2.505.956 kg, në mes të mazutit të evidentuar në evidencën e kontabilistit dhe atij të paraqitur në listat e regjistrimit, e shprehur në vlerë dallimi është 62.650 mijë denarë (të llogaritur sipas çmimit mesatar më 31.12.2020).
- SHA ESM Shkup disponon me listë pronësie për tokat dhe objektet ndërtuese, por për shkak të mungesës së të dhënave të detajuara dhe të sakta në librat afaristë, nuk është e mundur të vërtetohet plotësia e tyre, sipërfaqja dhe pronësia. Për tokën që me vendim të Qeverisë së RMV-së i është dhënë në shfrytëzim të përhershëm dhe në të cilën po ndërtohet objekti i ri administrativ - Objekti afarist i SHA ESM Shkup nuk është filluar procedura për sigurimin e listës pronësore.
- Janë konstatuar dobësi në zbatimin e Ligjit për prokurime publike, ndër të tjera, në pjesën e përcaktimit të vlerës së vlerësuar të prokurimeve, dëshmimin aftësinë së kërkuar me procedurën dhe përmbajtjen e specifikacionit teknik. Duke pasur parasysh se SHA ESM Shkup nuk ka obligim që t'i zbatoj dispozitat e këtij ligji në rastet kur lënda e prokurimit është energjia ose derivatet për prodhimin e energjisë, për realizim transparent të këtyre prokurimeve, shpall thirrje publike, në raport është nënvizuar nevoja e miratimit të procedurës për mënyrën e planifikimit dhe zbatimit të thirrjeve publike për prokurimin e derivateve për prodhimin e energjisë elektrike.

- Është vendosur evidencë joadekuate e rezervimit për rikultivimin e tokave të degraduara dhe anulimin e tyre, që ndikon në paraqitjen e dyfishtë të shpenzimeve në periudhën paraprake, si dhe paraqitjen e gabuar të të ardhurave nga rezervimet në vitin 2020.
- Janë konstatuar dobësi edhe në pjesën e kontrolleve të brendshme të vendosura në procesin e menaxhimit dhe punës së sistemit të TI-së, gjatë së cilës të njëjtit nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për sigurinë e TI-së dhe praktikat më të mira dhe paraqesin rrezik për funksionimin e sistemit.

Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi janë theksuar çështjet të cilat i referohen:

- Nevojës për sigurimin e lejes për harmonizim me planin operativ për termoelektranën REK Manastir, si kusht për funksionimin e tij dhe kontrollin e emetimeve të dyoksidit të squfurit dhe pluhurit që dalin nga aktiviteti që e kryen. Kështu që, në periudhën 2019 - gusht 2021, emetimet e matura të dyoksidit të squfurit dhe pluhurit në vazhdimësi janë mbi kufit e vlerave të lejuara, që ndikon në cilësinë e mjedisit jetësor, si dhe në shëndetin e njeriut.
- Nevojës për prokurim të objektit ndërtues dhe tokës në zonën qendrore të Shkupit me vlerë të përgjithshme prej 123,787 mijë denarë (pa TVSH), nëse merret parasysh se nga viti 2013 kanë filluar aktivitetet për ndërtimin e objektit të ri administrativ në të cilin duhet të vendoset menaxhmenti i SHA ESM Shkup, ndërsa është anuluar edhe renovimi i fasadës së objektit ekzistues administrativ.
- Shqyrtimit të vendimeve të miratuara për financimin e aktiviteteve që nuk janë në veprimtarinë e SHA ESM Shkup, siç janë huat e dhëna subjekteve në vlerë të përgjithshme prej 134,749 mijë denarë, për shkak të ndikimit të tyre në punën e SHA ESM. Shkup, likuiditetit dhe rentabilitetit i tij.
- Zbulimit të planeve të mundshme në të ardhmen për "Kodrën e Diellit – Tetovë" e cila është filial në kuadër të "ELEM TOURS" SHPKNJP Shkup, në drejtim të dhënies me koncesion, PPP ose shitjes. Qëllimi i këtyre planeve është përmirësimi i kushteve në qendrën e skijimit, objekteve akomoduese dhe zhvillimi i turizmit, si dhe gjendja financiare e "ELEM TOURS" SHPKNJP Shkup. Gjatë miratimit të vendimeve është e nevojshme të merren parasysh huat e dhëna deri më tani për "ELEM TOURS" SHPKNJP Shkup, si dhe investimet e rëndësishme në periudhën 2012-2020.
- Vëmendje e veçantë në raport është dhënë për të përshkruar gjendjen në RMV në lidhje me burimet e mundshme të prodhimit të energjisë elektrike, rolin e SHA ESM Shkup në sistemin energjetik në vend, të ardhurat që realizohen nga shitja e energjisë elektrike, problemet me të cilat ballafaqohet në raport me rezervat e thëngjillit dhe çmimit të ofruar për energjinë elektrike ndaj furnizuesit universal.

Kapaciteti total i instaluar për prodhimin e energjisë elektrike në RMV është 2.06 GW dhe kryesisht vjen nga funksionimi i termocentraleve dhe hidrocentraleve. Prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në RMV është SHA ESM Shkup me rreth 70% të kapacitetit të përgjithshëm të instaluar. RMV-ja ka varësi relativisht të lartë nga importi i energjisë elektrike, me peshë mesatare të importeve prej rreth 30%. Për shkak të sasive të shterura dhe të kufizuara të thëngjillit, janë shqyrtuar mundësitë e furnizimit nga burime të tjera furnizuese, siç është kalimi në burime të tjera të energjisë[10].

10 Strategjia për zhvillimin e energjetikës deri në vitin 2040 (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.25 nga 05.02.2020).

**Të ardhurat e realizuara të SHA ESM nga shitja e energjisë elektrike në periudhën 2018-2020**




Te grafiku vërehet trend në rënie i të ardhurave nga shitja e energjisë elektrike furnizuesit universal (që përdoret për ekonominë dhe familjet) si dhe rënia e të ardhurave nga shitja e tepricës së energjisë elektrike, ose shitjet në tregun e lirë. Në vitin 2020, duke pasur parasysh sasinë e vogël të tepricës së energjisë elektrike dhe fuqisë së prodhuar, u zbatuan vetëm dy ankande për shitje. Me liberalizimin dhe rritjen e konkurrencës në tregun evropian energjetik, SHA ESM Shkup në të ardhmen mund të presë rrezik për zvogëlimin e të ardhurave nga shitja e energjisë elektrike, si dhe me uljen e rentabilitetit.

# 5.8. SHOQËRIA INFORMATIKE

## 5.8.1. INTEROPERABILITETI MIDIS INSTITUCIONEVE TË SEKTORIT PUBLIK

Është kryer revizioni i TI-së si revizion i suksesit me temën "Funksionaliteti i platformës për interoperabilitet midis institucioneve të sektorit publik".

Qëllimi i revizionit ishte t'i përgjigjej pyetjes "A është funksionale platforma e interoperabilitetit?"

Me revizionin e kryer është konstatuar se platforma është operative, por ekzistojnë gjendje të caktuara në fushën e lëndës së revizionit që kanë ndikim të rëndësishëm në funksionimin dhe shfrytëzimin e saj, si vijon:

- organet e administratës shtetërore, Qeveria e RMV-së, ministritë, NJVL-të dhe institucionet e tjera, vonohen me detyrimet ligjore për vendosjen e digjitalizimit të procedurave, ndërsa në të njëjtën kohë ekziston edhe interesi i dobët për t'iu bashkuar platformës

së interoperabilitetit me qëllim të mundësimit të shërbimeve digjitale për qytetarët dhe institucionet;

- në periudhën kohore prej 01.01.2019 deri më 31.12.2021, për 338 ditë ose 31% e numrit të përgjithshëm të ditëve në periudhën e lartëpërmendur nuk ka kontratë të lidhur për mirëmbajtjen e platformës së interoperabilitetit;
- ekziston mungesë konstante e personave të punësuar të TI-së në MSHIA dhe në institucionet që janë të lidhura me platformën e interoperabilitetit;
- mungesa e trupit qeveritar për koordinimin dhe monitorimin e zhvillimit dhe përmirësimit të sistemeve të cilat përdoren nga më shumë institucione në përputhje me dokumentet e miratuara zhvillimore, strategjitë, planet e veprimit;
- nuk ekzistojnë sisteme të certifikuara dhe kontrolle të sigurisë së tyre;
- në platformë janë të lidhura vetëm 2,93% e institucioneve, të cilat në pajtim me kompetencat ligjore janë të detyruara të përdorin platformën për shkëmbimin e të dhënave në formë elektronike dhe sigurimin e shërbime elektronike për qytetarët;
- trafiku i përgjithshëm në platformë sipas viteve, pavarësisht lidhjes së institucioneve të reja, është në rënie të lehtë. Vlera mesatare për ngarkesën e procesorit në pikën qendrore të platformës është 6%;
- në vend që të zvogëlohet, çmimi për përcjelljen e një mesazhi, gjatë viteve ai rritet.

Në drejtim të tejkalimit të gjendjes së konstatuar janë dhënë rekomandime për përmirësimin e gjendjes në fushën e menaxhimit dhe zhvillimit të platformës së interperabilitetit, përkufizimin e kornizës strategjike për menaxhimin me të nëpërmjet planeve të sakta të veprimit dhe rreziqeve dhe mënyrave të TI-së të përkufizuara saktë për menaxhimin me to.

## 5.8.2. SISTEMI INFORMATIKË PËR PARAQITJE, TESTIM DHE PUNËSIM NË AGJENCINË E ADMINISTRATËS

Është kryer revizioni i TI-së i sistemit informatikë për paraqitje, testim dhe punësim në Agjencinë e Administratës (Agjencia) për realizimin e kompetencave gjatë punësimit në administratën publike dhe për të kontrolluar pajtueshmërinë e proceseve të sistemit informatikë me ligjet, politikat dhe standardet që zbatohen në Agjencinë e Administratës.

Në bazë të revizionit të kryer, janë konstatuar gjendjet si vijojnë:

- Sistemi mundëson konfidencialitet dhe integrim të të dhënave, si dhe disponueshmëri të sistemit në pjesën e paraqitjes dhe administrimit të kandidatëve për punësim në administratën publike, përveç se në pjesën e përditësimit të bazave të pyetjeve për zbatimin e provimeve për nëpunës administrativë dhe menaxhimin administrativ,
- Sistemi informatikë, duke përfshirë: harduerin, rrjetet e komunikimit, aplikacionet softuerike dhe të dhënat që i përmbajnë, janë në dispozicion të përdoruesve në çdo kohë me qëllim të kryerjes së veprimtarive të punës, si dhe të kandidatëve në procesin e krijimit të llogarisë dhe dhënies së provimeve, përveç se në fushën e kufizimit të qasjes në rrjetin kompjuterët gjatë kohës dhe dhënies së provimit,
- nuk monitorohen parimet e sigurisë për përdorimin e burimeve, d.m.th nuk janë vendosur politikat e kontrollit të qasjes,
- rregullativa ligjore ekzistuese është plotësisht e rregulluar dhe mundëson kornizë juridike adekuate dhe të mjaftueshme për zbatimin e procedurave për punësimin e nëpunësve administrativë, por nga ana e Agjencisë nuk i kanë respektuar dispozitat në pjesën e kufizimit të qasjes së rrjetit në kompjuterët gjatë kohës

së dhënies së provimit dhe përditësimin e bazave të pyetjeve.

- Agjencia nuk ka përgatitur dokumentet strategjike dhe planifikuese në fushën e vazhdimësisë së aktiviteteve, politikave dhe procedurave të TI-së për sigurinë e TI-së.
- kapacitetet njerëzore në Departamentin e TI-së dhe mbështetjes dhe në Sektorin për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim nuk janë plotësuar në mënyrë adekuate, dhe nuk janë përcaktuar edhe pozitat e ndjeshme të punës.

Janë dhënë rekomandime për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara me qëllim të forcimit të kapaciteteve në Departamentin e TI-së dhe mbështetjes, përcaktimin e pozitave të ndjeshme të punës me qëllim të përkufizimit të procedurave për rritjen e mbikëqyrjes dhe kontrollit, përgatitjen e planit të vazhdimësisë, përgatitjen e planit për zëvendësimin e punonjësit, përcaktimin e ekipit për rastet urgjente, përgatitjen e politikave dhe procedurave të TI-së, zbatimin dhe dokumentimin e inspektimeve periodike të sistemit për zbatimin e provimit, prokurimin e pajisjeve të sofistikuara të rrjetit me të cilat do të zbatohet segmentimi adekuat i rrjetit kompjuterik të Agjencisë, përgatitjen e procedurës për ndryshime në bazën e pyetjeve dhe kontrollit në "katër sy".



# 5.9. DREJTËSIA DHE SIGURIA

## 5.9.1. MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Është kryer revizioni i raporteve financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) për vitin 2020, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë.

Me revizionin e kryer janë konstatuar më shumë gjendje ndër të cilat:

Në kushtet e strukturës komplekse dhe të dispersuar organizative të MPB-së, është konstatuar nevoja për intensifikimin e aktiviteteve për përcaktimin e vlerës së tokave dhe objekteve ndërtimore të cilat i përdor Ministria e Punëve të Brendshme dhe në të cilat i zbaton përgjegjësitë e saja, për të evidentuar plotësisht pronën e patundshme me të cilën disponon MPB-ja.

Ministria e Punëve të Brendshme disponon me shumë magazina në të cilat ruhen rezervat e materialeve, pjesët rezervë dhe inventari i imët, pika karburanti për karburantet e blera për nevojat e automjeteve zyrtare, si dhe kuzhina për ushqimin e punonjësve të caktuar në MPB. Duke pasur parasysh vëllimin si dhe karakterin heterogjen të transaksioneve, natyrën specifike të funksionimit, është konstatuar nevoja për të rregulluar mënyrën e vlerësimit të stoqeve gjatë shfrytëzimit të tyre, për të monitoruar pa probleme gjendjen e tyre.

Duke pasur parasysh përmasat dhe kompleksitetin e aktiviteteve të cilat kryhen nga MPB-ja si subjekt i madh në sektorin publik, si në aspektin e mjeteve financiare me të cilat disponon dhe numrin e të punësuarve, ashtu edhe në aspektin e shpërndarjes territoriale në të gjithë vendin, u konstatua se ekipi i kuadrit të Departamentit për Revizion të Brendshëm, si dhe numri i revizioneve të kryera gjatë vitit, ndikojnë në vëllimin e informacioneve të cilat i merr personi udhëheqës për punën e MPB-së dhe rekomandimet për përmirësimin e tij.

Në lidhje me zbatimin e kompetencave të MPB-së lidhur me regjistrimin vjetor të mjeteve dhe detyrimeve, është konstatuar se ai nuk është i plotë dhe nuk është zbatuar plotësisht në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e miratuara brenda me të cilat është rregulluar mënyra e zbatimit të tij.

Me kontrollin e kryer në mënyrën e zbatimit të procedurave të prokurimeve publike, ndërsa për zbatimin e plotë të dispozitave të Ligjit për prokurimet publike, rritja e transparencës dhe konkurrencës gjatë zbatimit të prokurimeve dhe realizimin e kontratave për prokurimet publike janë dhënë rekomandime në pjesën e mënyrës së realizimit të pjesës së marrëveshjeve kornizë, në drejtim të përgatitjes së kontratave individuale të prokurimeve publike, kërkesave deri te bartësit e prokurimeve në formën me shkrim për realizimin e punimeve brenda afateve të parashikuara në marrëveshjet.

MPB-ja, përveç mjeteve nga Buxheti i RMV-së, realizon të ardhura edhe në bazë të kompensimeve për shërbime të kryera për pasaporta të lëshuara, letërnjoftime, patentë shoferi, leje trafiku, targa dhe për ofrimin e ndihmës (asistencës) ndaj subjekteve të tjera juridike.

Në vitin 2020, nga të ardhurat totale, 79% janë të ardhura nga shërbimet për formularë të lëshuara dhe targa të regjistrimit, të veçmas  sipas llojeve në tabelën e mëposhtme:

## Të hyrat nga formularët e lëshuar dhe targat e regjistrimit




Me analizën e kryer të stoqeve të formularëve të paguеshëm (certifikatë shtetësie, patentë shoferi, leje trafiku, vërtetim për vozitje prove, leje për armë), formularë biometrikë (pasaporta, letërnjoftime dhe patentë shoferi) dhe targa të regjistrimit, është konstatuar se aplikacioni i softuerit në SPB Shkup është jofunksional dhe nuk ka mundësi për servisimin e tij.

Në MPB në proces është futja e të dhënave në sistemin e integruar softuerik për punën materiale - financiare në nivel të çdo SPB-je, me zbatimin e plotë e të cilit pritet të vendosen të dhënat e plota dhe evidencat në kohë e të gjitha ndryshimeve të stoqeve të formularëve të pagueshëm për çdo SPB individualisht dhe në nivel të të gjithë MPB-së.

Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi është zbuluar se në përputhje me Ligjin për Agjencinë e Sigurisë Nacionale nga data 01.09.2019, Agjencia e Sigurisë Nacionale (ASK) filloj të punojë si organ i pavarur i administratës shtetërore me status të personit juridik. Për të punuar papengesë ASK-ja, ASK-së i janë dhënë të gjitha pasuritë e patundshme dhe të tundshme, pajisjet, evidencat e kontabilitetit, dokumentacioni, arkivat dhe mjetet e punës së përdorura nga Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim. Gjatë vitit 2020, në bazë të tetë vendimeve të Qeverisë së RMV-së, janë dorëzuar mjetet themelore dhe inventari i imët në posedim të ASK-së, por ende nuk është bërë pranim-dorëzimi i pronës së patundshmërisë, pajisjeve informatike dhe telekomunikacionit.

## 5.9.2. MINISTRIA E DREJTËSISË

Është kryer revizioni i raporteve financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2020, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë.

Me revizionin e kryer janë konstatuar më shumë gjendje ndër të cilat:

Mungon njësia funksionale e revizionit të brendshëm në drejtim të minimizimit të dobësive dhe përmirësimin e proceseve të kontrollit dhe menaxhimit me rreziqet, regjistrimi jo i plotë i kryer i mobilieve të zyrës së prokuruar për nevojat e Gjykatës Themelore Penale, pagesa e mjeteve për të cilat nuk është vepruar plotësisht sipas marrëveshjes dhe nuk është ndërmarrë asnjë aktivitet për sigurimin e dokumentacionit për të drejtën e përdorimit të sendeve të patundshme për një pjesë të drejtorive rajonale të ministrisë.

Për paraqitje reale të pozicionit të tokës në librat afaristë të ministrisë, është sugjeruar nevoja e inicimit të procedurës në Qeverinë e RMV-së për miratimin e Vendimit me të cilin do të bartet e drejta e shfrytëzimit të tokës në të cilën janë ndërtuar gjykatat.

Ministria e Drejtësisë nevojitet të vazhdojë me aktivitetet në drejtim të pranim-dorëzimit të plotë të mobilieve të prokuruar për zyrë të cilat me vendim të Qeverisë së RMV-së i janë caktuar në përdorim të përhershëm Gjykatës Themelore Penale, ndërsa janë evidentuar në evidencat e kontabilitetit të ministrisë.

Nga llogaria e ministrisë në bazë të kontratës së lidhur janë paguar mjetet për dhënie me qira të objektit në të cilin ndodhet Gjykata Administrative, e cila me Vendim të Qeverisë së RMV-së në vitin 2018 ka marrë në shfrytëzim të përhershëm, pa kompensim, sende të patundshme - objekt, që deri në vitin 2021 nuk është përdorur.

Gjithashtu, nga llogaria e ministrisë bëhet pagesa e mjeteve në bazë të vendimeve gjyqësore si kompensim në para për personat e privuar nga liria në mënyrë të pajustifikueshme, të cilët nuk mund të parashikohen dhe planifikohen, gjë që mund të sjellë shpenzimin e mjeteve buxhetore nga zëra të tjerë dhe të pengojnë në kryerjen e veprimtarive normale të ministrisë.

## 5.9.3. MINISTRIA E DREJTËSISË-DREJTORIA PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE

ESHR-ja ka kryer revizionin e raporteve financiare të Ministrisë së Drejtësisë – Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve për vitin 2020, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë.

Me revizionin e kryer janë konstatuar më shumë gjendje ndër të cilat:

Nevoja që rregullisht dhe në koordinim me autoritetet kompetente të llogaritet dhe të bëhet pagesa e kontributeve për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në bazë të aftësisë së kufizuar dhe lëndimit trupor të shkaktuar nga lëndimi në punë ose sëmundja profesionale për personat që vuajnë dënimin me burgim dhe kanë vuajtur masën edukative në shtëpinë edukative - korrektuese dhe ekipimi dhe funksionimi i revizionit të brendshëm.

Janë theksuar edhe dobësitë sistematike në lidhje me mjetet elektronike dhe sistemin për monitorimin dhe zbatimin e masës së paraburgimit në RMV, gjegjësisht se i njëjti ende nuk është aktiv, për çka institucionet kompetente në bashkëpunim me Drejtorinë duhet të ndërmarrin masa dhe aktivitete, për mundësimin e funksionimit operativ dhe të pandërprerë të pajisjeve për mbikëqyrjen elektronike, me qëllim të kryerjes së punëve provuese dhe sigurimin e sistemit efikas të mbikëqyrjes elektronike gjatë ekzekutimit të masës së arrestit shtëpiak në të gjithë territorin e RMV-së.

Gjithashtu është theksuar gjendja për aktivitetet e Drejtorisë në lidhje me realizimin e Projektit "Rikonstruimi i institucioneve penitensiare në RM", në bazë të Marrëveshjes kornizë për hua nga Banka për Zhvillim pranë Këshillit të Evropës, me të cilën është paraparë rikonstruimi

dhe ndërtimi i IP i Idrizovës, Burgu Shkup dhe ndërtimi i Burgut të Kumanovës dhe VPD-së Tetovë. Investimet për objektet në IP Kumanovë në vlerë prej 3.967 mijë denarë dhe në IP-IEVP Tetovë në vlerë prej 250.159 mijë denarë kanë përfunduar dhe në zhvillim e sipër janë procedurat për dhënien e së drejtës së pronësisë institucioneve, përkatësisht dhënien e lejeve të shfrytëzimit dhe listave pronësore nga ana e institucioneve kompetente në RMV.

## 5.9.4. INSTITUCIONI PENITENSIAR BURGU SHKUP - SHKUP

Me revizionin e kryer të raporteve financiare të IP Burgu Shkup - Shkup për vitin 2020, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë, është konstatuar nevoja për plotësimin e personelit të sektorit për risocializim të personave të dënuar dhe të departamentit për trajtimin me edukatorë, instruktorë për aftësim pune me qëllim të mos vihet në pikëpyetje procesi i risocializimit të personave të dënuar.

Gjithashtu është e nevojshme vendosja e revizionit të brendshëm, miratimi i politikave të kontabilitetit për përgatitjen, prezantimin dhe shpalosjen e raporteve financiare dhe arsyetimet e raporteve financiare, vendosja e evidencës së kontabilitetit për pajisjet materiale me të cilat disponon IP Burgu Shkup - Shkup, vendosja e evidencës së kontabilitetit dhe materialeve të sakta për pranim, dhënien e rezervave, kryerja e regjistrimit të pajisjeve, kërkesave dhe detyrimeve në mënyrë të paraparë me rregullativën ligjore, përcaktimi i strukturës së moshës së detyrimeve ndaj MPB-së, të cilat përfshijnë 99% të totalit të detyrimeve të papaguara, ndërsa u referohen shërbimeve të kryera - asistencës gjatë ndjekjes së personave të paraburgosur dhe të dënuar.

Për disa nga procedurat për PP-në, është konstatuar se nuk është siguruar transparencë e plotë dhe konkurrencë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

## 5.9.5. GJYKATA E APELIT SHKUP

Është kryer revizioni i raporteve financiare të Gjykatës së Apelit Shkup për vitin 2020, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë, ku është konstatuar nevoja për funksionimin e plotë të sistemit të kontrollit të brendshëm, regjistrimi i detyrimeve ndaj furnizuesve duke përcaktuar bazën ligjore, origjinën, strukturën e moshës dhe arsyet e shfaqjes së tyre, si dhe nevojën për evidencën e kontabilitetit të saktë dhe në kohë të kërkesave të paarkëtuara në bazë të paushallit gjyqësor dhe paraqitjen e tyre në raportet financiare.

Janë theksuar dobësitë sistematike, të cilat i referohen nevojës së miratimit të aktit nga ana e Gjykatës Supreme të RMV-së, me të cilin duhet të përcaktohet shuma dhe menyra e përcaktimit të paushallëve si shpenzime në procedurë, që gjykatësit të veprojnë dhe të vendosin. Është përcaktuar nevoja për rregullimin e mënyrës së llogaritjes së shtesës për përvojë pune në llogaritjen e pagave të gjykatësve dhe nëpunësve gjyqësorë.

Është bërë analiza e numrit të lëndëve të pazgjidhura nga vitet e kaluara, të sapopranuara, të zgjidhura dhe lëndëve të tjera të pazgjidhura gjyqësore për periudhën 2018-2020 të cilat janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

## Gjendja me lëndët gjyqësore në Gjykatën e Apelit Shkup në periudhën 2018-2020




Në vitin 2020, numri i lëndëve të pranuara është ulur për 26% në krahasim me vitin e kaluar, por numri i lëndëve të pazgjidhura mbetet i konsiderueshëm për 35% në vit.

## 5.9.6. GJYKATA THEMELORE TETOVË

Me revizionin e kryer të Gjykatës Themelore Tetovë në raportet financiare për vitin 2020, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë, është konstatuar nevoja për vendosjen e evidencës materiale të pajisjeve të përhershme, zbatimi i regjistrimit në mënyrën e paraparë me rregullativën ligjore dhe lidhjen e marrëveshjes për rimbursim të shpenzimeve për shërbimet komunale me përdorues të hapësirës.

Në lidhje me arkëtimin e paushallit gjyqësor është konstatuar nevoja për mbajtjen e evidencës për paushallët e arkëtuar gjyqësorë në kontabilitetin e gjyqit dhe vendosjen e evidencës së kontabilitetit të kërkesave të paarkëtuara në bazë të paushallit gjyqësor.

Gjithashtu, ka nevojë për vendosjen e kontrollit të plotë në gjendjen dhe lëvizjet e fondeve depozituese në lëndë të caktuara, kryerja e mbikëqyrjes së punës materialo-financiare me fondet e depozitave dhe sendeve të sekuestruara dhe të bëhet regjistrimi i mjeteve të pranuara në bazë të depozitave gjyqësore.

Në Gjykatën Themelore Tetovë mbahen lëndët të cilat janë konfiskuar me vendim të formës së prerë në procedurë të kundërvajtjes dhe penale, të cilat nuk janë marrë nga Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar.

Në bazë të Ligjit për menaxhimin me lëvizjen e lëndëve në gjykatat[11], kryetari i Gjykatës themeloi trup pune për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në Gjykatën Themelore Tetovë.

Është bërë analiza e numrit të lëndëve të pazgjidhura[12] dhe është konstatuar se Gjykata Themelore Tetovë nuk ka arritur ta tejkalojë hyrjen e lëndëve të sapopranuara, me çka është rritur numri i lëndëve të pazgjidhura edhe përkundër numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve për punë është në rritje dhe është 85% në vitin 2018, 93% në vitin 2019 dhe 2020.

11 Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 42/2020.

12 Raportet vjetore për punën e Gjykatës Themelore Tetovë për periudhën 2018-2020.

## 5.10. TRAFIKU, TRANSPORTI DHE KOMUNIKIMI

### 5.10.1 HEKURUDHAT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT - SHA TRANSPORT

ESHR-ja ka kryer revizionin e raporteve financiare dhe së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Hekurudhave të Republikës së Maqedonisë së Veriut - SHA Transport - Shkup për vitin 2020.

Me revizionin në vitin 2010 ishte konstatuar nevoja e vendosjes së sistemit të plotë të kontrolleve të brendshme dhe procedurave për punë me të cilat do të sigurojë funksionimin, monitorimin dhe zhvillimin e menaxhimit dhe kontrollit financiar të qëndrueshëm në të gjitha njësitë organizative.

Në shoqërinë përdoret sistemi i vjetruar i TI-së për të cilën është përcaktuar nevoja për marrjen e masave për përcaktimin e rreziqeve të TI-së, si dhe për tejkalimin e gjendjes në sistemin e TI-së me qëllim të parandalimit të aksidenteve dhe mosfunksionimit të mundshëm të tij.

Llogaritja e pagës për të punësuarit në shoqëri nuk është në përputhje me dispozitat ligjore dhe me marrëveshjet kolektive: koeficientët për çdo vend pune që janë përcaktuar në Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të shoqërisë, nuk janë të harmonizuara me konceptin e pagave bruto.

Gjithashtu joreale është vlera e vlerësuar e aktivës në bazë të evidentimit të pranuar inicial gudvil në vitin 2007, kur është kryer ndarja e kapitalit, mjeteve, të drejtave, detyrimeve dhe punonjësit e NP Hekurudhat e Maqedonisë u ndanë në dy subjekte juridike, NP Hekurudhat e Maqedonisë Infrastruktura dhe Hekurudhat e Maqedonisë SHA Transport. Nuk është përcaktuar mënyra e kryerjes së regjistrimit të shoqërisë me akt të veçantë dhe regjistrimi vjetor me gjendje 31.12.2020 nuk është zbatuar plotësisht, ndërsa është llogaritur amortizimi pa u kryer vlerësimi i kohëzgjatjes së përdorur të mjeteve dhe gjendja e tyre faktike/reale. Kërkesat afatshkurtra nga klientët dhe detyrimet afatshkurtra ndaj furnizuesve nuk janë deklaruar në mënyrë objektive dhe ato datojnë nga viti 1991.

Janë konstatuar mospërputhje në procedurat për dhënien e kontratave për PP-në dhe mosrespektim të dispozitave të tyre, me çka nuk është siguruar transparencë dhe konkurrencë e plotë ndërmjet operatorëve ekonomik.

Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi janë theksuar çështjet, ndër të cilat janë: humbja e vazhdueshme vjetore e shoqërisë, fonde të pamjaftueshme në nivel vjetor për të subvencionuar shpenzimet e trafikut të pasagjerëve nga Buxheti i RMV-së si shërbim me interes publik.

### 5.10.2. NDËRMARRJA RADIODIFUZIVE PUBLIKE RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË SHKUP - TVM

ESHR-ja ka kryer revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2020 te Ndërmarrja Radiodifuzive Publike Radiotelevizioni i Maqedonisë, Shkup (TVM), të themeluar nga Kuvendi i RMV-së, gjatë së cilës janë konstatuar gjendjet më të rëndësishme si vijojnë:

- janë përcaktuar dobësi në kontrollet e brendshme të vendosura në punën e TVM-së dhe të njëjtit paraqesin rrezik pas menaxhimit të suksesshëm me rreziqet, operacionet kryesore ekonomike, ndarjes së kompetencave dhe mbikëqyrjes së vendosur mbi aktivitetet;
- nuk janë miratuar akte strategjike, planifikuese, programore dhe nënligjore që mund të ndikojnë në planifikimin, punën dhe zhvillimin e TVM-së;
- në përmbajtjen e aktit për organizimin dhe sistematizimin e disa prej vendeve të punës nuk janë të përcaktuara kërkesat për llojin specifik të formimit profesional dhe përshkrimin e detyrave të punës. Më pas vijojnë dosjet jo të plota të punonjësve dhe vlerësimi jo i plotë i disa prej punonjësve, që mund të kontribuojë në plotësimin e vendeve të punës me staf që nuk ka kualifikime dhe njohuri në fushën e kërkuar për vendin e punës;

- aktet e brendshme dhe mënyra e llogaritjes së pagës nuk janë plotësisht të harmonizuara me rregullat ligjore në fuqi;
- nuk është vendosur njësia për revizionin e brendshëm e cila duhet të kontribuojë për përmirësimin e menaxhimit me rreziqet, kontrollin dhe menaxhimin;
- në regjistrin tregtar dhe regjistrin e personave të tjerë juridikë në Regjistrin Qendror të RMV-së nuk është bërë regjistrimi i kapitalit bazë të ndërmarrjes;
- regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve në fund të vitit nuk është zbatuar në tërësi dhe në mënyrë të rregulluar në pajtim me Rregulloren për kryerjen e regjistrimit;
- janë konstatuar parregullsi në mënyrën e evidentimit të rezervave, për shkak të të cilave për një pjesë të rezervave të konsumuara nuk janë evidentuar shpenzime;
- mungojnë të dhënat për masat e ndërmarra për arkëtimin e kërkesave të cilat janë më të vjetra se pesë vjet, si dhe mundësia për arkëtimin e tyre;
- janë konstatuar parregullsi në mënyrën e planifikimit, dhënies së kontratave për PP-në dhe zbatimin e tyre

Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi janë shpalosur gjendjet si vijojnë:

- mandati i skaduar i Këshillit të Programit dhe ndikimi i tij në zgjedhjen e Këshillit Mbikëqyrës, drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të TVM-së;
- përfshirja e personave udhëheqës në dispozitat e marrëveshjes kolektive;
- analiza e gjendjes së detyrimeve në TVM tregon se në vitin 2020 ka ulje të ndjeshme të detyrimeve ndaj furnizuesve, por detyrimet për kreditë afatshkurtra dhe afatgjata brenda dhe jashtë vendit janë ende të mëdha dhe mund të kenë ndikim negativ në likuiditetin e subjektit në periudhën e ardhshme;
- ndikimi i mjeteve buxhetore në zhvillimin dhe punën e NP-së, ndërsa të ardhurat e realizuara nga aktivitetet komerciale paraqesin shumë të parëndësishme dhe kanë trend të vazhdueshëm të rënies. U theksua nevoja për vendosjen e synimeve afatgjata për rritjen dhe zhvillimin e RTM-së dhe përcaktimin e planeve vjetore për realizimin e tyre me qëllim të rritjes së atraktivitetit të saj për publikun dhe arritjes së sasisë më të madhe të të ardhurave nga operacionet komerciale.

## Struktura e të hyrave të realizuara në periudhën 2015-2020



### 5.10.3. AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Agjencionit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (ASHMAA), të llogarisë për punën e rregullt për vitin 2020.

Me revizionin e kryer janë konstatuar gjendje të caktuara të cilat janë në lidhje me:

- zbatimin e papërshtatshëm të dispozitave ligjore me të cilat rregullohet e drejta e pagës:
- pagimin e nivelit të cilësisë së punëve të kryera si pjesë e pagës bazë dhe shtesës së pagës së suksesit në punë që duhet të ketë efekt në pagesën e fondeve të cilat nuk janë në përputhje me aktet ligjore;
- për të njëjtin vend të punës me nivel të njejtë të ndërlikuar janë caktuar numër të ndryshëm të pikëve (të përkufizuar si komponent variabil (nga-deri) gjatë përcaktimit të pagës bazë, me çka është përcaktuar se dallimi në vlerë të pagës bazë për të njëjtin vend të punës ndryshon dhe ky dallim lëvizë në kuadër prej 5 deri në 10 mijë denarë dhe
- gjatë zbatimit të regjistrimit të fondeve, kërkesave dhe detyrimeve, procedurat e parashikuara në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore nuk janë kryer në tërësi.

Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi janë zbuluar gjendjet për:

- ndarjen e donacioneve-ndihmës financiare në shumën totale prej 105.000 mijë denarë të TVM-së, radiodifuzerët komercialë dhe joprofitues të cilët kryejnë emetimin televiziv dhe radio në territorin e RMV-së, MSH-së dhe MPB-së për ballafaqimin me pesojat nga KOVID-19;
- Vendimet për fshirjen në evidencën e kontabilitetit të ASHMAA-së, të kërkesave të arkëtuara në bazë të kompensimeve vjetore për lëshimin e lejeve për kryerjen e veprimtarisë radiodifuze në shumën totale prej 20.736 mijë denarë dhe
- shqyrtimi i gjendjes së ASHMAA-së, si tatimpagues për TVSH-në.

## 5.11. MJEDISI JETËSOR

### 5.11.1. POLITIKAT DHE MASAT E MARRA NGA ANA E RMV-së / AUTORITETET KOMPETENTE, ME QËLLIM TË ZBUTJES SË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Sipas të dhënave të paraqitura në studimet shkencore, ndryshimi i sotëm klimatik shkaktohet nga ngrohja globale, gjegjësisht rritja e temperaturës mesatare të planetit Tokë. Kjo rezulton me ndryshime në: sasinë e reshjeve, nivelin e ujit në dete, liqene, lumenj dhe ujëra nëntokësore, botën bimore dhe shtazore, që ndikon edhe në jetën e njeriut. Ndryshimi i klimës në fakt është proces natyror që ndodh që nga formimi i planetit tonë, por këto ndryshime janë intensifikuar në 100 vitet e fundit si rezultat i rritjes së aktivitetit njerëzor . Në përgjithësi pranohet se ndryshimet klimatike, përkatësisht ngrohja globale në ose mbi 2°C, do të ketë pasoja të rënda për planetin Tokë.

**Ngrohja globale** shkaktohet nga efekti i serrës, përkatësisht mbulesa e serrës gjatë ditës lejon depërtimin e rrezeve të diellit dhe nxehtësia e krijuar brenda serrës nuk lejohet të dalë jashtë dhe atëherë murret e serrës bëhen më të ngrohta. Muret e serrës së planetit Tokë përfaqësojnë atmosferën e cila e rrethon planetin. Në atmosferë ka gazra të ndryshëm, ndërsa disa prej tyre, siç është dioksidi i karbonit ($CO_2$) kanë të njëjtat veti si edhe muret e serrës dhe ruajnë nxehtësinë e planetit. Përveç dioksidit të karbonit ($CO_2$), gazrat e tjerë të cilët shkaktojnë efektin e serrës të prodhuar nga aktivitetet njerëzore janë metani ($CH_4$), oksidi nitrik ($N_2O$), fluoro - hidrogjen karboni

(HFC), perfluorokarbonet (PFCs) dhe heksafluoridi i squfurit (SF6). Sa më i lartë të jetë përqendrimi i këtyre gazrave, aq më shumë nxehtësi mbetet e bllokuar në atmosferën e cila e rrethon planetin.

Ndikimi i ndryshimeve klimatike në sektorë të caktuar në jetën e përditshme është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

### HIDROLOGJIA DHE BURIMET UJORE

thatësirat, vërshimet, zhdukja e botës ujore, zvogëlimi i mundësisë së shfrytëzimit të hirdo-potencialeve për prodhimin e energjisë elektrike, etj.

### BUJQËSIA

efekte negative në produktivitetin e tokës, degradimin dhe erozionin e saj.

### PYLLTARIA

rritja e sasisë së materialit të thatë, të ndezshëm, ndërsa me këtë edhe rritja e numrit të zjarreve.

### NDIKIMET NË SHËNDET

mund të jenë direkte ose indirekte. Për shkak të rritjes së temperaturave, numër më i madh i vdekjeve nga nxehtësia. Grupi i veçantë i rrezikuar i qytetarëve janë personat me çrregullime neurologjike, demencë dhe goditje në tru. Gjithashtu njerëzit mund të vuajnë edhe për shkak të paraqitjes së sëmundjeve infektive si p.sh.: nëpërmjet riprodhimit të mushkonjave që përhapin sëmundje ngjitëse.

### NDIKIMET EKONOMIKE

Dëmi ekonomik nga ndryshimet klimatike është rreth 25% e BPV-së globale. FMN-ja vlerëson se fatkeqësitë natyrore që lidhen me ndryshimet klimatike reduktojnë rritjen me 0,4 pikë përqindje mesatarisht, ndërsa te ekonomitë më pak të zhvilluara edhe deri me 0,7 pikë përqindje.

ESHR-ja nëpërmjet revizionit të kryer të suksesit me temë "Masat dhe politikat e marra nga ana e RMV-së/autoritetet kompetente me qëllim të zbutjes së ndryshimeve klimatike" me të cilën qëllimi ishte t'i përgjigjej pyetjes: **"A janë vendosur kushte ligjore dhe institucionale në RMV për zbatimin e masave dhe politikave të miratuara në lidhje me zbutjen e ndryshimeve klimatike?"** iu bashkua radhës së institucioneve që përpiqen ta reduktojnë ndikimin e ndryshimeve klimatike.

Me revizion u përfshin edhe institucionet të cilat marrin pjesë drejtpërdrejt ose indirekt në krijimin e masave dhe politikave për zbutjen e ndryshimeve klimatike, si: MMJPH, ME, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, MBPEU, Agjencia për Energji, NJVL, Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të RMV-së, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike dhe një organizatë joqeveritare.

Nga revizioni i kryer është konstatuar se korniza juridike dhe institucionale e vendosur në RMV nuk i siguron të gjitha kushtet e nevojshme për zbatimin dhe monitorimin efikas dhe efektiv të masave dhe politikave të miratuara për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Me angazhimin dhe përpjekjet e institucioneve shtetërore, janë pranuar detyrimet ndërkombëtare për uljen e efektit të ndryshimeve klimatike, me ç'rast janë përgatitur dhe miratuar numër i madh i dokumenteve strategjike, planifikuese dhe programore në nivel nacional dhe vendor. Aktivitetet e përkufizuara për zbutjen e ndryshimeve klimatike në dokumentet e theksuara nuk janë zbatuar plotësisht dhe nuk monitorohet zbatimi i tyre.

## Aktivitetet e ndërmarra ndërkombëtare

**VITI 1992**

Është miratuar Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike (UNFCCC) me qëllimin e vetëm të stabilizohen përqendrimet e gazrave serrë të cilët shkaktojnë efekt në serrë.

**VITI 1997**

Protokolli i Kiotos është miratuar si mekanizëm për forcimin e qëllimeve të Konventës Kornizë të OKB-së me atë përcaktohen objektivat e detyrueshme dhe kufijtë e saktë për çdo vend të zhvilluar për të cilin duhet të reduktojë nivelet e gazit serrë. Në vitin 2012, u miratua Amendamenti i Protokollit të Dohasë.

**VITI 2015**

Marrëveshja e Parisit, marrëveshja e parë globale e detyrueshme ligjërisht për klimën, u nënshkrua nga 197 vende. Qëllimi i marrëveshjes është të kufizojë rritjen e temperaturës mesatare globale në "shumë nën" 2°C dhe të promovojë përpjekjet për të mbajtur rritjen e temperaturës mesatare globale që të jetë jo më shumë se 1.5°C në krahasim me nivelet para-industriale. Marrëveshja e Parisit nuk paraqet objektiva detyruese për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë.

Komiteti Nacional për ndryshimet klimatike i RMV-së i cili duhet të ofrojë udhëzime për veprimet e përgjithshme klimatike, si dhe të kontribuojë në integrimin e aktiviteteve në politikat, planet dhe masat sektoriale është themeluar në vitin 2003, por nuk funksionon në praktikë, d.m.th. ekzistenca e tij është nga natyra formale.

Nuk është vendosur asnjë sistem për inventarizimin e emetimeve të gazrave serrë, ndërsa Inventari nacional i emetimeve të gazrave serrë është vendosur nga më shumë institucione. Pikërisht për këtë nuk ekziston baza e të dhënave të vetme për emetimet e gazrave serrë në një vend, që e bën të vështirë përdorimin e tyre gjatë përgatitjes së dokumenteve nacionale strategjike, planifikuese dhe programuese për veprimin klimatik.

Mungojnë lidhjet funksionale dhe koordinimi ndërmjet institucioneve në nivel nacional dhe lokal gjatë zbatimit të masave dhe aktiviteteve për planifikimin e politikave për zbutjen e ndryshimeve klimatike, si dhe monitorimin e tyre. Mungesa e burimeve financiare, njerëzore dhe teknike, si parakusht i rëndësishëm për integrimin e politikave klimatike në të gjithë sektorët, kontribuojnë më tej në mosarritjen e efekteve të dëshiruara për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Në dispozitat ligjore mungon përkufizimi i qartë për financimin klimatik dhe nuk ekziston shënim klimatik i buxhetit, gjegjësisht nuk ekziston sistemi për monitorimin dhe konfirmimin e efekteve të shpenzimeve publike për zbutjen e ndryshimeve klimatike.

**Financimi i aktiviteteve për të reduktuar ndikimin e ndryshimeve klimatike në disa institucione.**

Në periudhën 2017 - 2021, nga 5% deri në 1.8% të fondeve të programit për investime në mjedisin jetësor në MMJPH janë përdor konkretish për qëllime që njihen saktësisht si projekte të ndryshimeve klimatike, përkatësisht për: përgatitjen e planit, strategjisë dhe aktiviteteve edukative.

## Realizimi i mjeteve nga Programi për investime në mjedisin jetësor

për periudhën 2017-2021
në 000 denarë




Në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor është paraparë kompensimi për prodhimin e energjisë nga lëndët djegëse fosile dhe tatimpaguesit janë të detyruar ta paguajnë atë në llogarinë përkatëse të fletëpagesës në kuadër të llogarisë së thesarit. Fondet e mbledhura nga ky kompensim duhet të përdoren për financimin e programeve dhe aktiviteteve për menaxhimin me mjedisin jetësor në lidhje me ndikimet e sektorit të energjisë. Për periudhën 2018 - 2019, nga  Qeverisa e RMV-së janë miratuar dy vendime individuale për ndarjen e mjeteve të realizuara në bazë të këtij kompensimi si grante të dedikuara për komunat. Është përcaktuar se shkalla e realizimit të këtyre vendimeve është 15% në vitin 2019 dhe 36% në vitin 2021.

Në periudhën 2017-2020, Qeveria e RMV-së, me propozim të ME-së, miratoi Program Vjetor për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe nxitjen e efikasitetit energjetik në amvisëri, me të cilin janë siguruar 242.700 mijë denarë, ndërsa janë realizuar gjithsej 193.414 mijë denarë. Gjithashtu, ka miratuar edhe Programin për mbështetjen financiare të prodhimit të energjisë elektrike nga prodhuesit preferencialë që shfrytëzojnë premium për vitin 2019 për të cilin janë siguruar 20.000 mijë denarë. Në fund me vitin 2021 janë publikuar 3 shpallje publike për dhënien e marrëveshjeve për të drejtën e shfrytëzimit të premive, ndërsa janë lidhur 38 marrëveshje dhe janë vënë në funksion 6 elektrocentrale fotovoltaike.

Mjetet e planifikuara dhe të realizuara nëpër komuna, të cilat janë në funksion të zbutjes së ndryshimeve klimatike, u referohen subvencioneve të dhëna qytetarëve si nxitje për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, përmirësimin e ndriçimit publik në komuna nëpërmjet zëvendësimit të llambave ekzistuesve me llamba led dhe aktivitete tjera.

Në periudhën 2014-2017, për ndikim të drejtpërdrejtë në zbutjen e ndryshimeve klimatike si ndihmë ndërkombëtare, janë marrë 114 milionë USD nga burime të ndryshme, ndërsa në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2019 janë marrë 25.1 milionë USD.

**Ndihma financiare e marrë**

2018 - 2019
në 000 USD




## 5.12. FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET KOMUNALE

### 5.12.1. NDËRMARRJET PUBLIKE NË NIVEL LOKAL

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2020 te NP "Ujësjellësi", NP "Pastërtia dhe Gjelbërimi", NP "Plani i Kumanovës", NP "Kumanovo Gas", NP "Tregu" dhe NP "Parkimi i Kumanovës" Kumanovë, të themeluara nga Komuna e Kumanovës dhe NPK "Nikolla Karev" Probishtip, e themeluar nga Komuna e Probishtipit.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë së NP-ve janë konstatuar gjendje të caktuara, ndër të cilat më kryesoret janë:

Detyrimet ligjore për lidhjen e marrëveshjeve me shfrytëzuesit e shërbimeve të ujit të pijshëm dhe me ofruesin e shërbimit për furnizim me uj, nuk është respektuar plotësisht nga ana e NP "Ujësjellësi" Kumanovë. NPK "Nikolla Karev" Probishtip nuk ka lidhur marrëveshje me krijuesit e mbeturinave komerciale, personat juridikë për grumbullimin dhe transportin e saj, ndërsa te NP "Pastërtia dhe Gjelbërimi" Kumanovë përqindja e marrëveshjeve të lidhura është 8%.

Te NP-të e reviduara, aktet e brendshme dhe mënyra e llogaritjes së pagës nuk janë harmonizuar me rregullat ekzistuese ligjore, ndërsa personat e angzhuar përkohësisht kryejnë detyra të rregullta pune për periudhë edhe më të gjatë se dy vjet.

Është e pranishme gjendja e humbjes së ujit në sistemin për furnizim me ujë prej 55% te NP "Ujësjellësi" Kumanovë, gjegjësisht 65% te NPK "Nikolla Karev" Probishtip, si rezultat i rrjetit të prishur të ujit dhe të vjetruar, përshkueshmëria e rezervuarit, konsumimi dhe lidhja jolegale, josaktësia e ujëmatësve, shpenzimet e pafaturuara, ujitja e sipërfaqeve publike të gjelbëruara për të cilat nuk kanë vendosur aparat për matjen e rrjedhës, etj.

Për arsye të shlyerjes së detyrimeve jo në kohë për kompensim të shfrytëzimit të ujit dhe për lëshimin e ujit nga ana e NP "Ujësjellësi'" Kumanovë - 28.713 mijë denar dhe NPK "Nikolla Karev'" Probishtip - 3.540 mijë denarë, janë realizuar të ardhura më pak në Buxhetin e RMV-së në shumë prej 32.253 mijë denarë.

Më pak të ardhura u realizuan edhe në Buxhetin e Komunës së Kumanovës, si rezultat i shlyerjes së parakohshme të detyrimeve nga ana e NP "Pastërtia dhe Gjelbërimi" Kumanovë, për kompensimin e mirëmbajtjes së pastërtisë publike në shumë prej 121.838 mijë denarë.

NPK "Nikolla Karev" Probishtip pa bazë kryen arkëtimin e kompensimit për shërbime funerale dhe kompensimin e investimit për plehra. Nuk posedon leje për mirëmbajtjen e pastërtisë publike dhe lejen për të kryer veprimtari për deponim dhe tretman të hedhurinave me çka ka sjellë në dyshim aftësinë dhe përgjegjësinë e NPK-së si ofrues i shërbimeve në kryerjen e veprimtarisë së saj.

Te NP "Tregu" Kumanovë janë kostatuar dobësi në mënyrën se si janë dhanë me qira hapësirat afariste - dyqanet dhe tezgët (mostransparenca, mosrespektimi i kushteve për lëshimin dhe mungesa e kritereve të sakta) që udhëzon në zgjedhje të papërshtatshme të qiramarrësit, përdorimit të pamjaftueshëm të hapësirës dhe më pak të ardhura të realizuara të ndërmarrjes nga veprimtaria e saj themelore.

Në regjistrin e vetëm tregtar dhe regjistrin e njësive të tjera të personave juridikë në Regjistrin Qendror të RMV-së nuk është kryer regjistrimi i kryegjësë themelore të NP "Ujësjellësi" NP "Pastërtia dhe Gjelbërimi", NP "Tregu"" dhe NP "Parkimi i Kumanovës" Kumanovë.

NP-të e reviduara nuk marrin masa në kohë për të arkëtuar kërkesat dhe nuk kryhet vlerësimi i nivelit të arkëtimit për shkak të vlerësimit të duhur të tyre në pozicionet e bilancit në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Problemet janë të pranishme në pjesën e regjistrimit të fondeve dhe detyrimeve, gjendja që është aktuale me vite dhe nuk lejon harmonizimin midis evidentimit të kontabilitetit dhe gjendjes faktike (është kryer regjistrimi i tokës, mjeteve materiale në përgatitje, mosverifikimi i realitetit të shumave të kërkesave të paraqitura dhe detyrimeve në bazë të dokumentacionit të jashtëm dhe të brendshëm).

Janë konstatuar dobësi edhe te procedurat e PP-së në pjesën e: specifikimit teknik, sasive të nevojshme të prokurimit, prokurimit të mjeteve pa kryer analiza të nevojave reale, realizimit të marrëveshjeve, afateve të përcaktuara ligjërisht dhe procedurave të pazbatuara për PP-në.

Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi janë theksuar gjendjet që kanë të bëjnë me sistemin e pavendosur të selektimit të hedhurinave të krijuara në nivelin e komunave si një nga parakushtet për zvogëlimin e sasisë së tyre, a në funksion të mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Me NP-të, për një periudhë të gjatë kohore udhëheqen nga u.d. drejtorë të emëruar me Aktvendim nga ana kryetarit të komunës në mënyrë të njëpasnjëshme në gjashtë muaj.

Puna e NP-së përcillet me rënie të likuiditet dhe solvencë të zvogëluar të cilët kanë ndikim në të gjitha proceset, duke shprehur detyrime ndaj furnizuesit dhe pamundësinë për t'i shlyer ato në kohën e duhur.

Me vendim të Qeverisë së RMV-së, është përcaktuar mënyra e punës dhe veprimit me lokacionet e përhershme për menjanimin e hedhurinave dhe përcaktimin e lokacioneve kohore për menjanimin e hedhurinave deri në periudhën e ndërtimit të deponisë rajonale për rajonin lindor dhe verilindor.

Është e nevojshme të intensifikohen aktivitetet rreth vendosjes së sistemit të integruar për menaxhimin me hedhurinat në rajonet lindore dhe verilindore, që përfshin ndërtimin e kapaciteteve qendrore dhe lokale për menaxhimin me hedhurinat, si dhe të deponive rajonale, ndërsa në drejtim të përmirësimit të gjendjeve në mjedisin jetësor dhe menaxhimit të organizuar me hedhurinat në përputhje me standardet nacionale dhe të BE-së.



## 5.12.2. NP “STREZHEVO” MANASTIR

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2020 të NP “Strezhevo” Manastir, e themeluar nga Qeveria e RMV-së, gjatë së cilës janë konstatuar gjendjet kryesore si në vijim:

- janë konstatuar dobësi në mekanizmat e kontrollit mbi monitorimin e parcelave bujqësore të raportuara për ujitje, ndërsa me këtë edhe në tërësinë e të ardhurave të realizuara nga arkëtimi i kompensimit për ujitje. Mundësia e kufizuar për kontroll mbi ujitjen e sipërfaqeve nga NP “Strezhevo” Manastir është për shkak të: infrastrukturës komplekse të sistemit - rrjetit për ujitje. Ky rrjet është shtrirë në gjatësi prej 534 km mbi të cilin janë vendosur rreth 4000 hidrantë për ujë, të cilët nuk kontrollohen automatikisht, por me dorë nga pronarët e tokës bujqësore. Numri i punonjësve të ngarkuar me kontrollin e sistemit të ujitjes është i pamjaftueshëm. Dobësi janë konstatuar edhe në mekanizmat e kontrollit për monitorimin e sasisë së ujit të shpërndarë për nevojat industriale.
- për disa nga objektet që janë pjesë përbërëse e rrjetit - sistemit të ujitjes, pronësia e pronës nuk është e rregulluar, ndërsa në lidhje me regjistrimin e kryer të objekteve dhe mjeteve është konstatuar se nuk është kryer regjistrimi i plotë;
- në periudhën prej vitit 2001 deri në vitin 2020, NP “Strezhevo” Manastir në vazhdimësi thekson humbje nga punët e rregullta, e cila mbulohet me kapital (kryegjë bazë), për shkak të së cilës në fund të vitit 2020 i njëjti është zvogëluar për 79% që nga fillimi i saj. Nga dokumentacioni i pranuar është konstatuar se ka mosharmonizim të të dhënave për investimin themelues të paraqitur në evidencën e kontabilitetit të NP-së me të dhënat nga Regjistri Qendror i RMV-së.

- mungon akti për llogaritjen e pagave të punëtorëve, dhe ekziston zbatimi joadekuat i rregullave ligjore me të cilat rregullohet mënyra e llogaritjes dhe pagesës së pagave dhe shtesave, që ndikon në saktësinë e llogaritjes dhe shumën e pagave të paguara për punonjësit;
- në pjesën e dokumentacionit përcjellës është konstatuar se mungojnë: të dhënat për masat e ndërmarra për arkëtimin e kërkesave kontestuese dhe të dyshimta, si dhe marrëveshjet e lidhura për donacione të pranuara në materiale dhe pajisje;
- te evidenca materiale e rezervave është konstatuar zbatimi i parregullt i politikës së kontabilitetit për vlerësimin e rezervave me çmime mesatare gjatë emetimit të tyre;
- nuk është përdorur dokumentacioni i projektit për riparimin e ndryshimeve erozive të tokës rreth kanalit kryesor të furnizimit, i prokuruar në vitet 2014 dhe 2015.

Me revizionin e kryer janë konstatuar edhe dobësi të caktuara sistematike.

Në pjesën "Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi"- është dhënë rishikim edhe i rezultateve të arritura nga puna financiare e NP "Strezhevo" Manastir në 10 vitet e fundit, për të cilat në vazhdimësi paraqet humbje.

## Rezultatet financiare nga puna e rregullt me dhe pa amortizim të shprehur në 000 denarë




Nëpërmjet paraqitjes grafike figurativisht është paraqitur ndikimi i shumës së amortizimit të llogaritur në rezultatin financiar të punës. Nëse në shpenzimet totale nuk i marrin parasysh shpenzimet në bazë të amortizimit të llogaritur, NP shfaqë rezultat financiar pozitiv - fitim. Gjendja në lidhje me rezultatin e paraqitur nga puna edhe më tej do të mbetet e pandryshuar, megjithëse ndërmarrja është likuide dhe i shlyen rregullisht detyrimet e saj.

Me qëllim që të ndodhin ndryshime që do të ndikonin në uljen e humbjes, është e nevojshme që në rregullativën ligjore, gjatë përcaktimit të bazës për kompensim të ujitjes, të përfshihen edhe shpenzimet për amortizim.

# 5.13. PUNË DHE SOCIALE

## 5.13.1. FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (FSPIMV) për vitin 2020, gjatë së cilës janë konstatuar këto gjendje:

- mungesa e ndarjes së plotë të kompetencave dhe përgjegjësive në procesin e pagesës, procedura të cilat ende nuk janë përshtatur me ndryshimet në Ligjin për SPI-në, ndërsa kontrollet e brendshme të vendosura jo gjithmonë sigurojnë konfirmimin e të dhënave të futura dhe saktësinë në procedurë;
- FSPIMV-ja ballafaqohet me mungesë të kapaciteteve të nevojshme të stafit në fushën e kuadrit profesional dhe të trajnuar për aktuari, për çka mungojnë realizimet e aktiviteteve për përgatitjen e analizës aktuariale të gjendjes në sistemin pensional, daljet permanente të punonjësve nga Sektori i TI-së, ndërsa revizioni i brendshëm punon pa përcaktimin minimal ligjor të kuadrit të nevojshëm;
- dobësitë në ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave në evidentimin amë pamundësojnë verifikimin e besueshmërisë dhe plotësinë e të dhënave të regjistruara, të nevojshme për realizimin e të drejtave nga SPI-ja;
- për shkak të mungesës së të dhënave përkatëse për punësimin dhe regjistrimin e obliguesve, si dhe gabimeve gjatë regjistrimit nga ana e institucioneve tjera, në llogarinë e pagesave të dedikuara për mbledhjen e mjeteve nga kontributi i arkëtuar për SPI-në ka mjete të paalokuara të cilat FSPIMV-ja nuk mund t'i shfrytëzojë, ndërsa të siguruarit nuk mund t'i ushtrojnë të drejtat e SPI-së;
- mekanizma të pamjaftueshëm për arkëtimin e detyrueshëm të dëmeve të përcaktuara për shkak të pagesës së pabazuar të pensioneve për të cilat janë regjistruar kërkesa nga qytetarët dhe përqindja e ulët e kthimit të mjeteve të paguara më shumë;
- është kryer evidentimi i tokës dhe objekteve ndërtimore në librat afaristë të FSPIMV-së për të cilat nuk ekziston dokument i besueshëm dhe për të njëjtit nuk është përcaktuar e drejta e pronësisë në Kadastrën e Patundshmërisë, etj.

Në pjesën Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi është zbuluar:

- struktura dhe niveli i të ardhurave të realizuara në periudhën raportuese, gjegjësisht rritja e të ardhurave nga kontributi i arkëtuar për SPI-në në vitin 2020 për 10.5% në krahasim me vitin e kaluar 2019 e cila nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për përfitime sociale (pagesa e të ardhurave nga pensionet së bashku me kontributin për sigurimin shëndetësor të pensionistëve, transfertat në shtyllën e dytë pensionale dhe pensionin invalidor) të cilat po ashtu rriten nga viti në vit, ndërsa në vitin 2020 kap shumën prej 76.795.935 mijë denarë, për gjithsej 326.295 shfrytëzues të të ardhurave, për të cilat përfundimisht me pagesat e muajit dhjetor janë për 5.6% më të larta në krahasim me vitin 2019.




- FSPIMV-ja edhe përkundër rritjes së të ardhurave në bazë të kontributeve nga SPI-ja ka mungesë (deficit) të mjeteve për pagesën e shpenzimeve për përfitime sociale, për shkak të të cilit në vitin 2020 janë transferuar mjete nga Buxheti i RMV-së në vlerë prej 29.855.353 mijë denarë. Ka trend të rritjes së deficitit në pagesën e të ardhurave pensionale, me përjashtim të dy viteve të fundit kur pjesëmarrja e këtyre fondeve në totalin e të ardhurave ishte 37% në vitin 2019, mirëpo në vitin 2020 është rritur në 38.4%, nga të cilat për mbulimin e deficitit për pagesën e pensioneve është 28.7%.



- Zgjidhjet ligjore ekzistuese që nuk parashikojnë pjesëmarrjen aktive të FSPIMV-së në krijimin e politikave në sistemin pensional, ndërsa FSPIMV-ja nuk mund të ndikojë ndjeshëm në rritjen e të ardhurave nga burimi, si dhe pasiguritë që lidhen me lëvizjet inflacioniste dhe lëvizjet e pafavorshme demografike të cilat kanë ndikim për punën e FSPIMV-së;
- sistemi i vendosur për përcaktimin, kontrollin dhe arkëtimin e kontributeve që nuk bazohet në integrimin e plotë të përditësuar dhe të saktë dhe shkëmbimin në kohë të të dhënave nga institucionet, që ndikon në plotësinë e të ardhurave, si dhe në likuiditetin e FSPIMV-së dhe qëndrueshmërinë e sistemit pensional;
- tërheqje të pabazuara të mjeteve nga llogaria e FSPIMV-së nga ana e përmbaruesit në bazë të urdhrave të përmbarimit, në të cilat shfrytëzuesit e pensioneve paraqiten si debitorë, si dhe kryerja e vazhdueshme e aktiviteteve nga ana e FSPIMV-së lidhur me realizimin e urdhrave të përmbarimit.

## 5.13.2. AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT







Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë në Agjencinë për Punësim të RMV-së (APRMV) për vitin 2020, gjatë së cilës është konstatuar:

- mospërputhja e të dhënave nga modulet për evidentimet materiale të mjeteve ekzistuese, rezerva e materialeve, si dhe të dhënat për pagesat në bazë të kompensimit në para dhe masat aktive në lidhje me ato të paraqitur në evidencën e kontabilitetit dhe nevojën për vendosjen e sistemit të integruar ndërmjet sistemit elektronik për programet dhe masat aktive në Qendrat e Punësimit dhe modulit për punën financiare të APRMV-së;
- nuk vepron në përputhje me udhëzimet operative për realizimin e Planit Operativ për vitin 2020 në pjesën e kryerjes së kontrolleve dhe sigurimin e plotësisë së dokumentacionit gjatë realizimit të programeve dhe masave aktive për punësime, si dhe zbatimin e monitorimit të tij, që ndikon në efikasitetin e masave dhe përdorimin me dedikim të fondeve gjatë përfshirjes së të papunëve në program, përkatësisht masave për punësim.  Gjendjet e përcaktuara janë rezultat i mungesës së burimeve njerëzore dhe parkut të automjeteve për kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara nga APRMV-ja;
- janë ndërmarrë detyrime pa zbatuar PP-në mbi kufirin e lejuar me LPP-në, si dhe dobësi në kryerjen e regjistrimit dhe në mënyrën e veprimit dhe evidentimit të rezervave të materialeve dhe inventarit të imët dhe lëshimit të tyre;

- Marrëveshja kolektive në nivel të punëdhënësit nuk është harmonizuar me rregullativën e vlefshme dhe nuk është dorëzuar propozimi në Qeverinë e RMV-së për përcaktimin e vlerës së pikës për llogaritjen e pagave të ofruesve të shërbimeve publike dhe personit ndihmës teknik, si dhe nuk ka marrëveshje të lidhur menaxheriale ndërmjet drejtorit / zëvendësdrejtorit të APRMV-së dhe Qeverisë së RMV-së në përputhje me ndryshimet në Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë;
- ekipimi i pamjaftueshëm në Sektorin për Revizion të Brendshëm dhe realizimi jo i plotë i revizioneve të planifikuara në planin vjetor të punës së revizionit të brendshëm;
- në fund të vitit 2020, nga ana e APRMV-së nuk është bërë harmonizimi i të ardhurave të realizuara nga kontributi i punësimit, i cili merr pjesë me 74% në totalin e të ardhurave të APRMV-së në vitin 2020, me të dhënat nga evidencat e DAP-it, për shkak të të cilave nuk ka mundësi për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e të ardhurave të realizuara.

Është kryer zbardhja e gjendjeve të caktuara të cilat ndikojnë në vazhdimësinë e agjencisë, ndërsa i referohen: numrit të personave të papunë shfrytëzues të kompensimit në para dhe efekti i ndërmjetësimit të APRMV-së e këtyre shfrytëzuesve, të cilët na tregojnë se numri është i vogël i punësimit të personave të cilat janë shfrytëzues të kompensimit në para edhe përkundër angazhimit të APRMV-së dhe pjesëmarrjes së saj gjatë ndërmjetësimit.

- nuk është respektuar dispozita e Ligjit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në pajtim me të cilin nga Buxheti i RMV-së duhet të paguhen mjete në para në llogarinë e fondit të veçantë, në bazë të TVSH-së dhe detyrimeve doganore të paguara nga ana e shoqërive mbrojtëse me çka APRMV-ja nuk i siguron plotësisht mjetet financiare që i detyrohen ligjërisht për përmirësimin e kushteve për punësime dhe të punës së personave me aftësi të kufizuara;
- gjendja për numrin e lëndëve dhe shuma e borxhit kryesor në procedurat para gjykatave kompetente në të cilat APRMV-ja paraqitet si paditëse ose ana e paditur, që në periudhat e ardhshme do të ndikojë në raportet financiare dhe në punën e APRMV-së.

**Efektet e ndërmjetësimit për punësimin e shfrytëzuesve të kompensimit me para**



### 5.13.3. INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS

Është kryer revizioni i raporteve financiare të Inspektoratit Shtetëror të Punës (ISHP) në llogaritë e buxhetit themelor për vitin 2020 së bashku me revizionin e pajtueshmërisë gjatë së cilës është konstatuar:

- mungesa e procedurave të shkruara për sistemin e kontrolleve të brendshme në procesin e prokurimeve dhe pagesave;
- dokumentet financiare kontrollohen nga një person i punësuar me kontratë në vepër të cilit në të njëjtën kohë i caktohen kompetencat për zbatimin e procedurave për PP-në;
- marrëveshjet e lidhura të punës që nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore;
- moskompletimi i Sektorit për Revizion të Brendshëm dhe marrëveshjet e parealizuara për kryerjen e revizionit të Ministrisë së Drejtësisë;
- evidentimi i kontabilitetit të materialeve të sapopërvetësuara ose të marra në mënyrë tjetër është zbatuar në kohë dhe në mënyrë kronologjike;
- dobësi në kryerjen e regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve, gjegjësisht ato në tërësi nuk janë kryer në përputhje me rregullativën ligjore dhe
- mosvendosja e evidencës së kontabilitetit për materialet e prokuruara dhe të lëshuara, etj.

Në pjesën e procedurave për PP-në është konstatuar se:

- për një pjesë nga prokurimet nuk është zbatuar procedurë për PP-në dhe në mënyrë jo të plotë janë zbatuar dispozitat e LPP-së, gjatë së cilës janë ndërmarrë detyrime që paraqesin tejkalim të kufirit të vlerës së përcaktuar me ligj dhe
- dobësi gjatë përgatitjes së dokumentacionit të tenderit dhe realizimin e marrëveshjeve për PP-në që nuk siguron të dhëna për shërbimet e kryera reale dhe ndikimi në mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve.

Plani Vjetor i Punës së ISHP-së për vitin 2020 është përgatitur para se të miratohet Metodologjija për vlerësimin e rrezikut, si dhe një pjesë e mbikëqyrjeve të jashtëzakonshme nuk kryhen në afatin e paraparë me ligj dhe janë lëndët jo tërësisht të kompletuar pas kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

Është bërë analizë e mbikëqyrjeve inspektuese të kryera sipas llojeve në periudhën 2018 - 2020 gjatë së cilës është konstatuar se mbikëqyrjet e jashtëzakonshme kanë trend të rritjes për shkak të rritjes së numrit të kërkesave në kohën e pandemisë KOVID-19, si rezultat i së cilës u reduktua mbikëqyrja e rregullt e inspektimeve.

#### NUMRI I KRYER I MBIKQYRJEVE INSPEKTUESE



Në lidhje me çështjet që ndikojnë në pasigurinë dhe vazhdimësinë e punës së ISHP-së, ndër të tjera, është zbardhur projekti për modernizimin e shërbimeve të inspektimit i cili zbatohet nga MSHIA, për softuerin elektronik të zhvilluar "E-inspector" përmes të cilit kryhen mbikëqyrjet dhe kontrollet e inspektimit dhe angazhimet e punonjësve nga ISHP-ja për kryerjen e detyrave të punës si "CallCenter", të cilat në periudhën paraprake janë kryer nga kompania e përzgjedhur në bazë të marrëveshjes pas procedurës së zhvilluar për PP-në.

## 5.14. ARSIMI

### 5.14.1. ARSIMI I LARTË

Është kryer revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë është realizuar në tre institucione (fakultete) të arsimit të lartë në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi", si: Fakulteti i Arteve Dramatike - Shkup, Fakulteti i Dizajnit dhe Teknologjive të Mobilieve dhe Enterierit - Shkup dhe Fakulteti i Mjekësisë Veterinare - Shkup.

Me revizionet e kryera në fakultetet e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" janë përcaktuar gjendjet në sistemin e kontrolleve të brendshme në procesin e pagesës pa miratuar procedura me shkrim për konfirmimin e vërtetësisë dhe objektivitetit të dokumentacionit financiar dhe kompetencave dhe përgjegjësive të padefinuara të personave të përfshirë në proces.

Përcaktimi dhe arkëtimi i të ardhurave të realizuara në baza të ndryshme në kuadër të veprimtarisë së arsimit të lartë realizohet pa procedurë të miratuar. Kjo gjendje është karakteristike për Fakultetin e Arteve Dramatike dhe Fakultetin e Dizajnit dhe Teknologjive të Mobilieve dhe Enterierit.

Gjithashtu janë konstatuar edhe parregullsi në mënyrën e pagesës së kompensimeve për kryerjen e aktiviteteve shtesë që nuk janë pjesë e obligimeve të rregullta të punës. Regjistrimi i një pjese të mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve nuk është kryer plotësisht dhe në mënyrë korrekte dhe janë konstatuar dobësi në zbatimin e LPP-së te disa nga procedurat e zhvilluara për PP-në.

Te Fakulteti i Arteve Dramatike janë përcaktuar gjendje të cilat kanë të bëjnë me mospajtueshmërinë e akteve të brendshme për llogaritjen dhe pagesën e pagave dhe të dhënave në evidencat e kontabilitetit me raportet financiare për vitin 2020. Nuk është përcaktuar e drejta për shfrytëzim të përhershëm të tokës dhe objekteve

ndërtimore dhe nuk është siguruar evidentimi në kohë dhe kronologjik i faturave të pranuara.

Nuk është futur evidenca analitike për llogaritjen dhe arkëtimin e të ardhurave të realizuara në baza të ndryshme nga kryerja e veprimtarisë së arsimit të lartë.

Janë përcaktuar gjendje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e pazgjidhura pronësore dhe juridike të Fakultetit të Dizajnit dhe Teknologjive të Mobilieve dhe Enterierit me Fakultetin e Pylltarisë dhe konfirmimin e pronësisë së objekteve ndërtimore ku fakulteti kryen veprimtari dhe evidentim jo të plotë të objekteve ndërtimore, pajisjeve dhe librave në bibliotekë.

Nuk është vendosur evidenca analitike për llogaritjen dhe arkëtimin e të ardhurave nga studentët në ciklin e parë, të dytë ose të tretë të studimeve, si dhe përdorimi jo i plotë i sistemit elektronik i-know për arkëtimin e të ardhurave të ciklit të dytë dhe të tretë dhe arkëtimi në baza të ndryshme nga kryerja e veprimtarisë së arsimit të lartë.

Te Fakulteti i Mjekësisë Veterinare janë përcaktuar gjendje që kanë të bëjnë me dobësitë në kontrollet e brendshme në pjesën e pranimit dhe konfirmimit të dokumentacionit financiar si dhe përgatitjes së faturave për shërbimet e kryera nga fakulteti dhe mospajtueshmëria në pjesën e akteve për pagesën e pagave të stafit në fakultet.

Në kuadër të raporteve të revizorëve është kryer zbardhja e gjendjeve të caktuara që mund të ndikojnë në vazhdimësinë e fakulteteve.

## 5.15. KULTURA

### 5.15.1. INSTITUCIONET NACIONALE NË FUSHËN E KULTURËS

Është kryer revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë në dy institucione nacionale (IN) në fushën e kulturës, si: Opera dhe Baleti Nacional dhe Filarmonia e RMV-së.

Veprimtaria themelore e këtyre IN-ve është artet performuese për arritjen e interesit nacional në fushën e kulturës.

Me revizionin e kryer janë konstatuar gjendje të caktuara që janë të përbashkëta te të dy IN-të:

- mungesa e akteve dhe procedurave të brendshme për rrjedhjen e dokumentacionit, si dhe për procese dhe aktivitete të rëndësishme për pagesat pa para në dorë dhe me para në dorë, llogaritjen dhe pagesën e pagave dhe realizimin dhe evidentimin e të ardhurave, me kompetencat dhe përgjegjësitë e definuara të personave në proceset;
- mangësitë në dokumentacionin mbështetës gjatë njohjes së pjesës së shpenzimeve të evidentuara dhe pagesave të kompensimeve për përdorimin e instrumenteve të veta për punonjësit dhe materialet shpenzuese pa të drejtën e bazës adekuate;
- dobësitë në pjesën e zbatimit të regjistrimit të mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve;
- janë përcaktuar dobësi te disa nga procedurat e zbatuara për PP-në dhe realizimin e kontratave për PP-në;
- dobësi në pjesën e mënyrës së ndarjes së biletave falas për shfaqjet nga aktivitetet programore të institucioneve, që përbën përqindje të konsiderueshme nga totali i biletave të shitura, për të cilën nuk është përgatitur akt i brendshëm që do të përcaktojë kushtet dhe kriteret për ndarjen e tyre.

Në pjesën e theksimit të çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë së IN Opera dhe Baleti Nacional, është kryer zbardhja për pagesën jo në kohë të detyrimeve ndaj furnitorëve, të cilat u rritën ndjeshëm në vitet 2013, 2014 dhe 2016, si dhe fillimin e procedurave gjyqësore nga ana e furnitorëve, arkëtimin e detyruar dhe bllokimin e llogarive të IN-së. Në kushte të tilla, vihet në pyetje pagesa e detyrimeve aktuale të IN-së dhe shfrytëzimi i mjeteve të miratuara nga Programi Vjetor i Punës së institucionit në përputhje me dedikimin.

## Gjendja e detyrimeve të papaguara (2011-2020)



Gjendja me detyrimet e papaguara në vitin 2016 është dukshëm më e lartë në krahasim me vitet e tjera për shkak të angazhimeve të ndërmarra në bazë të rinovimit të sallonit të IN-së, për të cilin është lidhur marrëveshje për financim me Ministrinë e Kulturës e cila nuk përmban dispozita të qarta dhe të sakta në lidhje me shumën dhe dinamikën e transferimit të mjeteve për financim.

Në pjesën për çështje të tjera, janë theksuar gjendje të caktuara për shkak të rëndësisë dhe ndikimit të tyre në punën e IN-së, si dhe realizimin e prioriteteve strategjike në kulturë.

## 5.16. VETËQEVERISJA LOKALE

### 5.16.1. NJËSITËE VETËQEVERISJES LOKALE

Është kryer revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2020 në NJVL: Kumanovë, Studeniçan, Aerodrom dhe Probishtip, gjatë së cilës janë konstatuar gjendjet si vijojnë:

Te komunat e reviduara ekziston struktura joadekuate organizative e revizionit të brendshëm dhe mosfunksionaliteti i tij, ndërsa në Komunën e Studeniçanit mungon sistemi i kontrollit të rregullt të brendshëm financiar.

Në komunat: Studeniçan, Aerodrom dhe Probishtip janë përcaktuar dobësi në procesin e buxhetimit dhe prezent është shfaqja e devijimit të konsiderueshëm ndërmjet të të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara edhe përkundër miratimit të rebalancit të buxhetit.

Në Komunën e Aerodromit prej 47.26% ka devijim të konsiderueshëm të shpenzimeve të planifikuara, Komuna e Probishtipit ka realizuar rreth gjysmën e buxhetit të planifikuar.

Komuna e Studeniçanit me rebalancë në vend që të harmonizojë projeksionet e planifikuara, përkatësisht t'i zvogëlojë ato, në përputhje me dinamikën e realizimit, buxheti është rritur për 20.86%. Komuna në fund të vitit 2020 shfaq borxhe të larta, me detyrime që janë 9% më të larta se të ardhurat e realizuara në buxhetin e vitit 2020.

NP-të në mënyrë të parregullt i kanë paguar kompensimet, gjegjësisht nuk i paguajnë në llogarinë e buxhetit të komunës. Në buxhetin e Komunës së Kumanovës në bazë të kompensimeve për pastërti publike janë paguar më pak mjete në vlerë prej 14.490 mijë denarë, ndërsa Komuna e Studeniçanit nuk realizon të ardhura në këtë bazë. Në anën tjetër, Komuna e Aerodromit nuk realizon të ardhura nga taksat komunale për shfrytëzimin e hapësirës për parkim të automjeteve në territorin e komunës, sepse parkingjet ekonimizohen nga NP-ja e Qytetit të Shkupit.

Komunat e reviduara nuk i respektojnë afatet e përcaktuara me ligj gjatë kryerjes së procedurave për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje që sjell njoftimin e parakohshëm të kërkuesve për plotësimin e dokumentacionit, prolongimi i procedurave dhe pamundësia e pronarëve për regjistrimin e pronës në kohë në Agjencinë e Kadastrës së Patundshmërive.

Me analizën e bërë të kërkesave për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje në komunat e reviduara është konstatuar se 67% janë zgjidhur dhe 33% janë ende në procedurë.

## Kërkesë për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuar pa leje




Komunat nuk dorëzojnë raporte vjetore në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve për shfrytëzimin e mjeteve të realizuara nga kompensimi në këtë bazë, dhe të cilat duhet të përdoren me qëllim për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik me të cilën kryhet mbulimi i objekteve pa leje dhe për rregullimin infrastrukturor të hapësirës në të cilën ndodhen ato.

Janë konstatuar parregullsi edhe në mënyrën e evidentimit të kërkesave, përcaktimin e vjetërsisë së strukturës së tyre, ndërsa për kërkesat tatimore që nuk janë arkëtuar në afatin e paraparë nuk është llogaritur dhe arkëtuar interesi dhe nuk merren masa për arkëtimin e tyre. Gjithashtu, në Komunën e Studeniçanit dhe Komunën e Probishtipit nuk mbahen evidenca për kërkesat në bazë të tarifës për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje.

Në Komunën e Aerodromit janë konstatuar raste të mostransparencës dhe mospajtueshmërisë ligjore në zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të lokaleve afariste, pajisjeve urbane dhe objekteve sportive si në vijim: procedura pa tender publik, kontrata të pacaktuara dhe kontrata pa kompensim, që ndikon në të ardhurat e realizuara të komunës në këtë bazë.

Në komunat e Kumanovës, Aerodromit dhe Studeniçanit janë konstatuar raste të mosrespektimit të dispozitave të Ligjit për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet dhe Ligjit për sport. Prezent është dukurija e zgjedhjes së projekteve dhe shumës së mjeteve të ndara të shoqërisë, shoqatave dhe klubeve sportive të realizohet pa kriter.

Komuna e Kumanovës nuk ka mbikëqyrur punën e partnerit privat, për të vlerësuar shkallën e realizimit të synimeve të përcaktuara nga PPP-ja, në lidhje me optimizimin e sistemit për ndriçimin publik, përmirësimin e efikasitetit në dhënien e shërbimeve për qytetarët dhe reduktimin e shpenzimeve.

Në Komunën e Studeniçanit janë konstatuar parregullsi gjatë llogaritjes dhe pagesës së tarifave mujore për anëtarët e Këshillit për pjesëmarrje në mbledhje.

Gjatë kryerjes së punëve për ndërtim/rikonstruim të rrugëve urbane dhe ndërurbane, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit nuk respektohen dispozitat e Ligjit për ndërtim,

lidhur me miratimin e marrë për ndërtim/rikonstruim para fillimit të punimeve (Komuna e Studeniçanit dhe Komuna e Probishtipit), mungon inspektimi teknik nga inxhinieri mbikëqyrës dhe miratimi për shfrytëzim për objektet e ndërtuara në Komunën e Studeniçanit, si dhe specifikimi/ inspektimi teknik për aktivitetet ndërtimore të kryera nga Komuna e Probishtipit janë bërë nga punëtorët në administratën komunale të cilët nuk i plotësojnë kërkesat ligjore për projektim.

Në komunat e reviduara prezent janë problemet në pjesën e regjistrimit të pronave dhe detyrimeve, gjendja e cila është aktuale prej vitesh dhe nuk mundëson harmonizimin e gjendjes së mjeteve dhe detyrimeve ndërmjet evidencës së kontabilitetit dhe gjendjes faktike të përcaktuar me regjistrim. Prona e cila është në pronësi të komunave nuk është e evidentuar plotësisht në librat afaristë.

Dobësi në procedurat për PP-në janë përcaktuar te Komunat e Kumanovës, Studeniçanit dhe Aerodromit në pjesën e: përcaktimit të vlerës së parashikuar të prokurimit, kushteve për përzgjedhjen cilësore të operatorëve ekonomikë dhe elementeve të kontratës (Komuna e Kumanovës), mosrespektimit të afateve të përcaktuara me ligj dhe moszbatimit të procedurave për PP-në (Komuna e Aerodromit), ndërsa Komuna e Studeniçanit ka lidhur marrëveshje kornizë edhe përkundër vendimit të miratuar për anulimin e procedurës për PP-në e çështjeve nga Komisioni Shtetëror për Ankesa për Prokurime Publike.

Në pjesën e Theksimit të çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë janë theksuar gjendje të cilat i referohen Komunës së Kumanovës, e cila kërkesë 170.786 mijë denarë nga NP "Ujësjellësi" Kumanovë në bazë të borxhit të riprogramuar të shlyer, nga huamarrja e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit MEAP, për prokurimin e pajisjeve dhe kryerjen e punimeve për modernizimin e sistemit të ujësjellësit dhe ujërave të zeza. Komuna e Probishtipit ka borxh prej 2,686 mijë denarë, si rezultat i pagesës jo në kohë të anuiteteve të vonuara pas marrjes së huas nga Buxheti i RMV-së.

Në drejtim të zgjidhjes së problemit shumëvjeçar me mungesën e hapësirës së saj për kryerjen e aktiviteteve, Komuna e Aerodromit ka ndërmarrë aktivitete në kuadër të Planit të programeve për zhvillim të Komunës së Aerodromit për periudhën 2021-2023, në të cilën janë paraparë mjete prej 165.000 mijë denarë për ndërtimin e objektit administrativ i cili nëse nuk realizohet me dinamikën e përcaktuar do të ndikonte në shpenzimet e ardhshme të komunës në këtë bazë.

Në pajtim me Ligjin për plotësimin e Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, me vendime të Këshillit të Komunës së Kumanovës, nga llogaria e të ardhurave të buxhetit të dotacioneve (930) është kryer transferimi i tepricës së mjeteve në shumë prej 43.000 mijë denarë në llogarinë e buxhetit themelor (630). Mjetet janë të dedikuara për ndërtimin dhe rikonstruimin e mini këndeve të lojërave për fëmijë dhe shkolla, sanimin dhe rikonstrukcionimin e nyjeve sanitare, tualeteve dhe konstruksioneve të çatisë dhe prokurimi i pajisjeve digjitale dhe mjeteve teknike ndihmëse për mësimin në kabinate.

Komunat tjera, edhe pse kanë mjete të papërdorura në llogarinë e të ardhurave nga buxheti i dotacioneve (930) më 31.12.2020, nuk është kryer transferimi i këtyre mjeteve te llogaria e buxhetit themelor, për shkak të detyrimeve të papaguara në fund të vitit përdoruesve të bllok dotacioneve.

# 5.17. PARTITË POLITIKE DHE FUSHATAT ZGJEDHORE

## 5.17.1. PARTITË POLITIKE - PUNA E RREGULLT

ESHR-ja është organ kompetent për monitorimin e financimit të rregullt të partive politike (PP), përmes sistemit të raportimit financiar, në përputhje me metodologjinë për revizion shtetëror të përcaktuar me Ligjin për revizionin shtetëror. Financimi i punës së PP-së është parakusht për sistemin politik demokratik në vend.

Me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2021, janë planifikuar dhe kryer revizionet e raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së tetë PP-ke: VMRO-DPMNE, LSDM, BDI, Lëvizja BESA, PDSH, GROM, DNET dhe Aleanca për Shqiptarët, me të cilat janë përfshirë 79% nga burimet e përgjithshme publike të financimit të PP-së në vitin 2020.

Me revizionet e kryera janë përcaktuar gjendjet për të cilat organet kompetente të PP-së është e nevojshme të ndërmarrin veprime për tejkalimin e tyre, veçanërisht në pjesën e zbatimit të regjistrimit në pajtim me rregullativën ligjore, duke vendosur mënyrën e kërkesës, pagesës dhe evidentimit të të ardhurave në baza të anëtarësimit për konfirmimin e plotë të së njëjtës, evidenca e plotë e pronës me të cilën disponon PP-ja, financimi i fushatës zgjedhore nga llogaria për punë të rregullt me mjete nga burimet e paparashikuara për financimin e fushatës zgjedhore, mossigurimi i plotë i dokumentacionit mbështetës për një pjesë të faturave për shpenzimet e kryera, zbatimi i vlerësimit të pozitave individuale të bilancit të përfshirë në librin kryesor nuk zbatohen sipas parimit të kontabilitetit të shfaqjes së modifikuar të ndryshimeve afariste/ transaksioneve, si dhe mossigurimi i dokumentacioneve të besueshme dhe të rregullta për disponim me mjetet me para të gatshme.

Në pjesën e Theksimit të çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë janë zbuluar gjendjet të cilat u referohen detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve të cilët datojnë nga vitet e kaluara dhe për strukturën e burimeve të financimit nga aspekti i pjesëmarrjes së burimeve të financimit privat dhe publik.

### Të hyrat e realizuara të partive politike nga ANËTARËSIA, DONACIONET DHE NGA BUXHETI I RMV



Pjesëmarrja e llojeve individuale të të ardhurave sipas viteve dhe sipas PP-së është paraqitur në grafikën.

Me analizat e të ardhurave totale sipas llojeve të burimeve të financimit, është konstatuar se pjesëmarrja e financimit publik nga Buxheti i RMV-së në punën e rregullt të PP-së shënon trend të zvogëlimit në vitin 2020 që është për 37% më pak se në vitin 2019, që vjen si pasojë e zvogëlimit të përqindjes për financimin vjetor të PP-së, si dhe zvogëlimit të të ardhurave totale burimore të Buxhetit të RMV-së si pasojë e ndikimit të krizës shëndetësore-ekonomike të shkaktuar nga virusi KOVID-19.

Për shkak të epidemisë me KOVID - 19, në qershor 2020 me Rregulloren me fuqi ligjore për financimin e partive politike[13] përqindja prej 0,15% nga të ardhurat burimore të Buxhetit të RMV-së është zvogëluar në 0,04%, që për në dhjetor 2020 me Ligjin për ndryshimin e Ligjit për financimin e partive politike[14], përqindja për financimin e PP-së për vitet 2020 dhe 2021 është përcaktuar në vlerë prej 0,105% të të ardhurave burimore të Buxhetit të RMV-së.

Gjithashtu, me revizionet e kryera vazhdimisht theksohen dobësitë sistematike në rregullativën ligjore dhe nevojën për tejkalimin e tyre, për të cilat janë dhënë informacione të detajuara nga ky raport në pjesën Dobësitë Sistematike.

## 5.17.2. PARTITË POLITIKE - FUSHATA ZGJEDHORE

ESHR-ja në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor kryen revizionin e raportit të plotë financiar për fushatën zgjedhore.

Në pajtim me Programin Vjetor të Punës për vitin 2021, janë kryer revizione të raporteve financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të shtatë pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme lokale për zgjedhjen e kryetarit të Komunës së Shtipit dhe Komunës së Plasnicës 2020.

Me revizionet e kryera te pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, janë përcaktuar gjendjet të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor, të cilat i referohen:

- pjesës së raporteve të zbatuara me ligj për të ardhurat dhe shpenzimet në fushatën zgjedhore që nuk janë dorëzuar në të gjitha institucionet kompetente;
- zbatimit jokonsekuent të afateve për dorëzimin e raporteve për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në procesin zgjedhor;
- raporteve financiare për fushatën zgjedhore që nuk përgatiten në përputhje me formularët e përcaktuar me ligj dhe
- në raportin e plotë financiar nuk janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet për reklama politike të paguara në bazë të marrëveshjeve për asignim, të paguara nga ana e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe se kryerja e qarkullimit pagesor me asignim nuk janë realizuar përmes llogarisë së transaksionit të pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore.

Fushata zgjedhore mund të financohet me mjetet e llogarisë së rregullt të PP-së, anëtarësimit në PP, donacionet e PP-së, donacionet nga personat fizikë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë, personat juridikë në shumë prej 30.000 euro në kundërvlerë me denarë dhe kreditë e PP-së të dedikuara për fushatën zgjedhore. Për përmbushjen e detyrimeve ligjore të radiodifuzerëve, mediave të shkruara dhe mediave elektronike (portaleve) në pjesën e publikimit të reklamave politike me pagesë, në procesin zgjedhor mjetet financiare

13 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 166/20.

14 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 294/20.

sigurohen nga Buxheti i RMV-së, ndërsa paguhen nga ana e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Nga analiza e kryer e burimeve totale të financimit të fushatës zgjedhore, është konstatuar se ajo është financuar në vlerë të përgjithshme prej 5,813 mijë denarë, ndërsa struktura e burimeve të financimit veçmas nga pjesëmarrësit është paraqitur në pasqyrën e mëposhtme.

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME LOKALE
PLLASNICË - SHTIP - VITI 2020

| Partia politike | LUKT | BRMP | INTEGRA | E ARDHMJA NE DUART TONA | Trajço Mitev | BDI | LSDM |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Donacionet nga personat fizik dhe juridik | 25 | 0 | 255 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| mjete të transferuara nga llogaria e transakisionit të rregullt te PP të llogarisë së transaksionit për fushatë zgjedhore | 0 | 204 | 254 | 5 | 0 | 0 | 0 |
| Publikimi i reklamave politike me pagesë me mjete financiare të siguruara nga Buxheti i RMV-së (KSHZ) | 0 | 147 | 1 | 88 | 143 | 126 | 1.720 |
| Të ardhurat nga anëtarësimi i personave fizik të paguara në llogarinë e fushatës zgjedhore | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2.652 |
| Të ardhura nga donacionet në shërbime nga personat fizik | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 14 |

Nga analiza e të ardhurave sipas llojeve të burimeve të financimit është përcaktuar se fushata zgjedhore është financuar me 57% të mjeteve të siguruara nga Buxheti i RMV-së të paguara nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, ndërsa 43% janë mjete të siguruara nga burime të tjera të financimit.

Gjithashtu, me revizionet e kryera në vazhdimësi sugjerojmë se dobësitë e caktuara sistematike të Kodit Zgjedhor, të paraqitura detajisht në pjesën "Dobësitë Sistematike" nga ky raport edhe për të cilat është e nevojshme të ndërmerren aktivitete shtesë për harmonizimin dhe tejkalimin e tyre.

# 6

DOBËSITË
**SISTEMATIKE**

**Ne, punonjësit në Entin Shtetëror të Revizionit, duke kryer kompetencat e përcaktuara me ligj dhe standardet për ISR, vlerësojmë vazhdimisht, ndër të tjera, shkallën e përputhshmërisë së ligjeve dhe akteve nënligjore dhe nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e tyre. Në këtë seksion ne nxjerrim në pah dobësitë sistematike për të cilat ekziston nevoja për të ndërmarrë veprime nga autoritetet kompetente të pushtetit ekzekutiv / legjislativ për t'i tejkaluar ato.**

| Rregullativa | Propozim për ndyshim/miratim |
|---|---|
| **Ligji për Borxhin Publik** | Saktëzimi i metodollogjisë për llogaritjen e shkalës së borxhit publik nga ana e Institucioneve kompetente në RMV (BKRMV, MF, Enti Shtetëror i Statistikës), për shkak të barazisë së të dhënave, si dhe rregullimi ligjorë i përfshirjës së të dhënave për borxhin shtetëror, si pjesë plotësuese nga llogaria përfundimtare e Buxhetit të RMV-së. |
| **Ligji për Buxhetet dhe Ligji për Buxhetin Gjyqësor** | Harmonizimi i nenit 14 të Ligjit për buxhetin gjyqësor me nenin 19 të Ligjit për Buxhetet në seksionin e periudhës kohore për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesave buxhetorë dhe qarkullimin buxhetorë. |
| **Ligji për kontabilitetin e buxhetit dhe shfrytëzuesve buxhetor,<br>Ligji për shfrytëzimin dhe dispozicion me sendet në pronësi të shtetit dhe me sendet në pronësi komunale** | Për shkak të rëndësisë së disponueshmërisë me të dhënat për pronën në nivel shtetëror, si dhe shprehjes së saj në raportet financiare, është e nevojshme që MF të shqyrtojë mundësinë për të ngrit nismën për rregullimin ligjor për mënyrën e evidentimit të pronës shtetërore dhe shprehjen e saj në raportet financiare. |
| **Ligji për kontabilitet të organizatave jofitimprurëse** | Është e nevojshme të ndërmerren aktivitete për ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore me të cilat rregullohet mënyra e udhëheqjes së kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse, me të cilat do të sigurojnë respektim të qëndrueshme të parimit të kontabilitetit të "ndodhjes së modifikuar të ndryshimeve afariste, respektivisht transaksioneve". |
| **Ligji për shfrytëzimin dhe dispozicionin me sendet në pronësi të shtetit dhe me sendet në pronësi komunale** | Sipas dispozitës së nenit 21 paragrafi (1) të Ligjit për shfrytëzimin dhe dispozicion me sendet në pronësi të shtetit dhe me sendet në pronësi komunale, sendet e patundshmëritë në pronësi të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit, Këshillit të Komunës, gjegjësisht Këshillit të Komunave të Qytetit të Shkupit dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit, me vendim mund t'ua japin në shfrytëzim përkohësisht ose përgjithmonë, me ose pa kompensim, organeve shtetërore dhe personave juridikë të themeluar nga shteti.<br>Sipas kësaj zgjidhjeje ligjore, rrjedh se kjo dispozitë e ligjit zbatohet vetëm në rastin kur sendet e paluajtshme në pronësi të komunës u jepet në përdorim të përkohshëm ose të përhershëm organeve shtetërore ose personave juridikë të themeluar nga shteti, por jo institucioneve ose personave juridikë të themeluar nga komuna.<br>Në funksion të tejkalimit të dobësinë e theksuar, mendojmë se është i nevojshëm të kryet ndryshimi dhe plotësimi i zgjidhjes ligjore për mënyrën e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm ose të përhershëm të sendeve të patundshmërive në pronësi komunale, ku do të përfshihen edhe personat juridikë të themeluar nga komuna. |

| Rregullativa | Propozim për ndyshim/miratim |
|---|---|
| **Ligji për financimin e partive politike** | Të miratojë udhëzime më specifike për rregullimin e mënyrës së pagesës, evidentimin dhe pagesën e anëtarësisë si burim i financimit të partive politike me qëllim të njëtrajtshmërisë në mënyrën e evidentimit të tyre të kontabilitetit dhe konfirmimin e limitit të përcaktuar ligjërisht për secilin anëtar veç e veç, duke pasur parasysh financimin e fushatës zgjedhore për një proces të caktuar |
| **Kodi Zgjedhor** | Të rishqyrtojë dhe qartësojë dispozitat e nenit 83 paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore me fonde nga llogaria e rregullt e partisë politike dhe nga donacionet nga një parti politike, në pjesën e limiteve individuale dhe totale të mjeteve të financuara / dhuruara nga personat fizikë dhe juridikë. |
| | Me ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Zgjedhor në vitin 2018, neni 71 u ndryshua, me çka shtoi mundësinë e depozitimit të fondeve në llogarinë e transaksionit për fushatën zgjedhore nga llogaria e partisë politike për punë të rregullta dhe nga llogaritë speciale për fondet e siguruara nga kredia, për shkak të së cilës është e nevojshme të ndryshohet dhe plotësohet neni 26 i Ligjit për financimin e partive politike, i cili do të rregullojë transferimin e fondeve nga llogaria për funksionimin e rregullt të partisë dhe nga llogaritë speciale për fondet e siguruara përmes kreditit për llogarinë e transaksionit të hapur për procesin zgjedhor. |
| | Të rregullojë mënyrën në të cilën donatorët do të dëshmojnë / konfirmojnë se ata nuk janë "persona të lidhur" të parashikuar në nenin 75, me radiodifuzer, mediat e shkruara dhe mediat elektronike (portalet e internetit) gjatë financimit ose dhënies së donacioneve për partitë politike. |
| | Rregullimi ligjorë i dispozitave të nenit 85 të Kodit Zgjedhor, në pjesën e mënyrës së veprimit për rastet kur në Raportin e Plotë Financiar tregohen fondet e tepërta të mbledhura në llogari për fushatën zgjedhore, si dhe kur ekziston mungesa e fondeve për financim dhe tregohen më shumë shpenzime se të ardhurat, d.m.th. ka detyrime të papaguara. |
| | Rregullimi i nenit 78-a në pjesën e përcaktimit të detyrimit për dorëzimin e raportit për reklamat dhe billbordet e përdorura nga komunat në RMV dhe Qytetin e Shkupit. |
| | Të ndërmerren aktivitete për rregullimin e mëtejshëm të Kodit Zgjedhor në pjesën e përcaktimit të organit kompetent për monitorimin dhe raportimin për prezantimin mediatik zgjedhor të mediave elektronike (portalet në internet). |
| | Rregullimi i mënyrës së organizimit, pagimit, monitorimit dhe raportimit tek autoritetet kompetente për prezantimin në internet të bërë nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore përmes rrjeteve sociale. |
| | Për të rishqyrtuar afatin e caktuar për pagimin e donacioneve, të përcaktuar me nenin 71 paragrafi 6, d.m.th. është e nevojshme të përcaktohet donacionet që do të paguhen jo më vonë se dita e përfundimit të fushatës zgjedhore. |

| Rregullativa | Propozim për ndyshim/miratim |
|---|---|
| **Kodi Zgjedhor** | Rregullimi i nenit 84-b, paragrafi 8 i Kodit Zgjedhor me të cilën do t'i mundësojë Ministrisë së Financave me akt nënligjor të rregullojë mënyrën e mbajtjes së librave afariste dhe përgatitjen e raportit financiar / financimet për fushatën zgjedhore, duke pasur parasysh të gjitha llojet / burimet e financimit të fushatës zgjedhore, veçanërisht kur ato jo gjithmonë shkaktojnë të hyra me para në llogarinë e transaksionit. |
| | Rregullimi i Kodit Zgjedhor, me çka në pjesën e gjobave dhe dispozitave të kundërvajtjes do të sigurojë gjoba edhe për mediat elektronike (portalet elektronike) në rast të mosparaqitjes së Raportit mbi hapësirën e reklamave të përdorura nga secili pjesëmarrës në fushatën zgjedhore dhe fondeve të cilat janë paguar dhe kërkojnë me atë qëllim. |
| | Rregullimi nomoteknik i Kodit Zgjedhor meqë disa nene nuk kanë rend dhe dispozitat e disa neneve kanë referencë të gabuar. |
| **Ligji për punë të brendshme, Ligji për pagesën e pagave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Ligji për ekzekutimin e buxhetit të RMV-së për vitin përkatës** | Harmonizimi i akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë mënyrën e llogaritjes së pagës së largimit që i paguhet punonjësit gjatë daljes në pension. Me dispozitat e nenit 9 të Ligjit për pagesën e pagave në RMV dhe nenit 14 të Ligjit për Ekzekutimin e Buxhetit të RMV-së për vitin përkatës është përcaktuar se punonjësit që dalin në pension i paguhet dyfishi i pagesës së largimit të llogaritur mbi bazën e pagës mesatare mujore neto për punonjës në Republikë të publikuar deri në ditën e pagesës. Ndërsa me dispozitat e nenit 175 të Ligjit për Punët e Brendshme është përcaktuar se punonjësi i cili ka fituar të drejtën e pensionit ka të drejtë në kompensim të njëhershëm në formë të kompensimit të largimit, në shumën prej pesë pagave mesatare mujore neto të fituara për punonjës në Republikë të publikuar deri në ditën e pagesës. |
| **Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Ligji për nëpunësit administrativë, Ligji për punonjësit në sektorit publik** | Është e nevojshme të qartësohet dhe harmonizohet neni 22 i Ligjit për ASHMAA me nenin 4 të Ligjit për nëpunësit administrativë në seksionin e subjekteve të cilat çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës mund ti rregollojnë tërësisht ose pjesërisht me ligj ose me marrëveshje kolektive në mënyrë të ndryshme nga ai i paraparë me Ligjin për nëpunësit administrativë. Mos harmonizimi i tillë ka ndikim në procedurën e punësimit, mënyrën e punësimit dhe statusin e të punësuarve në Agjenci. Është i nevojshëm harmonizimi i dispozitave të Ligjit për ASHMAA dhe Ligjit për të punësuarit në sektorin publikë, në sekseionin klasifikimit të vendeve të punës, evidencës, llojeve të punësimit, të drejtave të përgjithshme, detyrave dhe përgjegjësive, mobilitetit dhe çështjeve tjera të përgjithshme për punonjësit në sektorin publikë. |

| Rregullativa | Propozim për ndyshim/miratim |
| --- | --- |
| **Ligji për taksat komunale** | Revizioni në vazhdimësi njofton për dobësitë në zgjidhjen ligjore që rregullon arkëtimin e taksave komunale të cilat janë një nga burimet vetanjake të të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes lokale, ndërsa për shkak të zbrazëtirave në të nuk ka mundësi për arkëtimin real të tyre sipas llojeve dhe tarifave të caktuar dhe atë:<br>- Taksa komunale për përdorimin e rrugëve me automjete, është përcaktuar që të paguajnë personat juridikë të autorizuar për kryerjen e regjistrimit të automjeteve dhe të paguhet në llogarinë përkatëse të pagesës në kuadër të llogarisë së thesarit të komunës. Zgjidhja aktuale ligjore nuk e përcakton në cilat afate personat juridikë duhet të paguajnë taksën e arkëtuar në llogarinë e komunës, për të pasur detyrime për ta njoftuar komunën për numrin e automjeteve të regjistruara në varësi të kapacitetit kub dhe për shumën mujore të fondeve të mbledhura individualisht dhe kumulativisht.<br>- Taksa komunale për përdorimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, për të cilën nuk ka ndonjë detyrim të përcaktuar nga ndërmarrja tregtare përgjegjëse për shpërndarjen e energjisë elektrike e cila kryen arkëtimin e taksave nga pronarët e njehsorëve, për të informuar komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupi për numrin e tatimpaguesve sipas kategorive (numri i njehsorëve) në pajtim me numrin tarifor, si dhe për të hyrat e arkëtuara dhe kërkesave të paarkëtuara në bazë të tyre. |
| **Ligji për tatime mbi pronë** | Revizioni e tregon pasigurinë në pjesën e zbatimit të nenit 39 të Ligjit për tatime mbi pronë nga miratimi i tij në vitin 2004, në pjesën e detyrimit për të harmonizuar regjistrin e pasurive të patundshme të mbajtur nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit me regjistrin që e udhëheq Agjencia për Kadastër të Patundshmërive të RMV-së, dhe më së voni deri më 31 dhjetor të vitit, të dhënat nga gjendja e regjistrave duhet të dorëzohen në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe te Drejtoria e të Ardhurave Publike.Për zbatimin e këshaj zgjidhjeje ligjore janë të nevojshme saktësime të caktuara në Ligj si dhe lidhje softuerike të organeve kompetente. |
| | Në Ligjin nuk është definuar qartë mënyra me të cilën DAP do ti zbatojë aktivitetet të lidhura me kompetencat e marra nga komunat, dhe nuk është paraparë rregullimin e Ligjit nëpërmjet miratimit të aktit nënligjorë për të njëjtën. |

| Rregullativa | Propozim për ndyshim/miratim |
| --- | --- |
| **Ligji për zjarrfikje** | Në bazë të nenit 49 për financimin e aktiviteteve të Njësive Territoriale të Zjarrfikjes, Qyteti i Shkupit dhe komunat kanë mundësi të realizojnë të hyra shtesë nga gjobat për shkelje në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimet, kontribute vullnetare dhe fonde të tjera nga kompanitë e sigurimeve, fondacionet , personat juridikë dhe fizikë të destinuar për avancimin e mbrojtjes dhe të ardhurave nga burimet personale për shërbimet e kryera. Qyteti i Shkupit dhe komunat në RMV nuk realizojnë të hyra për këto baza përveç të ardhurave nga kompanitë e sigurimeve në shumën prej 2% të premive të mbledhura për sigurimin e automjeteve motorike dhe sigurimin e përgjegjësisë nga përdorimi i automjeteve motorike për të cilat nuk ka njohuri për vlerën e shumës të cilat duhen të paguhen dhe as nuk ka ndonjë detyrim ligjor për të qenë në gjendje të verifikojmë tërësinë dhe saktësinë e fondeve të paguara. Në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik, punonjësit në sektorin publik kategorizohen në katër grupe themelore, sipas të cilave zjarrfikësit profesionistë të punësuar në njësitë territoriale të zjarrfikësve kanë statusin e zyrtarëve të autorizuar në fushën e sigurisë, i përkasin grupit II - punët e zyrtarëve me autorizime speciale, përkatësisht personave të cilët kanë vendosur punësim në institucionet në sektorin publik në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe inteligjencës me qëllim të kryerjes së autorizimeve speciale, nëngrupi 10 - zyrtarë të tjerë të autorizuar në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe inteligjencës. Në kuadër të secilit nëngrup, me ligj të veçantë ose marrëveshje kolektive përcaktohen më shumë kategori të vendeve të punës. Me Ligjin për zjarrfikje përcakton tre kategori të vendeve të punës, si më poshtë: kategoria A - Shpëtuesit e zjarrfikësve të nivelit të lartë të menaxhimit, kategoria B - Udhëheqësit Shpëtues të zjarrfikësve dhe kategoria C - Shpëtuesit profesionistë të zjarrfikësve. Në kategorinë A përcaktohen 5 nivele të pozicioneve menaxheriale, ndërsa në kategorinë B dhe C përcaktohen 4 nivele pozicionesh. Në pajtim me ligjin e njëjtë për shkak të llojit dhe natyrës së punës që ata kryejnë, shuma e pagës së zjarrfikësve profesionistë në njësitë e zjarrfikësve në përputhje me nenin 5 të Ligjit është më e lartë për 20% të pagës së punonjësve të tjerë me trajnim profesional përkatës për vendin e punës në administratën komunale, të drejtat dhe detyrimet e pagave të të cilave rregullohen me Ligjin për nëpunës administrativë. Realizimi i së drejtës së punonjësve në TPPE për një pagë më të lartë se 20% të pagës së punonjësve të tjerë me përgatitje profesionale përkatëse për vendin e punës në administratën komunale është një dispozitë ligjore që është mjaft e saktë, duke pasur parasysh që struktura e të punësuarve në komuna është shumë e ndryshme dhe varet nga disa faktorë. Nevojitet zgjidhje e qartë dhe koncize ligjore për të përcaktuar pagën e zjarrfikësve profesionistë për të tejkaluar gjendjet e konstatuara. |

| Rregullativa | Propozim për ndyshim/miratim |
|---|---|
| **Ligji për lëndët e para minerale** | Në pajtim me nenin 76 të Ligjit për lëndë të para minerale, koncesionari që kryen kërkime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale paguan kompensim të njëhershëm për shfrytëzimin e hapësirës, ndërsa në varësi të llojit të lëndës së parë minerale të përcaktuar në koncesion, përkatësisht lejes për kryerjen e kërkimeve të detajuara gjeologjike.  Koncesionari që kryen eksploatimin e lëndës së parë minerale është i detyruar të paguajë kompensim për shfrytëzimin e hapësirës dhe tarifë për eksploatimin e sasisë të lëndës së parë minerale, lëndë e koncesionit. Mjetet paguhen në llogarinë përkatëse të pagesave në kuadër të llogarisë së thesarit dhe janë 22% të ardhura të Buxhetit të RMV-së dhe 78% të ardhura të buxhetit të komunës në zonën e së cilës kryhet veprimtaria koncesionare. Edhe për kundër se komuna disponon me të dhëna për marrëveshjet e lidhura për koncesione për hulumtime të detajuara gjeologjike dhe koncesione për eksploatimin e lëndës së parë minerale dhe ka pasqyrë në mjetet e paguara në llogarinë e buxhetit komunal, nuk ka mundësi ligjore për të konfirmuar plotësinë e të hyrave të cilat janë paguarë në llogarinë e tyre sipas në bazë të kësaj. |
